



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRATVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014



Prishtinë, 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë/Ministarstvo Pravde/Ministry of Justice

Prishtinë, 1/10/2015

Të nderuar/a,

Shoqëria, e përceptuar si një piramidë institucionesh shoqërore, si bazë kryesore ka familjen. Familja është vendi ku fillon dashuria dhe solidariteti njerëzor, vlera që janë njësi matëse për qëndrueshmërinë e piramidës-shoqëri. Është gjithashtu vendi ku edukohen qytetarët e përgjegjshëm, liderët e ardhshëm dhe ata që do të reflektojnë kudo që shkojnë karakteristikat tona pozitive. Nuk mund të ketë një piramidë funksionale pa një bazë solide. Një familje e shëndoshë që kultivon edukatë dhe vlera të mirëfillta është si një pemë, me frutet e së cilës mund të ushqehen gjenerata të tëra. Jo rallëherë, pemët kaplohen nga krimbat. Krimbi që depërton në një familje ka fuqinë të tjetërsoj qenësinë e saj duke i shumëzuar me zero të gjitha vlerat: ai krimb është dhuna. Megjithëse ende mund të ketë njerëz që mund të provojnë ta justifikojnë dhunën, ajo nuk është asnjëherë e justifikueshme. Dhuna nuk është mekanizëm disiplinues, as indeks i forcës. Mbetet një krimb i brendshëm që duke dëmtuar familjen, dëmton mbarë komunitetin. Do të doja të citoja një promovues të madh të jo-dhunës, Mahatma Gandhin i cili ka thënë “unë kundërshtoj dhunën sepse edhe nëse duket që ka ndonjë efekt të mirë, e mira është e përkohshme ndërsa keqja që shkakton dhuna është e përhershme”.

Dhuna në familje në të gjitha format e saj mbetet një nga shkeljet më të rënda të te drejtave të njeriut që ne njohim sot. Ajo që secili prej nesh duhet të kemi në mendje, është që dhuna është një sjellje jo e pranueshme në kontekstin social dhe e dënueshme nga legjislati në fuqi. Dhuna në familje, e shprehur në format fizike ose psikologjike, cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë integritetin fizik dhe shpirtëror të viktimave, shkatërron vlerat humane të komunitetit dhe pengon progresin. Shtrirja e madhe e këtij problemi tregon se dhuna në familje ndikon në shoqërinë si tërësi por e mira është që nuk konsiderohet më një çështje që i takon vetëm sferës private. Duke qenë pjesë e një shoqërie aktive, të përgjegjshme dhe demokratike, është detyrë e secilit prej nesh të bëjmë pjesën tonë në mënyrë që të çrrënjësimi këtë fenomen negativ.

Fatkeqësisht, dhuna në familje është një dukuri shumë e përhapur në të gjitha vendet e botës dhe prek të gjitha grupet shoqërore pa dallim vendi, kulture, feje, moshe, niveli arsimor apo standardi jetësor. Ky fenomen shqetësues është prezent edhe në shoqërinë tonë, e cila është duke kaluar nëpër fazën sfiduese të ndërtimit të shtetit ligjor dhe institucioneve demokratike për një zhvillim të qëndrueshëm dhe drejt proceseve të integritetit evropian. Ndoshta ju e keni përjetuar në mënyrë direkte ose indirekte dhunën, ndoshta kjo ju ka ndodhur vetëm njëherë, mund të ketë gjasa që ju punoni apo jetoni afër dikujt që është duke u keqtrajtuar tani. Megjithëse dhuna dëmton harmoninë e të gjithë anëtarëve të familjes, femrat dhe fëmijët janë më të prekur

nga kjo dukuri e shëmtuar. Fëmijët që jetojnë dhe u ekspozohen ambienteve ku ushtrohet dhuna, kanë më shumë gjasa të jenë të keqtrajtuar dhe të neglizhuar. Ndikimi i dhunës në rritjen dhe zhvillimin e tyre psiko-social është shumë i madh. Edhe në qoftë se një fëmijë nuk dëmtohet fizikisht, dhuna lë shenja të thella dhe ata mund të kenë probleme të natyrës emocionale që determinojnë sjelljen e tyre në të ardhmen. Kushdo që janë viktimat, ekziston zgjidhja, ekzistojnë mekanizmat për ndihmë. Siguria juaj dhe e atyre që ju rrethojnë është prioritet për institucionet e angazhuara në këtë drejtim.

Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje ka shprehur përkushtimin e saj që të bashkërendit aktivitetet dhe politikat bashkë me akterët tjerë duke u bazuar në tri shtylla: parandalimin, mbrojtjen e trajtimin dhe rehabilitimin e riintegrimin. Është detyrë e secilit prej nesh që të kontribuojmë sa i përket parandalimit si shtyllë e parë, proces që për të qenë i suksesshëm, fillon me një edukim të mirëfilltë nëpër familje që janë celula e shoqërisë dhe në shkolla si institucione edukativo-arsimore. Suksesi i shtyllës së parë është i rëndësishëm së veçantë pasi që realizohet parandalimi përmes vetëdijesimit që dhuna është dukuri negative. Jemi të vetëdijshëm që duhet të fuqizohen shtylla e dytë dhe e tretë, respektivisht mbrojtja e trajtimi si dhe rehabilitimi e riintegrimi, gjë që do të ndodhë falë angazhimit të institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë drejtim.

Një falënderim të veçantë meritojnë donatorët dhe përkrahësit duke filluar nga Ambasada Amerikane, UN Women, UNDP, OSCE si dhe shoqëria civile për ndihmën dhe gatishmërinë e ofruar që kanë ndikuar në realizimin e objektivave të Zyrës së Koordinatorit Nacional.

Si Koordinator Nacional kundër Dhunës në Familje dhe Zëvendësministër i Drejtësisë, dëshiroj të shpreh vullnetin dhe angazhimin institucional që përmes infrastrukturës ligjore dhe praktikave të mira, të ndikojmë që Kosova të bëhet model i parandalimit, adresimit dhe trajtimit të këtij problemi.

Singerisht,
Lirak Çelaj
Koordinator Nacional kundër Dhunës në Familje
Zëvendësministër i Drejtësisë
Ministria e Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë/Ministarstvo Pravde/Ministry of Justice

Parathënie

Zyra e Koordinatorit Nacional ka nderin të prezantoj raportin vlerësues të Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014.

Ky raport ngërthen në vete dy vlerësime të hartuara nga dy autore të ndryshme, të cilat kanë vlerësuar implementimin e Programit duke u bazuar në dy këndvështrime .

Vlerësimi i parë që do të keni rastin të lexoni në këtë publikim, i përkrahur nga UN Women dhe i hartuar nga konsulentja Ariana Qosaj- Mustafa, ka analizuar implementimin e Programit duke u fokusuar në ndikimin që programi ka patur në të mbijetuarat. Vlerësimi i dytë i përkrahur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, që ka për autore prokuroren amerikane Amy Litwin, ka analizuar efikasitetin e implementimit të Programit nga ana e sektorit të drejtësisë, me theks të veçantë në punën e gjykatave, prokurorive dhe mbrojtësve të viktimave.

Rëndësia e këtij raporti vlerësues qëndron në faktin që të gjeturat dhe rekomandimet e këtyre vlerësimeve do të jenë në funksion të hartimit të Strategjisë së re kundër Dhunës në familje. Falë këtij raporti, zyrtarët dhe ekspertët që do të punojnë në hartimin e strategjisë së re do të mund të punojnë në mënyrë specifike në pikat që janë ngritur në mënyrë që çështja e dhunës familjare të adresohet edhe me më shumë seriozitet e përgjegjësi institucionale.

Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014 ka shënuar një hap të rëndësishëm duke reflektuar seriozitetin e institucioneve që të trajtojnë me përgjegjësi të plotë këtë fenomen. Jemi të bindur që Strategjia dhe Plani i Veprimit i ri do të jetë edhe më mirë e strukturuar dhe do të përmbaj aktivitete e politika të harmonizuara të akterëve institucionalë.

**VLERËSIMI I STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË
KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE (2011-2014):
SFIDAT KRYESORE DHE RRUGA PËRPARA**

TETOR, 2015

Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje

Autore: Ariana Qosaj Mustafa

Lektorimi: DAS Group

Tirazhi: 200

SHKURTESAT

Kodi penal	Kodi penal i Republikës së Kosovës
Kodi i Procedurës Penale	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
QeK	Qeveria e Kosovës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
POS	Procedurat Standarde të Operimit
UNFPA	Fondi Popullor i Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Agjensioni i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
AV	Avokatët e viktimës
ZANV	Zyra për Avokim dhe Ndihmë Viktimave

Ky raport është përkrahur nga UN Women. Qëndrimet dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë ato të UN Women.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE: PASQYRË E PËRGJITHSHME MBI VLERËSIMIN E NSAPDV, 2011-2014.....

I) POZITA AKTUALE E DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË.....

II) PASQYRË MBI PROCESIN E HARTIMIT TË NSAPDV TË MËPARSHËM (2011-2014)

III) RISHIKIM I METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT.....

II. SFIDAT KRYESORE TË PARAQITURA NGA STRATEGJIA E MËPARSHME DHE PLANI I VEPRIMIT (2011-2014)

I) ÇËSHTJET KRITIKE NË KUPTIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E KORNIZËS LIGJORE.....

II) ÇËSHTJET KRITIKE NË FUNKSIONIMIN E MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE

OBJEKTIVI SPECIFIK 1 - PARANDALIMI DHE PËRFSHIRJA.....

OBJEKTIVI SPECIFIK 2 - MBROJTJA

OBJEKTIVI SPECIFIK 3 - SHËRBIMET.....

FORMULIMI I POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE PËR ÇDO SEKTOR

IV. GJETJET KRYESORE

V. PËRFUNDIMI & RRUGA PËRPARA

VI. NIVELI I IMPLEMENTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT MBI DHUNËN NË FAMILJE (2011 – 2014)

LITERATURA.....

SHTOJCA.....

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT TË SKPVKDHF-SË
2011-2014

I.i Hyrje

Dhuna në familje është formë e dhunës që i prekë anëtarët e familjes që shpesh janë në pozitë të cenueshme për shkak të gjinisë së tyre, moshës, statusit social dhe atij ekonomik. Në Kosovë viktimat e dhunës në familje janë kryesisht gratë, fëmijët dhe të moshuarit.¹ Mbrojtja e jetesës me dinjitet dhe pa dhunë garantohet me Kushtetutë të Kosovës dhe me ligjet përkatëse.² Duke u bazuar në garancitë kushtetuese, institucionet kosovare kanë ndërmarrë një varg ndryshimesh ligjore dhe të politikave për të adresuar nevojat e viktimave të dhunës në familje.

Ngjashëm, gjatë administrimit të Kosovës nga misioni ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara, në vitin 2003 Kosova miratoi Rregulloren 2003/12 Mbrojtja kundër Dhunës në Familje.³ Qasja e KB-së bazohej kryesisht në ndihmën për “viktimat” duke e definuar viktimën në një kuptim më të gjerë si person që ka përjetuar forma të ndryshme të lëndimit, qoftë ai fizik, mendor apo emocional apo viktimë e humbjes ekonomike që dobëson mundësinë e viktimës që në mënyrë thelbësore të gëzojë të drejtat e veta të adresuara në veprimet apo mosveprimet e përcaktuara në ligjet kombëtare penale apo në normat njerëzore të njohura ndërkombëtarisht.⁴ Në përputhje me rrethanat, qasja bazohej në implementimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), të listuar si e aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Përkohshme të Kosovës.⁵ Dispozitat e rregullores gjithashtu ishin baza që Kuvendi i Kosovës të miratojë Ligjin e ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (Ligji Kosovar për Dhunën në Familje) në vitin 2010, duke rivendosur gatishmërinë e institucioneve kosovare për adresimin e menjëhershëm të çështjes së dhunës brenda familjes.⁶ Duke u bazuar në kërkesat e Ligjit të Kosovës për Dhunën në Familje, institucionet kosovare kanë ndërmarrë një numër aktiviteteve dhe në vitin 2011 u miratua Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje (SKPVKDHf 2011-2014). Strategjia dhe Plani i Veprimit kanë skaduar në vitin 2014, e si rrjedhim ka lindur nevoja për vlerësim të ndikimit të saj në realitet si dhe nevoja për të analizuar praktikat më të mira të saj dhe mësimet e nxjerra. Kosova duhet të përpilojë Strategjinë e re dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje gjatë vitit 2015, ndërkaq mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira paraqesin shembuj të adresimit të zbrazëtirave të mbetura dhe mënyrën për të vazhduar më tutje.

1 Në pritje të dhënave nga Policia e Kosovës nga Njësitë për Dhunë në Familje.
2 Shih Nenin 23 dhe Nenin 37, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
3 Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12 për mbrojtjen nga dhuna në familje, në: http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2003regs/RE2003_12.pdf.
4 Shih faqen iv. të “Doracakut për drejtësinë për viktimat: për përdorimin dhe aplikimin e Deklaratës së Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit,” Zyra e KB-së për kontrollim të drogave dhe parandalim të krimit, në dispozicion në https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/UNODC_Handbook_on_Justice_for_victims.pdf
5 Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/09 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, në <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm>
6 Shiko Ligjin e Kosovës kundër Dhunës në Familje Nr.03/L-18, në dispozicion në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>.

a) **Gjendja e dhunës në familje në Kosovë**

Dhuna në familje vazhdon të jetë një nga format e përhapura të dhunës që prekin kryesisht gratë dhe fëmijët në Kosovë.⁷ Siç shihet nga të dhënat nga Policia e Kosovës, vazhdimisht raportohen raste të dhunës me afërsisht 1000 viktimat në vit që ndihmohen nga institucionet kosovare. Në më shumë se 80% të rasteve viktimat janë gra, të pasuara nga fëmijët dhe meshkujt e moshuar.⁸ Gjendja socio ekonomike e grave, fëmijëve dhe të moshuarve në Kosovë i bën ata tradicionalisht të varur nga anëtarët tjerë të familjes. Marrëdhëniet e pushtetit të dominuara nga përparësitë ekonomike janë mbizotëruese tek familjet ku kryefamiljari është mashkull i cili zakonisht është bashkëshorti i viktimës, babai apo të bijtë.

Gratë dhe fëmijët prirën të degradohen në sferën private dhe shpesh janë përgjegjëse për kujdesin për të fëmijët dhe të moshuarit, të disiplinuar që të jenë “moralisht” në rregull në mënyrë që t’i përmbahen roleve të tyre “reproduktive”. Në një hulumtim më të vjetër të Rrjetit të Grave të Kosovës për Agjencinë për Barazinë Gjinore në vitin 2008 për të ofruar informata për Strategjinë e parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje, intervistat me mbi 1200 respondentë treguan se më shumë se 40% e burrave dhe grave pajtohen që fëmijët duhen “disiplinuar” fizikisht në mënyrë që vajzat të jenë “moralisht” në rregull dhe që t’i përmbahen roleve të tyre “reproduktive”, ndërsa djemtë duhen “disiplinuar” fizikisht në mënyrë që të vazhdojnë rolin e tyre “të kryefamiljarit dhe mbajtësit të familjes”.⁹ Tradicionalisht grave gjithashtu u janë mohuar të drejtat e garantuara me ligje për të trashëguar apo regjistruar pronë në emrin e tyre. Vlerësimet ndryshojnë ku shifrat e fundit tregojnë që nga 8 deri në 15% e grave kanë pronë të regjistruar në emrin e tyre.¹⁰ Kjo shkakton efekt të drejtpërdrejt në kapacitetin e grave për të hapur biznes të tyre dhe zvogëlon kapacitetin e tyre për vetëpunësim kur dihet se kolaterali për kredi në emër të femrave është 3-5% në mbarë Kosovën.¹¹ Në mes të këtyre faktorëve social dhe ekonomik, gratë dhe vajzat rëndom qëndrojnë jashtë sferës publike me shifra të ulëta të përfaqësimit të grave në qeverinë e formuar kohëve të fundit në Kosovë. Nga 21 ministri të Qeverisë së Kosovës (QeK), vetëm dy ministri udhëhiqen nga gratë, ku njëra është e caktuar si ministre pa portofol.¹² Përmirësime të vogla janë arritur me kuotën për gratë në parlament që garantohet me ligjet për zgjedhje, përndryshe Kosova do të vazhdonte të ballafaqohej me sfida të mëdha në përfaqësimin e grave në sferën publike po të mos kishte garanci të ofruara përmes kuotave.

Përballë këtyre faktorëve socio-ekonomik dhe praktikave diskriminuese kundër grave, roli i qeverisë së Kosovës për të përkrahur gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje mbetet i detyrueshëm sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse. Në këto rrethana nevojiten më shumë përpjekje në përkrahjen e fuqizimit ekonomik afatmesëm dhe afatgjatë të viktimave, bazuar në kontekstin social dhe tradicional mbizotërues në Kosovë.

7 Shiko studimin nga Ulf Farnsveden, Ariana Qosaj-Mustafa dhe Nicole Farnsworth “Profilit Gjinor i Vendit - Kosova,” faqe. 2, i financuar nga Suedia dhe mund të gjendet në http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF.

8 Shiko të dhënat e kategorizuara nga Policia e Kosovës, shtojca komunikimi me e-mail me hulumtuesin e UN Women – korrik 2015.

9 Shih hulumtimin e Rrjetit të Grave të Kosovës për Agjencinë për Barazinë Gjinore, Siguria fillon në shtëpit: Hulumtimi për të ofruar informata për Strategjinë e parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje, 2008, f.2. në dispozicion në <http://www.womensnetwork.org/documents/20130120165404373.pdf>.

10 Shih “Profilin gjinor të vendit – Kosova,” në http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF

11 Po aty.

12 Shih uebfaqen zyrtare të qeverisë së Kosovës në <https://www.rks-gov.net/sq-AL/vegeza/Pages/Institucionete-Kosoves.aspx>.

b) **Vështrim i procesit të përpilimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të kaluar kundër Dhunës në Familje (2011-2014).**

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim të ngushtë me Agjencitë Kosovare, shoqërinë civile dhe akademinë ka udhëhequr procesin e përpilimit të Strategjisë së parë gjithëpërfshirëse dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për periudhën nga viti 2011 deri në 2014 (SK-PVKDHF 2011-2014). Ky proces zgjati për 9 muaj dhe bazohej në kërkesat nga Ligji i Kosovës për Dhunën në Familje. SKPVKDHF-ja e kaluar bazohej në katër parime kryesore që lidhen me të drejtat e njeriut dhe konsiderimin që dhuna në familje është shkelje e të drejtave të njeriut; parimin e partneritetit që identifikon të gjithë akterët e përfshirë për implementuar planin e veprimit së bashku; parimin e pronësisë vendore të implementimit të aktiviteteve bazuar në kontekstin e Kosovës dhe parimin e aktiviteteve reale dhe të realizueshme të bazuara në arritjet reale edhe pse plani konsiderohej ambicioz.¹³

Procesi i përpilimit të SKPVKDHF-së mblodhi palët vendore dhe ndërkombëtare të interesit në mënyrë që përpilohet Strategjia dhe Plani i Veprimit dhe të mundësohet koordinimi i përpjekjeve dhe aktiviteteve ekzistuese të institucioneve kosovare, akterëve të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare me synimin e vetëm parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje në Kosovë.¹⁴ Shumë nga përpjekjet në Kosovë ekzistonin edhe para Planit të Veprimit, por qëllimi i strategjisë dhe planit të veprimit ishte koordinimi i këtyre aktiviteteve dhe fokusimi i intervenimeve në drejtimin e duhur.

SKPVKDHF-ja ka adresuar nevojat e viktimave të dhunës në familje duke udhëzuar përgjigjen e institucioneve kosovare në tri shtylla kryesore:

- 1) Parandalim;
- 2) Mbrojtje dhe siguri; dhe
- 3) Përkrahje, trajtim dhe riintegrim.

Shtylla I: Nën shtyllën **Parandalimi**, SKPVKDHF-ja ka identifikuar mënyrat për rritjen e nivelit të njohurive dhe vetëdijes se shoqërisë së Kosovës në përgjithësi lidhur me dhunën në familje informuar qytetarët lidhur me pasojat e saj. Në të njëjtën kohë ky plan kërkon të rrisë reagimet e komunitetit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën. Për më tepër, ky program gjithashtu mëton të identifikojë mënyrat për rritjen e qasjen në informata dhe mjete ligjore për viktimat e dhunës në familje, në mënyrë që të përmirësojë sigurinë dhe mirëqenien e tyre.¹⁵

Shtylla II: Nën **Mbrojtjen dhe sigurinë** plani përmbante aktivitete që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, duke ofruar shërbime juridike dhe sociale si dhe duke kërkuar ofrimin e mbrojtjes ligjore dhe fizike nga aktet e dhunës në familje.

Shtylla III: Plani gjithashtu adresonte aktivitete për **Përkrahje, trajtim dhe riintegrim** për viktimat si dhe për kryerësit e dhunës në familje. Kjo shtyllë gjithashtu ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për viktimat si dhe të gjejë mënyra për të ndihmuar kryerësit

13 Shiko fq. 12 të Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në familje 2011-2014, në dispozicion në uebfaqen e Agjencisë për Barazi gjinore <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%3%ABs%20Kund%3%ABr%20Dhun%3%ABs%20n%3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>.

14 Shih f. 12 të Raportit Vjetor të Progresit për aktivitetet kundër dhunës në familje të Zyrës së Koordiniatorit kombëtar kundër dhunës në familje, publikuar në maj 2013. Shih faqen 11 në http://www.md-ks.net/repository/docs/Final_English_APR_DV.pdf. Financuar nga UNDP, projekti Iniciativa për Siguri të grave.

15 Shih f. 11 të Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në familje 2011-2014.

që të integrohen plotësisht në shoqëri.¹⁶ Për më tepër SKPVKDHF-ja pranon që riintegrimi i viktimave të dhunës në familje kërkon qasje multi-disiplinore dhe kërkon përfshirjen e të gjithë akterëve që mbrojnë viktimat dhe u ofrojnë shërbime atyre. (Lista e plotë e aktiviteteve nën secilën shtyllë dhe objektivë strategjike është paraqitur në Tabelën e Planit të Veprimit në Shtojcën I).

Përgjegjësia për të përpiluar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje del nga Ligji i Kosovës për Dhunën në Familje. Sipas Nenit 27 të këtij Ligji, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me ministritë tjera përkatëse është përgjegjëse për të përkrahjen dhe ngritjen e strukturave dhe infrastrukturës ndihmëse për Programin e Kosovës për Dhunë në Familje në mënyrë që "...të përkrahë dhe të përmbushë nevojat e personave kundër të cilëve është ushtruar dhunë, duke përfshirë ndihmën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm...".¹⁷ Ky Nen i Ligjit përkon me vendimin e qeverisë të korrikut 2012¹⁸, për caktimin e Zëvendësministrit të Drejtësisë në rolin udhëheqës për përpilimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje, dhe si Koordinatorin e paracaktuar Kombëtar kundër dhunës në familje. Për më tepër, përshkrimi i detajuar i roleve dhe përgjegjësi të Koordinatorit Kombëtar përcakton ndër përgjegjësitë tjera do të jetë edhe monitorimi i Planit të Veprimit. Ndryshe nga kjo, Plani i Veprimit përcakton që përgjegjësia kryesore e monitorimit të implementimit të SKPVKDHF-së bie mbi Agjencinë për Barazi Gjinore.¹⁹ Megjithëse Neni 27 duhet amandamentuar për të përcjellë infrastrukturën e përcaktuar për implementimin e SKPVKDHF-së,²⁰ përgjegjësitë kryesore vazhdojnë të mbesin tek Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje dhe tek Grupi Koordinues.

Procesi i vlerësimit është përkrahur edhe nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë nën udhëheqjen e UN Women. Sidoqoftë, përgjegjësitë kryesore për implementimin dhe mbikëqyrjen e monitorimit të SKPVKDHF-së mbetet tek Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje. Siç është cekur në vendimin qeveritar për Termat e Referencës për Koordinatorin, përgjegjësitë e tij/saj janë: a) të udhëheqë procesin e implementimit të SKPVKDHF-së Kosovës të aprovuar nga qeveria më 25 gusht 2011; b) të raportojë pranë qeverisë, kuvendit dhe strukturave tjera koordinuese për implementimin e SKPVKDHF-së; c) të udhëheqë Grupin Koordinues dhe të sigurojë takime të rregullta të grupit duke thirrur gjithashtu takime urgjente; dhe d) të sigurojë gatishmërinë politike nga të gjitha ministritë dhe agjencitë e përfshira për të përkrahur punën e pikave të kontaktit që janë anëtarë të Grupit Koordinues.

Në këtë mënyrë, gjetjet kryesore, sfidat dhe mundësitë për vlerësim do të përdoren me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të SKPVKDHF-së për të përpiluar Planin e Ri të veprimit i cili duhet përfunduar gjatë vitit 2015.

16 Po aty.

17 Shih Ligjin e Kosovës për mbrojtje nga Dhuna në Familje, Neni 27 Programi i Kosovës kundër Dhunës në familje, në dispozicion në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>.

18 Shih vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Termat e referencës për emërimin Koordinatorit Kombëtar kundër dhunës në familje, të miratuar më 11.07.2012, me vendimin Nr. 04/83. Shtojca II.

19 Shiko fq. 52 të Strategjisë së Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në familje 2011-2014, në dispozicion në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Barazi Gjinore në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>.

20 Diskutimet me grupe të fokusimit me nëngrupin punues për dhunë në familje të Grupit Koordinues për Gjini dhe Siguri, të mbajtur nga hulumtuesi i UN Women për vlerësimin e NSAPDV-së dhe nga misioni i OSBE-së në Kosovë, 3 korrik 2015 në Prishtinë.

c) Vështrim i metodologjisë së vlerësimit

Sidoqoftë, metodologjia e vlerësimit kishte disa kufizime. Për shkak të afatit të shkurtër kohor, hulumtimi nuk është një analizë shteruese e të gjitha aktiviteteve të implementuara nga institucionet kosovare dhe organizatat tjera përgjegjëse për implementimin e SKPVKDHF-së. Synimi i vlerësimit ishte që vlerësojë në përgjithësi dhe në aspektin e cilësisë nivelin e implementimit të aktiviteteve për të identifikuar sfidat kryesore që kanë mbetur, mësimet e nxjerra të pasuara nga praktikat më të mira, e gjithashtu për të ofruar opsionet për vazhduar tutje. Analiza e hollësishme sasiore e planit të implementimit të aktiviteteve është rol i vazhdueshëm që duhet të implementohet dhe ushtrohet nga Koordinatori Kombëtar i Kosovës kundër Dhunës në Familje në pajtueshmëri me rolin e tyre monitorues. Kështu, për të garantuar pronësinë e procesit, ky vlerësim duhet të bëhet rregullisht sipas përshkrimit të detajuar në Termat e Referimit nga Vendimi Qeveritar Nr. 04/83 (shih Shtojcën II).

Vlerësimi është përshtatur për të përmbushur nevojat e respondentëve duke përfshirë anëtarët e mekanizmave koordinues për dhunën në familje në tri pilot projekte të përkrahura nga UNKT-ja në Gjilan, Gjakovë dhe Dragash. Për më tepër, hulumtimi ka identifikuar dhe ka aranzhuar takime me pjesëmarrës të nën-grupit për dhunën e bazuar në gjini të Grupit për Siguri dhe Gjini (GSGJ) dhe mekanizmat tjera institucional të mandatar në Kosovë në nivelin qendror për të punuar në rastet e dhunës në familje. Hulumtim gjithashtu ka qenë në gjendje që të konsultojë në lidhje me aktivitetet për dhunën në familje në dy komuna shtesë, në komunën e Prishtinës dhe atë të Graçanicës, në mënyrë që të analizojë nivelin e reagimit në ato komuna pa mekanizmin koordinues të formalizuar dhe të vlerësojë mësimet e nxjerra nga rastet me mekanizma koordinues për qëllime krahasimi. Këto gjetje kanë mbështetur procesin e përpilimit të kapitullit të mësimave të nxjerra të raportit final. Vlerësimi ka filluar në qershor 2015 dhe ka përfunduar rreth mesit të korrikut 2015 me rreth 50 respondentë të konsultuar gjatë kësaj periudhe të vlerësimit.²¹ Vlerësimi gjithashtu ka zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësuesit e institucioneve kyçe të mandatuara për të implementuar SKPVKDHF-në. Lista e plotë e respondentëve është në dispozicion në pjesën e Shtojcave të këtij raporti.

Analiza cilësore më poshtë është bazuar në intervistat e gjysmë-strukturuar me palët kyçe të interesit të mandatuara për të punuar në përgjegjësitë lidhur me dhunën në familje sipas SKPVKDHF-së së kaluar dhe qëllimisht është lënë jashtë analiza dhe vlerësimi i rolit të avokatëve të viktimës dhe i komponentës së drejtësisë penale për rastet e dhunës në familje. Kjo analiza do të përmbledhet në një fazë të mëvonshme para përpilimit të Strategjisë së ardhshme dhe Planit të Veprimit në koordinim me kërkesat nga Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje.²² Analiza e mëposhtme kryesisht është fokusuar në sfidat kryesore të identifikuar në SKPVKDHF-në e kaluar dhe në nivelin e implementimit të tyre, që janë përdorur edhe si bazë për diskutim me grupet e fokusit dhe listat e aktiviteteve që pasqyrojnë nivelin e implementimit në kuadër të Tabelës së Planit të Veprimit në Shtojcën I dhe vërejtjet e hulumtuesit për nivelet e implementimit.

21 Vlerësimi i organizuar si grup diskutimi me anëtarët e Mekanizmave Komunal Koordinues për Dhunën në Familje nga komunat Dragash, Gjakovë dhe Gjilan me përkrahjen nga Programi i Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për Dhunën në Familje në Prizren, 16 qershor 2015. Një diskutim tjetër i grupit të fokusimit është organizuar dhe mbajtur me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UN Women, me anëtarët e nëngrupit punues për Dhunë të Bazuar në Gjini, si pjesë e Grupit Koordinues për Siguri dhe Gjini. Grupi koordinon përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore në Kosovë. I përbërë nga institucionet kombëtare (policia, agjencitë qeveritare), organizatat e grave, EUSR-ja, EULEX-i, OSBE-ja, NATO-ja dhe Agjencitë e KB-së. Shiko identifikimin dhe lidhjen e iniciativave lokale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë 1999-2012, në uebfaqen e Zyrës së UNDP-së në Kosovë në http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/womenPub/UNDP_ENG_FINAL.p

22 Përfundimet e takimit të nëngrupit punues për dhunën e bazuar në gjini të Grupit Koordinues për Siguri dhe Gjini me Koordinatorin Kombëtar, qershor 2015.

II. SFIDAT KRYESORE TË LISTUARA NGA STRATEGJIA E KALUAR DHE PLANI I VEPRIMIT (2011-2014) ²³

Të dhënat në vijim janë listuar nga Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje (2011-2014) duke u bazuar në gjetjet nga tre hulumtues. Përpilimi i SKPVKDHf-së ishte argumentuar me analizën e fakteve duke përfshirë të gjeturat nga hulumtimi sasior dhe cilësor të publikuara në raportet a) “Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për të ofruar informata për Strategjinë e parë kombëtare dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje (2008),” b) “Më shumë sesa fjalë në letër: përgjigja e ofruesve të drejtësisë për dhunën në familje në Kosovë (2009)” dhe c) “Hulumtimi lidhur me ndikimin e dhunës në të drejtat riprodiktive të grave në Kosovë (2008).”²⁴ Lista e mëposhtme e çështjeve kritike e nxjerrë nga SKPVKDHf 2011-2014 e kaluar bazohet në raportet faktike të listuara më lartë. Vlerësimi në vijim fokusohet në analizën cilësore të niveleve të implementimit të fushave kritike që janë mbuluar nga SKPVKDHf-ja e kaluar.

3.2.1 Çështjet kritike në kuptimin dhe implementimin e kornizës ligjore

- Niveli i njohurive të konventave ndërkombëtare dhe zbatimi nga gjykatësit, prokurorët dhe juristët është i kufizuar
- Ekziston përdorim i kufizuar i masave të dhëna me urdhra mbrojtës siç parashihet me rregulloren për mbrojtje ndaj dhunës në familje
- Masat e dhëna me urdhra mbrojtës në gjykata janë të arsyetuara dobët
- Institucionet kosovare kanë i kushtojnë vëmendje të kufizuar implementimit të urdhrave për mbrojtje
- Ekzistojnë kapacitete të kufizuara profesionale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje
- Në përgjithësi ekziston besim i kufizuar i qytetarëve për sistemin gjyqësor
- Aktet e dhunës në familje kundër fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar mbesin të pa raportuara sa duhet.

3.2.2 Çështjet kritike në funksionimin e mekanizmave institucional

- Kosova nuk e ka infrastrukturën e nevojshme për të mbrojtur dhe përkrahur gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje
- Koordinimi dhe bashkëpunimi i dobët ndërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore dhe ZK-BGJ-ve në komuna;
- Mungesa e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale për të parandaluar dhe ofruar shërbime për viktimat e dhunës në familje
- Institucionet e rëndësishme për zbatim të ligjit nuk e konsiderojnë si prioritet dhunën në familje
- Qendrat për Punë Sociale, edhe pse të mandatuara për ofruar ndihmë dhe përkrahje për viktimat, shpesh janë pasive në ofrimin e ndihmës për rastet e dhunës në familje

23 Origjinali marrë nga Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje, faqet 36 deri 43. Teksti në anglisht i përshtatur nga gjuha shqipe nga konsulenti i UN WOMEN. Shiko në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>

24 Dy raportet e para të hulumtuara nga Rrjeti i Grave të Kosovës për Qeverinë e Kosovës të përkrahura nga UNDP-ja dhe Qeveria e Finlandës, dhe Projekti Iniciativa për Siguri të Grave. Kjo e fundit është përkrahur nga zyra e UNFPA-së në Kosovë dhe gjithashtu e hulumtuar nga Rrjeti i grave të Kosovës.

- Institucionet ballafaqohen me sfida operative dhe logjistike
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve
- Zbrazëtirat në sistemin e referimit gjatë dhënies së ndihmës për viktimat e dhunës në familje
- Ekzistojnë shërbime të pamjaftueshme dhe ofrim i dobët i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.
- Ekziston nivel i ulët i vetëdijes tek ofruesit e shërbimeve

Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit kundër dhunës në familje gjithashtu parashihte një numër të objektivave strategjik dhe specifik për të adresuar mangësitë e sipërpërmendura ligjore, të politikave dhe strukturore. Më poshtë janë paraqitur objektivat specifike të SKPVKDHf 2011-2014:

II.i OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE:

Objektiva specifike 1- PARANDALIMI DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Deri në vitin 2013,²⁵ të themelohen mekanizmat efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje

Objektiva specifike 1.1 Të përpilohet politika në nivel qendror dhe lokal për parandalim, mbrojtje dhe ofrim të shërbimeve për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje

Objektiva specifike 1.2 Të sensibilizohet shoqëria lidhur me dhunën në familje

Objektiva specifike 1.3 Të themelohen mekanizma për edukim dhe vetëdijesim të të rinjve për dhunën në familje

Objektiva specifike 1.4 Të rritet numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje

Objektiva specifike 2 - MBROJTJA

Deri në vitin 2013 të arrihet që të ketë mekanizma efikas mbrojtës për viktimat e dhunës në familje

Objektiva specifike 2.1 Të sigurohen shërbime efikase për mbrojtje fizike të viktimave të dhunës në familje nëpër tërë territorin e Kosovës

Objektiva specifike 2.2 Të ngrihen kapacitete të palëve të internist (policisë, prokurorisë, gjykatave dhe qendrave për punë sociale) për trajtimin e dhunës në familje

Objektiva specifike 2.3 Të sigurohet ndihma juridike falas për viktimat e dhunës në familje

Objektiva specifike 3 – SHËRBIMET

Të sigurohen shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve të dhunës në familje në mbarë territorin e Kosovës dhe të përmirësohet qasja e viktimave në ato shërbime

Objektiva specifike 3.1 Të ngrihen dhe fuqizohen kapacitetet e punonjësve shëndetësorë, të shërbimeve sociale dhe personelit arsimor për të ofruar shërbime për viktimat e dhunës në familje

Objektiva specifike 3.2 Të përmirësohen politikat për përkrahje ekonomike për viktimat dhe kryerësit e dhunës.

Objektiva specifike 3.3 Të ngrihen dhe të fuqizohen shërbimet sociale (shëndetësore, arsimore, sociale, ekonomike, juridike) për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje

25 Teksti narrativ i SKKDHF-së i referohet vitit 2013 ndërsa tabela e objektivave i referohet vitit 2014.

4.2 Formulimi i politikave dhe programeve për secilin sektor

Programi kombëtar kundër dhunës në famije gjithashtu synon të përmirësojë qasjen në shërbime për viktimat e dhunës në familje me qëllim të parandalimit të dhunës, mbrojtjen e viktimës dhe ndëshkimin e rehabilitimit të kryerësit. Aktivitetet e parapara për të arritur këto synime janë paraqitur më poshtë në Planin e Veprimit të listuara me nivelin e tyre të implementimit nën Seksionin IV pas seksionit të analizës së gjetjeve kryesore.

III. GJETJET KRYESORE

a) Çështjet kryesore në të kuptuarit dhe implementimin e kornizë ligjore

Analiza e mëposhtme ofron një analizë të nivelit të implementimit të aktiviteteve duke u bazuar në tri shtyllat, të parandalimit, mbrojtjes dhe përkrahjes e riintegrit. Aktivitetet e listuara më poshtë nuk paraqesin listë shteruese të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra për implementimin e SKPVKDHf 2011-2014. Meqenëse raportimi i rregullt i institucioneve ka ndodhur vetëm gjatë ofrimit të të dhënave për raportin vjetor të vitit 2012 për Koordinatorin Kombëtar kundër dhunës në familje dhe lista mbetet e kufizuar në të gjitha informatat e ofruara pasi që raportimi zyrtar ka ndodhur vetëm një herë.²⁶ Analiza e ofruar bazohet në të dhënat e ofruara nga institucionet të vlerësuara sipas kërkesave për vlerësim të përkrahura nga zyra e UN Women në Kosovë në koordinim të ngushtë me kërkesat e Koordinatorit kombëtar kundër dhunës në familje.

1. Në përgjithësi, gjyqësori kosovar dhe viktimat e dhunës në familje kanë njohuri të kufizuara për konventat ndërkombëtare dhe aplikueshmërinë e tyre të drejtpërdrejt në legjislacionin e Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës, në rast të kundërshtimeve të ligjeve, konventat ndërkombëtare kanë aplikueshmëri të drejtpërdrejt në legjislacionin vendor.²⁷ Një vendim novator në përdorimin e rastit të të drejtave ndërkombëtare të njeriut ka ndodhur në vitin 2012 me rastin e Diana Kastratit, kur Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori si referencë në vendimin e vet analizën dhe përdorimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW). Ky vendim pohonte se vonesat nga Gjykata e Komunale e Prishtinës në lëshimin e urdhrit për mbrojtje për Diana Kastratin, e kanë vënë në rrezik jetën e saj dhe nuk kanë ofruar mbrojtjen e domosdoshme që ka çuar përfundimisht në vdekjen e saj dhe vrasjen nga ish-burri i saj. Ky rast ka zbuluar se vonesat në nxjerrjen e urdhrave për mbrojtje janë shkelje e të drejtave të njeriut pasi që ka mohuar të drejtën e personit për jetesë dhe të drejtën për mjete efikase juridike siç është e garantuar me konventa ndërkombëtare.²⁸ Për më tepër, rasti gjithashtu ka mobilizuar reagimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili ka kërkuar që urdhrat për mbrojtje në rastet e dhunës në familje, të lëshuara nga gjykatat në Kosovë, të jenë në pajtueshmëri me afatet e sakta të parapara me Ligjin e Kosovës kundër Dhunës në Familje. Gjithashtu IGJK-ja urdhëroi prioritarizimin e rasteve të dhunës në familje në gjykata, në pajtueshmëri me afatet e parapara me Ligjin e Kosovës kundër Dhunës

26 Shiko aktivitetet kundër dhunës në familje në Kosovë, raporti vjetor i progresit 2012, publikuar në maj 2013 nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje, z. Daut Xhemajli, Zëvendësministër i Drejtësisë, përkrahur nga UNDP-ja zyra në Kosovë. Gjendet në http://www.md-ks.net/repository/docs/Final_English_APR_DV.pdf

27 Shiko Kushtetutën e Kosovës, Neni 22.

28 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. KI 41/12 me aplikuesit Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

në Familje, sipas vendimit Nr. 22/2012 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Prioritarizimi i rasteve të dhunës në familje dhe urdhrat nga KGJK-ja që të kërkojnë përgjigje të menjëhershme nga gjykatat kosovare, ka ndikuar në nivelin e implementimit dhe të kuptuarit të legjislacionit për dhunën në familje. Megjithatë, niveli i njohjes dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare nga gjykatësit, prokurorët dhe avokatët është ende i kufizuar: për shembull, në procedimet e gjykatës civile lëshimi i UM-së zakonisht shihet si zëvendësim për ndjekje, me pajtimin ndërmjet palëve të konsideruar si zgjidhje të preferuar nga gjykatat pavarësisht nga kërkesat ligjore.²⁹

2. Në vitin 2014 për të kuptuar dhe implementuar më tej kornizën ligjore në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore përpiloi Komentarin për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje me përkrahje nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.³⁰ Komentari ishte synuar për personelin gjyqësor duke përfshirë gjykatësit dhe prokurorët dhe për qëllime trajnimi në mënyrë që të avancohet implementimi i Ligjit të Kosovës për Dhunën në Familje. Sidoqoftë, hulumtimi i mëvonshëm për dhunën e bazuar në gjini të udhëhequr nga Rrjeti i Grave të Kosovës³¹ ku janë targetuar më shumë se 1000 respondentë, ka nxjerrë në pah që gjykatat vazhdojnë të përdorin ligjin e rasteve ndërkombëtare dhe që ka njohuri të dobëta për ligjet dhe konventat ndërkombëtare. Në përgjithësi, duket se ka një përmirësim në afatin e nxjerrjes së urdhrit për mbrojtje edhe pse është adresuar me udhëzimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin e Diana Kastratit. Përdorimi dhe njohuritë për ligjin ndërkombëtar të drejtave të njeriut që është drejtpërdrejt i aplikueshëm në legjislacionin e Kosovës janë ende të kufizuara. Nevojiten aktivitete të mëtutjeshme për të rritur njohuritë e strukturave gjyqësore lidhur me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe përdorimin e ligjit të rastit që del nga konventat ndërkombëtare.

3. Për më tepër, institucionet kosovare kanë ndërmarrë një numër iniciativash për të implementuar kornizën ligjore për aktet e dhunës në familje siç kërkohej nga SKPVKDHf-ja dhe Ligji i Kosovës për Dhunën në Familje. Kryeministri i Republikës së Kosovës në vitin 2012 dhe Ministri i Shëndetësisë në vitin 2013, përpiluan dhe aprovuan dy akte nënligjore për të implementuar Ligjin e Kosovës për Dhunën në Familje. Qeveria gjithashtu përpiloi dhe miratoi Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrave për trajtim psiko-social të kryerësve të dhunës në familje të shtyrë nga masa detyruese e trajtimit nga alkoolizmi dhe vartësia në substanca psikotropike.³² Këto akte nënligjore kërkojnë gjithashtu krijimin dhe licencimin e OJQ-ve dhe/ose agjencive qeveritare për të ofruar shërbime shëndetësore dhe sociale në mënyrë që të ofrohet trajtimi i detyrueshëm i urdhëruar nga gjykata duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës së përshtatshme edhe në nivelin komunal.³³ Megjithatë, implementimi i këtyre udhëzimeve administrative mbetet i kufizuar në praktikë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.³⁴ Trajtimi i veçantë për kryerësit e dhunës në familje që kanë nivel të

29 Komunikimet me postë elektronike me këshilltarin gjinor të EULEX-it, korrik 2015

30 Shiko Komentarin e ABGJ-së për Ligjin për Mbrojtjen e nga Dhuna në Familje, gjendet në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Komentari%20i%20Ligjit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje%20-Shqip.pdf>.

31 Përfaqësuesi i RRGK-së në diskutimet me grupe të fokusimit me nëngrupin punues për dhunë të bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtina.

32 Shiko UA-në Nr. 12/2012, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UA_per_trajtimin_psiko-social_te_kryersve_te_dhunes_ne_familje_10.09.pdf. Shiko gjithashtu UA-në Nr. 02/2013, gjendet në: <http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Udhezim%20Administrativ%2002-2013.pdf>.

33 Shiko Nenin 8, paragrafi 3 i UA-së Nr. 12/2012.

34 Diskutimet me grupe të fokusimit me anëtarët e Mekanizmave Komunal për Dhunë në Familje nga Dragashi, Gjilani dhe Gjakova, 16 qershor 2015 në Prizren.

vartësive nga alkooli apo droga apo të atyre në nevojë për përkrahje psiko-sociale aktualisht nuk ofrohen si opsion trajtimi.³⁵ Megjithatë, disa kryerës të dhunës në familje janë trajtuar në spitalet primare, ndërsa Ministria e Shëndetësisë duhet të ngrejë infrastrukturën ndihmëse në mënyrë që të implementohet Udhëzimi Administrativ përkatës (UA 02/2013). Për më tepër, kryerësit që janë trajtuar njëherë në objektet e spitaleve të kujdesit primar, pasi janë larguar nga ato objekte nuk u janë nënshtruar trajtimeve përcjellëse.³⁶ Në përgjithësi, implementimi i këtyre dy akteve nënligjore të aprovuara për kryerësit e dhunës në familje, kanë pasur nivel minimal implementimi për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës për të implementuar këto akte specifike.

4. Për të avancuar nivelin e njohurive dhe implementimin e kornizës ligjore dhe të Ligjit të Kosovës kundër Dhunës në Familje konkretisht, Qeveria e Kosovës nën udhëheqjen nga Agjencia për Barazi Gjinore ka përpiluar dhe miratuar në vitin 2013 Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë.³⁷ Ky dokument politikë i njohur si PSO-të ofron një përshkrim të detajuar të roleve dhe përgjegjësi për policinë, punëtorët social, avokatët e viktimave duke përfshirë gjithashtu gjykatësit, mësime të ndihmës, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, prokurorët dhe personelin e strehimores në identifikimin, referimin si dhe asistimin e viktimave të dhunës në familje. Trajnime gjithashtu janë mbajtur për t'iu përgjigjur nevojës së avancimit të kapaciteteve dhe zbatimit profesional të POS-ve deri në vitin 2014. Gjatë periudhës 2011-2014 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) u ofroi nga dy kopje të POS-ve origjinal 38 komunave me gjithsej 80 kopje të shpërndara.³⁸ Gjithashtu gjatë vitit 2014, Agjencia për Barazi Gjinore së bashku me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe me përkrahjen e MPMS-së dhe palëve tjera të interesit, trajnuar më shumë se 200 punëtorë social, zyrtarë policorë dhe avokatë viktimash lidhur me përmbajtjen dhe procedurat e përcaktuara me PSO-të.³⁹ Përveç kësaj, MPMS-ja hartoi dhe miratoi “Standardet minimale për punëtorët social në asistimin e viktimave të dhunës në familje.” Një shumicë e konsiderueshme e punëtorëve social janë trajnuar gjatë vitit 2013 në trajnime njëditore në lidhje me implementimin e standardeve minimale përkatëse dhe me kërkesat ligjore në dhënien e ndihmës për viktimat e dhunës në familje.⁴⁰ Sidoqoftë, hulumtimi i vitit 2015 i Rrjetit të Grave të Kosovës për dhunën e bazuar në gjini tregon se policia dhe punëtorët social vazhdojnë të kenë njohuri minimale për kornizën ligjore, duke përfshirë Ligjin e Kosovës kundër dhunës në familje.⁴¹ Përveç kësaj, njohuritë e kufizuara lidhur me masat që duhen lëshuar me urdhër mbrojtje vazhdojnë, pasi që vetëm masat 1 dhe 2 të parapara me ligj kryesisht përdoren dhe kërkohen me formularët e kërkesës për lëshim të urdhrit për mbrojtje. Krahësuar me masat tjera të listuara në Ligjin e Kosovës për Dhunë në Familje, avokatë e viktimave dhe punëtorët social përdorin kryesisht masat 1 dhe 2, ndërsa masat tjera përdoren në një shkallë më të vogël.⁴² Kjo mungesë njohurish për masat e

35 Diskutimet me grupe të fokusimit me anëtarët e nëngrupit punues për dhunë e bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtinë.

36 Po aty.

37 Shiko Procedurat Standarde të Operimit (SPO) për mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, e miratuar në vitin 2013. Gjetet në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Procedurat_Standarde_te_Veprimi_per_Mbrojtje_nga_Dhuna_ne_Familje.pdf

38 Komunikimi me postë elektronike me përfaqësuesin me MPMS-së, korrik 2015.

39 Shiko “OSBE-ja përmbyll trajnimin për përgjegjësit për reagim ndaj dhunës në familje në Kosovë,” në <http://www.osce.org/kosovo/129891>

40 Intervista e hulumtuesit me pikën kontaktuese për dhunë në familje të MPMS-së, korrik 2015.

41 Gjetjet preliminarë për shkallën e dhunës së bazuar në gjini në Kosovë, 2015, komunikimi me postë elektronike me hulumtuesin, korrik 2015.

42 Të dhëna hyrëse nga hulumtuesi i Rrjetit të Grave të Kosovës, komunikimi me postë elektronike në korrik 2015.

kërkua dhe të lëshuara me urdhër mbrojtje, ndikon gjithashtu në nivelin e implementimit të Ligjit të Kosovës kundër Dhunës në Familje.

5. Me qëllim të kuptimit dhe implementimit të kornizës përkatëse ligjore për dhunën në familje, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës nën drejtimin e Zyrës për Avokim dhe Ndihmë Viktimave (VAAO), hartoi formularët për kërkesë të lëshimit të urdhrit të mbrojtjes. Formularët e kërkesave gjithashtu tregojnë në detaje informatat e parashtruesit të kërkesës, masat që duhen kërkuar dhe rrethanat që janë relevante për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.⁴³ Më parë, kërkesat për lëshim të urdhrit të mbrojtjes nuk ofronin shpjegimet e detajuara për masat e mbrojtjes që mund të kërkohen.⁴⁴ Ndryshe nga kjo, të gjetura e hulumtimit nga RRGK të vitit 2015, pikëvështrimi i Avokatëve të Viktimave është që përpilimi i formularëve të kërkesës e ka rritur numrin e masave që mund të kërkohen nga parashtruesit e kërkesës dhe e ka diversifikuar përdorimin e saj.⁴⁵ Përdorimi i tij i plotë dhe analiza e implementimit në praktikë mbeten për t'u vlerësuar. Sidoqoftë, aprovimi i formularit të kërkesës për lëshimin e urdhrit për mbrojtje është një përmirësim i ndërmarrë nga institucionet kosovare për të avancuar të kuptuarit dhe implementimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje.

6. Për të avancuar nivelin e njohurive për legjislacionin për dhunën në familje, Zyra për Avokim dhe Ndihmë Viktimave e Prokurorisë së Shtetit ka hartuar formularin për deklarimin e dëmeve. Synimi i këtij formulari ishte që të qartësojë dëmet e pësura nga viktimat dhe që të kërkojnë dëmshpërblim duke plotësuar formularin e deklarimit të dëmeve në procedimet penale.⁴⁶ Formulari është në dispozicion edhe përmes internetit në uebfaqen zyrtare të prokurorisë së shtetit. Formulari përshkruan në detaje procedurat për viktimat për të deklaruar dëmet e pësura nga aktet e dhunës në familje.⁴⁷ Shkalla deri në të cilën kërkohen dëmshpërblime dhe sa ato kompensohen mbetet i panjohur në këtë nivel të vlerësimit.

7. Sa i përket çështjes qenësore të implementimit të kornizës ligjore, çështja e vonësive në lëshimin e urdhrit për mbrojtje duke përfshirë lëshimin e ndëshkimeve të lehtë për recidivistët dhe shkelësit e urdhrit për mbrojtje, janë vërejtur vetëm disa përmirësime të vogla. Shumica e gjykatave themelore në Kosovë kanë emëruar gjykatës për të prioritarizuar lëshimin e urdhrit për mbrojtje pas vendimit Nr. 22/2012 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.⁴⁸ Problemet qëndrojnë në implementim me rastet kur gjyqtarët janë në pushim apo dalin në pension. Në këso raste janë raportuar vonesa në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.⁴⁹ Sa i përket sistemit të avancuar dhe përmirësuar të vlerësimit të rasteve të recidivistëve dhe dhënies së ndëshkimeve sipas Ligjit të Kosovës për dhunën në familje, nuk ka pasur përmirësime.⁵⁰ Për më tepër, shkelja e urdhrave të mbrojtjes është bërë vetëm në raste të rralla kundërvajtje penale dhe rrejdhimisht rast recid-

43 Shiko, Zyra për Avokim dhe Ndihmë Viktimave, Prokuroria e Shtetit të Kosovës: në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Declaration_of_damages.pdf.

44 Të dhëna hyrëse nga hulumtimi i Rrjetit të Grave të Kosovës, komunikimi me postë elektronike në korrik 2015.

45 Intervista me Menaxherin e Avokatit të Viktimës, korrik 2015.

46 Neni 218, po aty, fq. 22.

47 Shiko http://www.psh-ks.net/repository/docs/Deklarate_mbi_demin.pdf.

48 Shiko vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, takimi i 58-të i KGJK-së, mars 2012.

49 Diskutimet me grupe të fokusimit me anëtarët e nëngrupit punues për dhunë e bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtinë

50 Diskutimet me grupe të fokusimit me anëtarët e nëngrupit punues për dhunë e bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtinë

ivist, që çon në dështim në ekzekutimin e ndëshkimeve të duhura në pajtueshmëri me kërkesat nga Ligji i Kosovës për dhunë në familje. Nuk ekzistojnë udhëzime të qarta për praktikuesit që punojnë në fushën e sundimit të ligjit se si të trajtojnë dhe monitorojnë urdhrat për mbrojtje, shkeljen e tyre dhe kujt duhet t'i raportojë viktimat për shkeljen e urdhrit të mbrojtjes dhe si duhet policia të trajtojë rastin.⁵¹

8. Sa i përket arsytimit të duhur e të detajuar të masave të lëshuara me urdhër mbrojtës të kërkuara nga SKPVKDHf-ja, kjo çështje është adresuar vetëm pjesërisht për shkak të përpilimit dhe aprovimit të formularit të sipërpërmendur nga Zyra për Avokim dhe Ndihmë Viktimave të njohur si Formulari për kërkim të lëshimit të urdhrit për mbrojtje. Kjo masë ka përmirësuar pjesërisht nivelin e implementimit të kësaj kërkeje që mbulohet nga SKPVKDHf-ja.

9. Në fund, kapacitetet e kufizuara profesionale për rastet e dhunës në familje vazhdojnë të mbesin sfidë. Edhe pse ka pasur përmirësime thelbësore në avancimin e njohurive institucionale për ligjet dhe standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, sfidat kryesore mbesin në nivelet e implementimit. Gjithashtu, niveli i ulët i raportimit të akteve të dhunës në familje kundër fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara duket se ka mbetur një çështje kritike. Shifrat tregojnë rritje të vazhdueshme të raportimeve të akteve të dhunës kundër të moshuarve dhe ndër anëtarë meshkuj të familjes,⁵² por megjithatë mbrojtja dhe ofrimi i ndihmës në rastet e dhunës në familje ku përfshihen fëmijët mbetet problematike. Për shembull, edhe pse janë dizajnuar dhe përkrahur dhomat për intervistim miqësore për fëmijët në gjatë stacione policore në Kosovë, përdorimi i tyre ende mbetet i kufizuar nga Policia e Kosovës të monitoruara nga UNICEF në vitin 2014.⁵³ Edhe pse janë zhvilluar dhe implementuar standarde minimale nga shërbimet sociale,⁵⁴ pikëvështrimi i përgjithshëm i agjencive që punojnë me fëmijët është që asistencë me fokus interesin më të mirë të fëmijës ka nevojë për përmirësim dhe duhet adresuar duke hartuar një kapitull të veçantë në SKPVKDHf-në e re për ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimat të dhunës në familje.⁵⁵

b) Çështjet qenësore për funksionimin e mekanizmave institucional kundër dhunës në familje

1. Infrastruktura kosovare për të ndihmuar dhe përkrahur gratë dhe fëmijët që janë viktimat të dhunës në familje është përmirësuar. Kosova ka kaluar një proces të gjatë të licencimit të kapaciteteve të nëpunësve socialë që është përcjellë me zhvillimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve sociale në pesë fusha kryesore.⁵⁶ Licencimi i ofruesve të shërbimeve nga OJQ-të për viktimat e dhunës në familje ka përfunduar tek vonë.⁵⁷ Licencimi është kryer në pajtim me kriteret që dalin nga Ligji i Kosovës për Shërbime Sociale dhe Familjare për të

51 Komunikimet me postë elektronike me këshilltarin gjinor të EULEX-it, korrik 2015.

52 Të dhëna nga Policia e Kosovës, në dispozicion në raportin final të vlerësimit nga UN WOMEN, korrik 2015.

53 Intervista e hulumtuesit me pikat kontaktuese të UNICEF-it për Dhunën e bazuar në gjini, korrik 2015 në Prishtinë. Janë zhvilluar dhe dhuruar 6 dhoma intervistimi për PK-në për krijimin e mjedisit miqësor për intervistimin e fëmijëve (nga 48 stacione ekzistuese të policisë).

54 Intervista e hulumtuesit me pikat kontaktuese të MPMS-së për Dhunën në Familje, korrik 2015.

55 Po aty. Shiko Studimin e Vlerësimit të Nivelit Bazë për DHBGJ dhe dhunën në familje në komunat Dragash, Gjilan dhe Gjakovë, 2013, UNICEF.

56 Shiko fq. 18 të Planit të Veprimit Partneriteti Evropian, dhjetor 2012, gjendet në http://www.mei-ks.net/repository/docs/European_Partnership_Action_Plan_2012.pdf

57 Intervista e hulumtuesit me personin kontaktues të MPMS-së për dhunën në familje, korrik 2015.

avancuar kapacitetet profesionale të ofruesve të shërbimeve.⁵⁸ Në bazë të këtij Ligji edhe organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale duhet të regjistrohen dhe respektojnë standarde të caktuara të licencimit të përcaktuara nga Departamenti për Mirëqenie Sociale.⁵⁹

2. Për me tepër, sipas Ligjit të ri Penal Të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale, mbrojtësit e viktimave janë bartur nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës te Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Ata gjithashtu parashihen që të veprojnë si përfaqësues të autorizuar të viktimave para gjykatës për krimet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.⁶⁰ Kjo ka rritur shkallën e qasjes për viktimat në mjetet juridike, megjithatë shkalla e zbatimit për sa i përket cilësisë së ofruar nga këto shërbime mbetet për tu vlerësuar më tutje. Për më tepër, Kosova gjithashtu për çdo vit, sa ka zgjatur periudha e implementimit të SKPVKDHf-së 2011-2014, ka vazhduar që të ofrojë asistencë financiare për viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, ofruesit e strehimit, si ofrues shërbimesh të licencuara nga MPMS-ja e që udhëhiqen nga OJQ-të, vazhdojnë të kundërshtojnë mbulimin minimal të shpenzimeve nga qeveria, pasi që ato nuk mbulojnë mjaftueshëm pagat e personelit profesionistë të strehimoreve dhe shpenzimeve tjera për shërbime komunale, duke i lënë shpesh OJQ-të të varura nga komuniteti i donatorëve që të paguajnë personelin e strehimoreve dhe për përkrahjen financiare për shpenzime tjera për shërbime komunale.⁶¹ Në disa raste vetëm komunat kanë ofruar mbështetje për strehimoret, siç është rasti me Gjilanin që ka ofruar objektin për shfrytëzim si dhe komuna e Prishtinës. Vetëm në vitin 2014, gjatë fushatës parazgjedhore, qeveria u pajtua, përmes një mbështetjeje që ka ndodhur vetëm njëherë nga kryeministri, që të përkrahë të gjitha nevojat e financimit për OJQ-të.⁶² Megjithatë, nevojat e përhershme për OJQ-të duhet të rivlerësohen si duhet nga ana e qeverisë gjatë përpilimit të SKPVKDHf-së së re, duke përfshirë përpilimin e përbashkët të kritikave përkitazi me shkallën e financimit dhe mbështetjes.

3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu ka krijuar kriteret për licencimin e nëpunësve socialë në pajtim me kushtet që dalin nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.⁶³ Gjatë viteve 2013-2014, Ministria ka licencuar të gjithë nëpunësit socialë duke i regjistruar këta profesionistë edhe në Regjistrin për Shërbime Sociale dhe Familjare.⁶⁴ Licencimi gjithashtu është përdorur nga Ministria si mjet për vlerësimin dhe monitorimin e nivelit të performancës së nëpunësve socialë dhe punën me viktimat e cënueshme duke përfshirë viktimat e dhunës në familje.

4. Prej vitit 2003 Mbrojtësit e Viktimave (MV) kanë përfaqësuar në përgjithësi interesat e viktimave të dhunës në familje që parashiheshin sipas kodeve të përkohshme penale. Megjithatë, me Kodin e ri Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2013,⁶⁵ Mbrojtësit e Viktimave i kanë avancuar edhe rolet e tyre për përfaqësimin e viktimës në gjykata dhe që të kenë të drejtën për përfaqësimin e interesave të tyre duke kërkuar mbrojtjen e këtyre të drejtave në emër të viktimave. Edhe pse ka pasur kritika rreth rolit të mbrojtësve të

58 Shiko Nenin 8.3 të Ligjit kosovar për shërbime sociale dhe familjare, 2005. Gjendet në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf

59 Po aty.

60 Shiko Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Neni 63 gjendet në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf

61 Intervistë me anëtarin e Koalicionit strehimi të OJQ-ve, 16 qershor 2015 në Prizren.

62 Po aty.

63 Shiko nenin 1 të Ligjit kosovar për shërbime sociale dhe familjare, 2005. Gjendet në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf

64 Intervista e hulumtuesit me personin kontaktues të MPMS-së për dhunën në familje, korrik 2015.

65 Shiko kodet penale që gjenden në www.legislationline.org/documents/id/17771

viktimave për përfaqësimin në gjykata të të gjitha viktimave të krimit, siç duket për të shtrirë kapacitetet e burimeve njerëzore të MV-së që të mbulojë të gjitha viktimat e krimit, shumica e rasteve të mbuluara në vitin 2014 nga MV-të kanë qenë të ndërlidhura me rastet e dhunës në familje.⁶⁶ Megjithatë, ekziston kritikë valide se MV-të ende përpiqen që të kenë mirëkuptim të përbashkët rreth detyrave dhe përgjegjësi në rastet e dhunës speciale, posaçërisht pas ndryshimit të mandatit të tyre të ri të bazuar në Kodin e ri Penal.⁶⁷ Nevojitet një shqyrtim i mëtejshëm për rolin dhe implementimin praktik të mandatit të MV-së dhe rolet e përgjegjësitë e tyre të reja, në pajtim me Kodin e ri Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, duhet të reflektohen në PSO.

5. Sipas udhëheqësit të donatorëve, d.m.th. Zyra e UNDP-së në Kosovë, pesë zyre shtesë për ndihmë juridike janë mbështetur nëpër Kosovë, me qëllim të ofrimit të mjeteve efikase juridike për grupet e cenueshme duke përfshirë viktimat e dhunës në familje. Për më tepër, në vitin 2012, Ligji i Kosovës për Ndihmën Juridike gjithashtu i ka renditur viktimat e dhunës në familje si kategori të cilëve u takon e drejta për iniciimin e procedurës së kërkimit të ndihmës juridike falas.⁶⁸ Megjithatë, mbyllja e pesë zyrave për ndihmë juridike të mbështetura nga UNDP-ja, e që i janë transferuar QK-së, tashmë janë mbyllur nga Qeveria e Kosovës në vitin 2015. Kjo është vlerësuar si dështim i institucioneve të Kosovës që të vazhdojnë mbështetjen e qasjes dhe të drejtës juridike falas në mjetet efikase për grupet e cenuara duke përfshirë viktimat e dhunës në familje.⁶⁹ Vazhdimi i kësaj mbështetje do të kishte shpenzime minimale buxhetore dhe është qenësor që të mos u pamundësohet qasja në mjete juridike falas viktimave të dhunës në familje posaçërisht në zonat rurale.⁷⁰ Përveç kësaj, pasi që nismat e donatorëve shpesh duken të pamjaftueshme dhe duhet të ketë një rritje të rolit të Qeverisë së Kosovës për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, Qeveria e Kosovës duhet shqyrtojë që rihapjen e këtyre zyrave ta bëjë pjesë të veprimtarive të SKPVKDHf-ve të ardhshme dhe/ose të marrë parasysh se çfarëdo intervenimi në të ardhmen duhet të marrë për bazë obligimin që të mbështes mekanizmat kundër dhunës në familje përmes financimit nga buxheti i Kosovës.

6. Ekziston nevoja për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për krimet që janë të ndërlidhura me dhunën gjinore në përgjithësi. Për shembull gjatë viteve 2011-2014 ishte përpiluar një dokument për monitorimin e rregullt të Zyrës Gjinore të EULEX-it ku ishin analizuar mbledhja e të dhënave duke përfshirë viktimat e dhunës në familje nëpër institucionet për sundimin e ligjit në Kosovë. Raporti i brendshëm kishte identifikuar zbrazëtira përkitazi me ofrimin e rekomandimit për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për krimet që janë të ndërlidhura me dhunën gjinore. Për më tepër, EULEX-i rekomandon që në të ardhmen e afërt institucionet e Kosovës duhet të punojnë edhe në ofrimin e të dhënave të kategorizuara sipas gjinisë për kryerësit dhe viktimat e krimit, marrëdhënies në mes tyre dhe llojit të krimit sipas kategorive të definuar mirë ndërmjet të gjitha institucioneve për sundimin e ligjit që janë të përfshira.⁷¹ Deri më tani një koordinim i tillë nuk duket se ekziston e as nuk ka një bazë të të dhënave ndërinsti-tucionale për rastet e dhunës në familje.

66 Shifrat e sakta gjendet te UNWOMEN. Intervistë me Mbrojtësin e viktimës dhe Menaxherin e asistencës, korrik 2015.

67 Komunikimi/intervista me postë elektronike me Këshilltarin për çështje gjinore në EULEX, korrik 2015.

68 Shiko Nenin 31 të Ligjit kosovar për ndihmë juridike falas, gjendet në [http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ndihme_juridike_falas_\(anglisht\).pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ndihme_juridike_falas_(anglisht).pdf).

69 Përfundimet nga prezantimi i të gjeturave preliminare me Koordinatorin nacional kundër dhunës në familje, 13 korrik 2015.

70 Diskutim i fokus grupit me zyrtarin e ndihmës juridike, Mekanizmi i koordinimit për dhunën në familje në komunat e Dragashit, Gjilanit dhe Gjakovës, 18 qershor 2015 në Prizren.

71 Komunikimi me postë elektronike me Këshilltarin për çështje gjinore në EULEX, korrik 2015.

7. Nevojat logjistike dhe operative të institucioneve mbeten një sfidë. Nëpunësit social shpesh ankohen për mungesën e infrastrukturës së duhur për të mbrojtur dhe mbështetur gratë, burrat dhe fëmijët që janë viktimat e dhunës në familje.⁷² Për shembull, në rastet kur raportohen raste emergjente nga ana e viktimave të dhunës në familje shpesh ka nevojë që të ndihmohen me pajisje higjienike, veshmbathje dhe ushqim. Në këtë drejtim, QMP-të janë decentralizuar dhe financohen nga nivelet qendrore d.m.th. MPMS-ja kanalizohet vetëm përmes mbulimit të nevojave për asistencë sociale, megjithatë shërbimet sociale këshillohen që të zhvillojnë tutje planet për mbështetje në nivele komunale.⁷³ Për më tepër, MPMS-ja në koordinim me QMP-të gjithashtu duhet të synojë mënyrat për të adresuar nevojat emergjente dhe afatgjate të viktimave në bashkëpunim të ngushtë me komunat si dhe institucionet e nivelit qendror me qëllim të identifikimit të mënyrave për të mbështetur dhe ofruar buxhet të duhur për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përkrahjen e viktimave në SKPVKDHf-në e ardhshme. Përveç kësaj, nëpunësit socialë ankohen se transportimi i viktimave nga QMP-të mbetet problem. Duhet të identifikohen mënyra alternative dhe inovative të mbështetjes siç është rasti i komunës së Prishtinës për të paguar shpenzimet e taksisë për nëpunësit socialë në raste emergjente.⁷⁴ Për më tepër, niveli i koordinimit dhe memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet komunave që bashkërisht tu ndihmojnë viktimave të dhunës në familje brenda rajoneve të ndryshme të Kosovës akoma mbetet sfidë. Nuk ka shembuj të njohur të marrëveshjeve ndër-komunale për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje, gjë që është shqetësuese, pasi që vetëm strehimoret përkrahen nga 7 komunat e Kosovës që mbulojnë nevojat e rajoneve të Kosovës.

8. Vlen të përmenden disa praktika më të mirat. Për shembull Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndarë buxhet për psikologë që të këshillojnë studentët në përgjithësi. Pas kësaj? 2 deri 3 psikologë janë caktuar për komunë, siç është treguar në hulumtimin vijues të RRGK-së 2015 për dhunën që ka për bazë gjininë. Policia e Kosovës qartazi ka rezervuar fonde për njësi të specializuara dhe ka nxjerrë PSO për policinë me MPMS-në, ndërsa Ministria e Drejtësisë ka ofruar financim të pjesshëm për strehimore me disa gjykatës të specializuar që u kanë dhënë prioritet rasteve të dhunës në familje.

9. Në përgjithësi, edhe pse ka përmirësime të përgjithshme në funksionimin e mekanizmave kundër dhunës në familje, e pasuar edhe me përmirësimet e pjesshme në implementim, megjithatë mbeten shume sfida në ofrimin e asistencës dhe mbrojtjes efikase për viktimat. Për shembull në vitin 2012 dhe 2013 Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ofruar trajnime gjithëpërfshirëse në ngritjen e reagimit ndaj dhunës në familje duke ofruar trajnime për nëpunësit socialë, mbrojtësit e viktimave, Policinë e Kosovës dhe punonjësit shëndetësorë, duke përfshirë shoqërinë civile në nivelet lokale për implementimin e Procedurave standarde operative. Gjithashtu janë shfaqur gjashtë filma në rajonin e Pejës rreth dhunës që bazohet në gjini, emisione në radio dhe trajnime të personelit mjekësorë se si t'i trajtojnë rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.⁷⁵ Megjithatë, këshilla do të ishte që institucionet të zhvillojnë edhe protokolle të shkurta dhe precize rreth mënyrës së trajtimit të rasteve të dhunës në familje edhe përtej Procedurave standarde operative.⁷⁶ Në veçanti institucionet duhet të synojnë që të rrisin llogaridhënien dhe

72 Diskutim i fokus grupit me zyrtarin e ndihmës juridike, Mekanizmi i koordinimit për dhunën në familje në komunat e Dragashit, Gjilanit dhe Gjakovës, 18 qershor 2015 në Prizren.

73 Intervistë e hulumtuesit me përfaqësuesin e UNICEF-it, korrik 2015.

74 Komunikim përmes postës elektronike në mes të hulumtuesit dhe përfaqësuesit nga komuna e Prishtinës, korrik 2015.

75 Intervistë me përfaqësuesin e OSBE-së, qershor 2015.

76 Diskutim të rekomandimeve të fokus grupit me anëtarët e nën-grupit punues për dhunën e bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtinë.

praktikuesit si policia, prokurorët dhe gjykatësit duhet të jenë në gjendje dhe të jenë aktivë që të ndëshkojnë mungesën e llogaridhënies në rastet kur rastet e dhunës në familje nuk adresohen si duhet. Për shembull do të ishte e rekomandueshme që dështimi nga ana e policisë, prokurorët dhe gjykatësit që të veprojnë shpejtë në rastet e dhunës në familje të raportohen menjëherë dhe të konsiderohen vepra penale në rast se nuk raportohen.⁷⁷

10. Në fund, koordinimi duket të mbetet sfida për funksionimin efektiv të mekanizmave institucionalë që ofrojnë asistencë dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Takimet ndër-ministrale për dhunën në familje nuk janë mbajtur në orare të rregullta siç parashihet në Termat e referencës të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar.⁷⁸ Për më tepër, mungesa e pronësisë dhe paqëndrueshmëria e zyrës së sekretariatit/logjistikës, që varet kryesisht prej donatorëve, duhet të jetë mësim i mësuar nga SKPVKDHF-ja e kaluar. Në këso raste, zgjedhja më e përshtatshme është përkrahja e pozitës së sekretariatit nga buxheti i Kosovës dhe të përcillen shembujt e radhitur nga mekanizmi kombëtar kundër trafikimit në Kosovë që ka caktuar një anëtar të përhershëm me orar të plotë që financohet nga qeveria për të mbështetur Koordinatorin kombëtar. Duhet të caktohet një pozitë e shërbyesit civil të kualifikuar për të siguruar vazhdimësinë ndërmjet ndryshimeve politike (shiko gjithashtu hulumtimin, e ardhshëm, të RRGK-së 2015).

c) Shërbimet për mbështetje, trajtim dhe riintegrim

Riintegrimi i viktimave të dhunës në familje duket të jetë sfida kryesore për të cilën janë pajtuar të gjithë pjesëmarrësit e vlerësimit. Në shumicën e rasteve viktimat varen nga anëtarët e familjes për shkak të mungesës së mundësive për punësim dhe praktikave diskriminuese sociale dhe tradicionale. Gjithashtu ekziston mungesa e asistencës afatgjate dhe shërbimet e rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje, ku shpesh viktimat lihen me mundësi të kufizuara për zgjedhje dhe detyrohen që të kthehen te partneri i tyre i dhunshëm.⁷⁹ Shpesh kjo shikohet gabimisht nga ana e institucioneve si pjesë e qëllimit për pajtim të viktimave.⁸⁰ Shërbimet e riintegritit po ashtu janë përcjellë edhe me mbështetje minimale buxhetore nga QK-ja. Për shembull në vitin 2012 qeveria kishte ndarë rreth 10% të fondeve për riintegrim me qëllim që të implementojë kornizën ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje. Kostot e rehabilitimit dhe riintegritit ishin vetëm 399.585 Euro prej 3,060,116 Euro apo 13% të ndara në vitin 2012.⁸¹

Disa komuna kanë qenë më aktive në mbështetjen e mekanizmave për Koordinim komunal për dhunën në familje të përkrahur nga Ekipi i KB-së në Kosovë. Megjithatë, të gjitha komunat duhet të synojnë mënyrat për gjetjen e vullnetit politik afatgjatë për mbështetjen e aktiviteteve të ndërlidhura me dhunën në familje, madje edhe pas përfundimit eventual të mbështetjes nga donatorët. Plani i ardhshëm i Veprimit duhet të përkrahë edhe krijimin dhe përsëritjen e këtyre modeleve në nivele komunale. Në fushat ku këto aktivitete mund të duken shume ambicioze, duhet të identifikohet bashkëpunim i veçantë rajonal i komunave dhe duhet të përpilohen memorandume mirëkuptimi për bashkëpunimin ndër-komunal. Ky aktivitet nuk është implementuar deri më tani. Me implementimin e këtij aktiviteti disa komuna mund ta mbulojnë nevojën për adresimin e financimit afatgjatë të strehimoreve dhe financimit të strehimoreve të përbashkëta

77 Komunikimi me postë elektronike me Këshilltarin për çështje gjinore në EULEX, korrik 2015.

78 Diskutim të rekomandimeve të fokus grupit me anëtarët e nën-grupit punues për dhunën e bazuar në gjini, 3 korrik 2015 Prishtinë.

79 Komunikimi me postë elektronike me Këshilltarin për çështje gjinore në EULEX, korrik 2015.

80 Po aty.

81 Rrjeti i Grave të Kosovës për Zyrën e UNDP-së në Kosovë, Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, fq.1 gjendet në <http://www.womensnet-work.org/documents/20130405120224756.pdf>

komunale. Kjo gjithashtu do të ishte në harmoni me kriteret e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Marrëveshjet ndër-komunale duhet të adresojnë edhe nevojën për financim të programeve për punësim dhe trajnime arsimore për viktimat e dhunës në familje.

Në fund, modeli komunal i mekanizmave të koordinimit për përpilimin e planeve komunale të veprimit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje duhet që posaçërisht të adresojë nevojat e viktimave të dhunës në familje për rehabilitim dhe riintegrim afatgjatë, përmes veglave të posaçme në dispozicion; këshillim, trajnim dhe mundësi të detajuara punësimi. Vetëm atëherë viktimat do të mund të fuqizoheshin dhe do tu jepej mundësia për punësim në mënyrë që të jenë në gjendje të gjejnë zgjidhje afatgjate, posa të kenë vendosur që të çlirohen nga situatat e rrezikshme të dhunshme në familjet e tyre.

Sfidat tjera: kalkulimet e buxhetit për SKPVKDHF-në e ardhshme

SKPVKDHF-ja e kaluar ishte bazuar vetëm në parashikime të përafërta të shpenzimeve buxhetore për implementimin e Planit të Veprimit duke ndarë gjithsej 2.414.560 € buxhet prej të cilave 1.612.854 € do të siguroheshin nga buxheti i Kosovës dhe 780.196 € nga donatorët ndërkombëtarë. Mungon kategorizimi specifik i shpenzimeve buxhetore ku te aktivitetet radhitën vetëm institucionet përgjegjëse dhe me disa shpenzime të aktivitetit dhe jo medoemos ofron institucionin specifik përgjegjës. Po ashtu afatet kohore janë të përgjithësuara pa kalkulime specifike. (Raporti i ardhshëm i RRGK-së 2015)

Kështu që, duhet të paraqitet një kalkulim gjithëpërfshirës i aktiviteteve të implementuara nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Koordinatorit kombëtar kundër Dhunës në Familje ashtu siç është paraqitur në Termat e Referencës,⁸² para procesit të përpilimit të Strategjisë dhe Planit të ri të Veprimit kundër Dhunës në familje të paraparë për fund të vitit 2015. Për shembull, vetëm në vitin 2011 QK-ja ka shpenzuar së paku 3,060,116 Euro për të adresuar kryesisht nevojat për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, prej të cilave më shumë se një milion Euro ishin siguruar nga donatorët (37.2%).⁸³

Për ta përmbledhur, shërbimet përkritazi me dhunën në familje në vitin 2011 i kanë kushtuar shtetit të Kosovës 1.76 Euro për kokë banori derisa 1.11 Euro për individë në taksa. Më shumë se 80% të kostove të mbuluara nga QK-ja drejtuar në aktivitetet që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe parandalimin. Kostot e ndara të rehabilitimit dhe riintegritit ishin vetëm 399.585 Euro prej 3,060,116 Eurove të ndara në vitin 2012. Kostot e dhunës në familje ishin parashikuar të jenë më të larta me futjen e Procedurave standarde operative, megjithatë nuk dihen kostot reale të qeverisë të dedikuara dhunës në familje për çdo vit, për shkak të mungesës së njohurive nga ana e institucioneve lidhur me përgjegjësitë dhe aktivitetet e plota që janë implementuara dhe që i janë raportuar rregullisht zyrës së Koordinatorëve kombëtarë. Në veçanti koordinimi i pamjaftueshëm në mes të zyrtarëve të buxhetit, programit dhe barazisë gjinore mbetet një vërejtje e valide.⁸⁴ Përveç kësaj, Strategjia dhe Plani i kaluar Kombëtar i Veprimit kundër Dhunës në familje kishte paraparë 2.414.560 € për planin e implementimit prej 48 muajsh. Kjo

82 Shiko TeR-të detyrat dhe përgjegjësitë, shtojca.

83 Rrjeti i Grave të Kosovës për Zyrën e UNDP-së në Kosovë, Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, fq.1 gjendet në <http://www.womensnet-work.org/documents/20130405120224756.pdf>

84 Rrjeti i Grave të Kosovës për Zyrën e UNDP-së në Kosovë, Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, fq.1 gjendet në <http://www.womensnet-work.org/documents/20130405120224756.pdf>

tregon se parashikimet buxhetore kanë qenë mjaft të ulëta krahasuar me shpenzimet vjetore të siguruara nga QK-ja për çdo vit e të cilat janë ofruar sipas kalkulimeve të hulumtimit të Rrjetit të Grave të Kosovës për shpenzimet buxhetore të lidhura me dhunën në familje në vitin 2011. Rekomandohet që në SKPVKDFH-në e ardhshme parashikimet të bëhen më të sakta në mënyrë që të reflektojnë shpenzimet reale të QK-së për aktivitetet e ndërlidhura me dhunën në familje në Strategjinë dhe Planin e ardhshëm të Veprimit.

V. PËRFUNDIM/RRUGA PËRPARA

Bazuar në të gjeturat e prezantuara më lartë, më tutje paraqiten disa prej opsioneve të politikave për tu adresuar gjatë përpilimit të Strategjisë dhe Planit të ri të Veprimit kundër Dhunës në familje:

- Indikatorët e paraqitur në tabelën e Planit të Veprimit janë vetëm të nivelit të aktivitetit, duke mos specifikuar nivelet e objektivit strategjik apo objektivave specifike. Kështu që ndikimet e matura mund të jenë vetëm afatshkurta përmes matjeve të nivelit të aktivitetit. Gjithashtu edhe hulumtimi i ardhshëm i RrGK-së për dhunën gjinore konfirmon se indikatorët e kanë dëshmuar të vështirë matjen e progresit, pasi që në implementimin e tyre ishin të përfshirë shumë aktorë.
- Nuk ka pasur mekanizëm qendror për mbledhjen e të dhënave e as për analizimin e tyre, përveç raportit të Koordinatorit kombëtar kundër Dhunës në familje të vitit 2012. Megjithatë, ushtrimi do të ishte mjaft ambicioz, pasi që ky mekanizëm i nivelit qendror është dashur që të merrte informata nga anëtarët e Grupit koordinues për implementimin e SKPVKDFH-së në baza të vazhdueshme dhe të rregullta çdo çerek mujorësh.
- Disa indikatorë i radhisin vetëm disa institucione si përgjegjëse në aspekt më të gjerë, siç janë “institucione lokale dhe qendrore” ose “aktorë privatë”. Pasi që asnjë institucion nuk është radhitur si agjenci me përgjegjësi parësore, kjo e ka vështirësuar monitorimin ose e ka krijuar mundësinë për përzierje të pjesshme në implementim me institucione tjera, duke përzier përgjegjësitë apo duke theksuar se nuk është kompetencë e tyre (hulumtimi, i ardhshëm, i RrGK-së 2015).
- Nevojiten aktivitete të mëtutjeshme për rritjen e vetëdijes së strukturave gjyqësore për standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe shfrytëzimit të ligjit sipas rasteve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.
- Implementimi i dy akteve kryesore nën-ligjore të miratuara për kryesit e dhunës në familje dhe trajtimi i tyre në rast se janë në varësi të drogës apo alkoolit ka pasur nivele minimale të implementimit për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës për implementimin e këtyre akteve specifike. Institucionet përgjegjëse gjegjëse siç është Ministria e Shëndetësisë duhet të ndajnë fondet e nevojshme dhe/apo infrastrukturën e nevojshme për implementimin e aktit nën-ligjor duke përfshirë edhe këtë aktivitet në Strategjinë dhe Planin e ri të Veprimit kundër Dhunës në familje.
- Në veçanti, institucionet gjithashtu duhet të synojnë rritjen e llogaridhënies për institucionet, praktikuesit si policia, prokurorët dhe gjykatësit të cilët duhet të jenë aktiv për të ndëshkuar për shkak të mungesës së përgjegjësisë kur nuk adresohen shpejtë rastet e dhunës në familje. Për shembull do të rekomandohej që këto krime të raportohen menjëherë dhe të konsiderohen si vepra penale në rast se nuk raportohen.
- Në disa raste indikatorët kanë dëshmuar se janë shumë të përgjithshëm dhe të vështirë për matje të mëtutjeshme, ato duhet të monitorohen rregullisht nga Zyra e Koordinatorit kombëtar dhe Sekretariati i tyre gjegjës. Për më tepër, mungesa e pronësisë dhe

paqëndrueshmëria e zyrës së sekretariatit/logjistikës, që varet kryesisht prej donatorëve, duhet të jetë mësim i mësuar nga SKPVKDFH-ja e kaluar. Në këso raste, zgjedhja më e përshtatshme është përkrahja e pozitës së sekretariatit nga buxheti i Kosovës dhe të përcillen shembujt e radhitur nga mekanizmi kombëtar kundër trafikimit në Kosovë që ka caktuar një anëtar të përhershëm me orar të plotë që financohet nga qeveria për të mbështetur Koordinatorin kombëtar. Duhet të caktohet një pozitë e shërbyesit civil të kualifikuar për të siguruar vazhdimësinë ndërmjet ndryshimeve politike (hulumtimi, i ardhshëm, i RrGK-së 2015).

- Parashikimi i buxhetit duhet të jetë real dhe i saktë. Buxheti i paraqitur për implementimin e planit tregon mospërputhje për kostot e ofruara për vitin 2011 nga qeveria e Kosovës për implementimin e kornizës ligjore. Shumica e aktiviteteve të paraqitura në planin e Veprimit reflektohen edhe në kornizën ligjore të analizuar dhe paraparë nga raporti i RrGK-së “Me çfarë kosto?” Parashikimet e buxhetit për Planin e ardhshëm të Veprimit duhet që rrjedhimisht të jenë në harmoni me këto parashikime si dhe të jenë më të sakta.
- Plani në përgjithësi nuk duhet të varet në mbështetjen nga donatorët dhe/ose OJQ-të, mirëpo qeveria fillimisht duhet të ndajë burime adekuate për implementimin e tij. Kolonat që janë quajtur ‘pa kosto’ duhet të largohen, pasi që të gjitha aktivitetet do të kenë një kosto dhe duhet të bëhet vlerësimi i saktë i kostos (për më shumë informata shiko edhe Raportin e Rrjetit të Grave të Kosovës “Me çfarë kosto?: Alokimet buxhetore për zbatimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje, 2013).

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

Niveli i implementimit për Planin e veprimit për dhunën në familje (2011-2014)⁸⁵

OBJEKTIVA STRATEGJIKE	OBJEKTIVA SPECIFIKE	AKTIVITETET	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE & MBËSHTETËSE	AFATI KOHOR	BUXHETI	INDIKATORËT E MONITORIMIT	NIVELI I IMPLEMENTIMIT
1. Deri në vitin 2014, të krijohen mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje	1.1. Të hartohen politika në nivelin lokal dhe qendror për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje.	1.1.1. Zhvillimi i programeve për psikolog në shkolla	MASHT, MEZh, grupi punues	2011-2012	7000 € BK	- Programi është zhvilluar - Raportet nga grupet punuese	Implementim i pjesshëm Programi do të zhvillohet Pedagogët e shkollës janë larguar Psikologu i fëmijëve është caktuar vetëm në disa komuna
		1.1.2. Hartimi i programeve për nëpunësit social. MPMS-ja prej vitit 2006 ka përpiluar doracakun profesional për zyrtarët e Shërbimeve sociale “Reagimi ndaj rasteve të dhunës në familje”, që ishte përpiluar nga MPMS-ja në bashkëpunim me OSBE-në.	MPMS		70.000€	MPMS të organizojë trajnime për zyrtarët e Shërbimeve sociale; ndanë 70.000€	Licencimi i nëpunësve social ka përfunduar Standardet minimale për asistencë për viktimat e dhunës në familje janë përcaktuar (ndërmjet 5 standardeve për shërbime sociale) Trajnimet janë kryer nga MPMS –ja për standardet minimale Performanca dhe njohuri për ligjet nga ofruesit shërbimeve mbetet e ulët (hulumtimi, i ardhshëm i RrGK-së, 2015).
		1.1.3. Inkuadrimi i 80 pedagogëve dhe psikologëve në komuna	MASHT, komunat, Departamentet arsimore komunale	Viti akademik 2011-12	34.560 € BK	Numri i psikologëve dhe pedagogëve Numri i shkollave pilot me psikologë	Pedagogët e fëmijëve janë larguar/licencimi në proces Numri i ulët i psikologëve në komuna
		1.1.4. Futja e kurrikulës me tema rreth dhunës në familje dhe marrëdhëniet familjare në departamentin e psikologjisë.	Fakulteti i Filozofisë	Viti akademik 2011-12	21.600 € Universiteti 21.600 € Universiteti	Kurrikula është miratuar	Kurrikula e shkollës fillore adreson barazinë gjinore dhe dhunën kundër grave shkurtimisht në librin E Drejta Qytetare. Duhet të kryhet vlerësimi i hollësishëm i cilësisë dhe ndikimit të kurrikulës (MASHT intervista në pritje)
	1.2. Të sensibilizojë shoqërinë rreth dhunës në familje.	1.2.1. Organizimi i fushatave për informim të publikut të përqendruar në dhunën në familje.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MD Institucionet qendrore dhe lokale (Ministritë dhe komunat) OJQ-të, donatorët, media	2011-14	5.000 € 1.500€ 29.900€ € Institucionet përgjegjëse	Numri i fushatave për informim të publikut të përgatitura Ndikimi në publik	Janë ofruar 16 ditë të fushatave vjetore të rregullta për aktivizim nga Agjencia për Barazi Gjinore, zyrtarët gjinor komunal, nëpunësit social, mekanizmat për koordinim komunal rreth DhF. Mungesë e njohurisë gjithëpërfshirëse në të gjitha aktivitetet e kryera gjatë 16 ditëve të fushatave të aktivizimit. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ofruar trajnime për gazetarët, megjithatë trajnimi i ofruar është i

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

							kufizuar te rolet model të burrave për vetëdijesim ndaj dhunës në familje Fokusim i madh vetëm në një periudhë të ngritjes së vetëdijes d.m.th. ngjarja e aktivizimit 16 ditësh, duhet të jetë i vazhdueshëm
		1.2.2. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e komunitetit dhe subjekteve relevante (media, institucionet qendrore dhe lokale, OJQ-të)	MD Institucionet qendrore dhe lokale (ministritë dhe komunat) OJQ-të, donatorët (UN Women), Asociacioni i i Pavarur i Gazetarëve, mediet	2011-14	1.000€ për vit	Numri i tryezave të rrumbullakëta të organizuara Numri i pjesëmarrësve Ndikimi i ngjarjeve në prani të medieve Ndikimi publik (vlerësimi i ndikimit publik)	E PËRFUNDUAR PËSËRISHT: ABGJ ka organizuar diskutime për të prezantuar SKPVKDHF-në; ka lëshuar fushatë 16 ditore dhe ka shpërndarë 60 posterë; Zyrtarët gjinor komunal gjithashtu organizuan me CSOs dhe donorët. Disa nisma por zakonisht përgjatë 16 ditëve të ngjarjes së aktivizimit.
	1.3. Të krijohet mekanizma për edukim dhe ngritje të vetëdijes tek të rinjtë për dhunën në familje	1.3.1. Në përbajtjen e programit për fëmijët në radio dhe TV të përfshihet çështja e dhunës në familje.	Media, gazetarët, donatorët (UNICEF; UNDP; UNWomen), MCYS, Teatrot, ABGJ	2011-2013	Pa kosto	Numri i programeve, shkrimeve, artikujve, kolumnave, shfaqjeve teatrale dhe dokumentarëve të implementuara deri më tani	Ky aktivitet nuk paraqet kosto dhe nuk ka vlerësim të qartë dhe specifik. Hulumtimi i ardhshëm i RrGK-së 2015 sugjeron që kostot të vlerësohen si duhet, madje edhe për fushatat për informim të publikut të kryera me Radio Televizionin e Kosovës si transmetues publik, për shkak të mungesës së ekspertizës për të prodhuar emisione të tilla. Disa OJQ prodhuan shfaqje teatrale për rritjen e vetëdijes rreth dhunës, por jo duke i pasur fëmijët si objektiv të posaçme.
	1.4. Të rritet numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje	1.4.1. Përditësimi i bazës aktuale të të dhënave, duke përfshirë kontributin e institucioneve tjera, me përjashtim të MPMS-së, MD-së	Policia, prokurorët publik, gjykatat, qendrat për punë sociale, strehimoret, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, donatorët	2012-2014	150.000 € Donatorët	Baza e të dhënave është përditësuar Numri i rasteve dhe procesverbalet janë regjistruar Raportet që bazohen në informata dhe shënime, Numri i politikave që ndikohen nga shënimet e mbledhura	Baza e të dhënave e MPMS-së ekziston, megjithatë nuk përdoret bashkërisht nga agjencitë që u ofrojnë asistencë viktimave të dhunës në familje Institucionet mbajnë procesverbale të veta, kurse mbrojtësi i viktimës, njësi i asistencës dhe Policia e Kosovës i publikojnë procesverbalet. Nuk janë përdorur shënime të qarta dhe të përbashkëta për të avokuar për politikën e monitorimit (hulumtimi, i ardhshëm i RrGK-së, 2015)

85 Plani i veprimit është marrë nga origjinali i Strategjisë dhe Planit të veprimit kundër dhunës në familje 2011-2014, gjendet në <http://abgi.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

		1.4.2. Edukimi i popullatës rreth raportimit të dhunës në familje	ABGJ, Media, shkollat, komunat	2011-2013	Pa kosto	Raportet nga vlerësimi i ndikimit Numri i rasteve të raportuara	Fushatat janë organizuar dhe ofruar nga aktorët kryesorë, megjithatë kryesisht janë përqendruar vetëm në datat 16 ditore të fushatës së aktivizimit.
		1.4.3. Informimi i popullatës rreth institucioneve ku mund të raportojnë dhunën në familje	Policia, MD, media, Komisioni për ndihmë ligjore, ABGJ, shkollat, Qendrat për punë sociale, komunat, donatorët	2011-2013	Pa kosto	Fushata për ngritjen e vetëdijes Numri i broshurave Numri i publikimeve Transmetimet në TV	Policia e Kosovës u ofron viktimave fletushkat e dhura rreth rastit që i raportohet policisë. Përveç kësaj, OJQ-të ofrojnë informata të tilla Gjithashtu Policia e Kosovës nuk ofron në të gjitha zonat intervista për viktimat e DhF-së me zyrtare femra të policisë. Për shembull komuna e Dragashit. Informimi duhet të ofrohet në baza të rregullta e jo vetëm gjatë fushatave 16 ditore të aktivizimit.
		1.4.4. Ta zhvillojë më tutje kapacitetin e PK-së me qëllim të ndryshimit të qasjes ndaj dhunës, viktimave dhe keqbërësve	Policia	2011-2013	Pa kosto	Numri i rasteve të adresuara nga policia	Parashikimet e kostos nuk ishin të sakta dhe precize, duke e bërë monitorimin të vështirë Policia e Kosovës e ka bërë ndarjen specifike të kostove për Njësitin e DhF-së. Trajnimet janë të obligueshme për oficeret e PK-së. Disa oficerë të policisë duket të demonstrojnë kapacitete të përmirësuara krahasuar me hulumtimin të linjës bazë të RrGK-së në vitin 2008. Megjithatë, në disa rajone oficerët e njësitit të policisë për dhunën në familje nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim tjetër përveç kursit për Dhunë në familje në akademi (hulumtimi, i ardhshëm i RrGK-së, 2015) E përfunduar pjesërisht E paqartë
2. Të arrijë që, deri në vitin 2013, të ketë mekanizma efikas mbrojtës për viktimat e dhunës në familje.	2.1. Të sigurojë shërbime efikase për mbrojtje fizike të viktimave të dhunës në familje në tërë territorin e Kosovës.	2.1.1. Të kryej studim për hartën e mbulimit të shërbimit për viktimat e dhunës në familje	ABGJ, Policia, strehimoret, në bashkëpunim me institucionet, OJQ-të, donatorët	2011	25.000 € OJQ-të Donatorët	Studimi është kryer Të gjeturat dhe rekomandimet	Ekzistojnë disa studime, megjithatë pa ndonjë fokus të përpiktë.
		2.1.2. Zhvillimi i vendbanimeve sociale për	Ministria e Financave, komuna, donatorët	2011-14	500.000 € Donatorët	Fondet të ndara Numri i	Implementim i kufizuar

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

		strehim dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje			komunat MEF-i	apartamenteve të ndërtuara Numri i viktimave të strehuara Numri i vendimeve të marra për dhënien e lejes për strehim është ndërtuar	Disa komuna, në bazë të vullnetit të mirë të kryetarëve dhe drejtorëve të drejtorive, e kanë implementuar këtë kusht Ekziston mungesë e përgjithshme e njohurisë rreth ekzistimit të SKPVKDHF-së në mesin e zyrtarëve komunal Ekziston përzierje kompetencash në implementim ndërmjet Planit gjinor të veprimit dhe SKPVKDHF-së Implementimi i vendbanimit social i njohur në disa komuna vetëm si në Prizren, Podujevë që ka pëe objektivë vetëm ish viktimat e dhunës në familje, posaçërisht komunat që kanë mekanizma të koordinimit për DhF-në ndajnë linja të përshtatshme buxhetore për mbështetjen e viktimave. Vendbanimi social mbetet një zbrazëti e përgjithshme
		2.1.3. Krijimi i një mekanizmi të bashkëpunimit ndërmjet komunave, me qëllim të ofrimit të strehimit për viktimat e dhunës në familje	Komunat strehimoret	2011	Pa kosto Strehimoret, Komunat	MiM-i është implementuar	Nuk është implementuar
2.2. Të ndërtojë kapacitete të palëve të interesit (policia, prokuroria, gjykatat dhe qendrat për punë sociale) për trajtimin e dhunës në familje	2.2.1. Organizimi i trajnimeve për rreth (150 pjesëmarrës) – gjykatësit, prokurorët, policia, mbrojtësit e viktimave, nëpunësit shëndetësor dhe social, personeli i arsimit, zyrtarët e ndihmës ligjore	IKAP, ABGJ, Drejtësia e Kosovës, Akademia policore e Kosovës, institucionet qendrore, IGJK, donatorët		2011-2014	200.000 € Donatorët Institucioni përgjegjës 11.734€	Numri i trajnimeve të organizuara Numri i pjesëmarrësve Numri i moduleve të përgatitura	Është organizuar një numër trajnimesh që janë ofruar nga ana e Agjencisë për Barazi Gjinore, Instituti Gjyqësor i Kosovës (intervista në pritje), VAAU, UNKT/UN Women, mekanizmat e koordinimit për DhF-në në tri komuna, etj. Vizitë studimore për hetuesit të policisë nga veriu dhe jugu, trajnim i avancuar për menaxhimin e lëndëve të organizuar nga UN Women Nuk është i qartë institucioni përgjegjës – vështirë të monitorohet Nr. i moduleve të përgatitura do të konfirmohet (intervista me IGJK-në në pritje)

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

						Gjatë viteve 2011-2014 MPMS-ja ka ofruar dy kopje origjinale të PSO-ve për 38 komuna, që në total ka arritur 80 kopje të shpërndara Në vitin 2014, Agjencia për Barazi Gjinore bashkë me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe përkrahjen e MPMS-së dhe palëve tjera të interesit i kanë trajnuar më shumë se 200 nëpunës social, zyrtarë policie dhe mbrojtës të viktimave rreth përmbytjes dhe procedurave të dokumentit Procedurat standarde operative. Nivel i kënaqshëm i implementimit
		2.2.2. Dhënia e pajisjeve të nevojshme (komunikimet, automjetet dhe telefonat) me qëllim të adresimit të rasteve të dhunës në familje.	MEF-i, MPMS-ja, Policia, komunat, donatorët, (UNDP), UN Women, operatorët privat, MD, MAP	2011-2014	100.000 € Buxheti vjetor i Kosovës. Donatorët 2. Shpenzimi i karburanteve. Mirëmbajtja e automjeteve ekzistuese për një vit) 29.000 €	Numri i njësive dhe pajisjeve të ofruara Rritja e performancës së personelit në trajtimin dhe adresimin e rasteve të dhunës në familje Shfrytëzimi i kufizuar i dhomave të përshtatshme për fëmijët Vështirë të monitorohet ndikimi i cilësisë, informatat gjithashtu janë në pritje të hulumtimit të ardhshëm të RRGK me respondentët e viktimave (2015)
						Dhomat e përshtatshme për fëmijët për intervistë janë në dispozicion, megjithatë nuk shfrytëzohen shpesh m2 në dispozicion nuk është i ditur Rajonet kanë mungesë transportimi, përjashtim bëjnë policia Komuna e Prishtinës ka kontraktuar shërbimin e taksisë për të përkrahur QPM-të për nevojat e transportimit për intervista QPM-të akoma ankohen për mungesë transporti në përgjithësi dhe pako asistence për viktimat e dhunës në familje gjatë fazës së parë fillestare të
		2.2.3. Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme për palët e interesit që t'i trajtojnë rastet e dhunës në familje nga raportimi në proces gjyqësor.	MEF-i, MPMS-ja, MD-ja, Policia, gjykatat, prokurori publik, qendrat e punës sociale, OJQ-të	2012-2013	92.000 € vjetore	Hapësira e siguruar (m²/për çdo anëtar të personelit dhe viktimë) Komuna e Prishtinës ka kontraktuar shërbimin e taksisë për të përkrahur QPM-të për nevojat e transportimit për intervista QPM-të akoma ankohen për mungesë transporti në përgjithësi dhe pako asistence për viktimat e dhunës në familje gjatë fazës së parë fillestare të

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

							intervistës. Dhomat e përshtatshme për fëmijët për intervistë të përkrahura nga donatorët me policinë e Kosovës nuk shfrytëzohen mjaftueshëm.
	2.3. Të sigurojë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje	2.3.1. Përgatitja e broshurave, fletëpalosjeve me qëllim që të informojë qytetarët për ndihmë ligjore	Komisioni për ndihmë ligjore, MD-ja, Kuvendi	2011-2013	5.000 € vjetore		Ligji mbi Ndhimën Juridike Falas i kategorizon viktimat e dhunës në familje si kategori që iniciojnë procedurën për ndihmë juridike falas Numri i zyrave për ndihmë juridike mbetet i kufizuar, pasi që 5 zyra të përkrahura nga zyra e UNDP-së në Prishtinë janë mbyllur Vlerësimet e koston së planit nuk kanë qenë reale dhe SKPVKDDHF-ja e ardhshme duhet gjithashtu të reflektojë nevojën që të kalkulojë sërish mbështetjen për rihapjen e 5 zyrave për ndihmë juridike falas dhe avancimin e qasjes së viktimave të dhunës në familje posaçërisht në zona rurale. Nr. i indikatorëve të matjes duhet të adresohet në Planin e ardhshëm të veprimit.
		2.3.2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të institucioneve të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje	Komisioni i ndihmës juridike, institucionet, OJQ-të	2011	Pa kosto	Numri i marrëveshjeve të implementuara Numri i institucioneve të përfshira	PSO-të janë përpiluar dhe miratuar Dokument parësor duhet të jetë PSO-ja E kryer
		2.3.3. Zhvillimi i SPO-ve për trajtimin e viktimave të dhunës në familje.					E kryer: PSO-të të përpiluara dhe miratuara nga QK-ja.
		2.3.3.1. Përpilimi i procedurave standarde operative për trajtimin e viktimave të dhunës	MD-ja, MPMS-ja, grupi punues, përfshirë institucionet qendrore dhe ekspertët	2011	12.000 € Donatorët Komisioni Evropian	PSO-të për trajtimin e viktimave dhe keqbërësve janë miratuar	Njëjtë si më lartë Gjithashtu janë miratuar nga MPMS-ja standardet minimale për asistencë të viktimave të dhunës në familje
		2.3.3.2. Përpilimi i standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, MPMS-ja					E kryer
3. Të sigurojë shërbime efikase për rehabilitimin dhe rinintegrimin e viktimave dhe kryerësit e dhunës në familje	3.1. Të ndërtojë dhe forcojë kapacitetet e nëpunësve për përkujdes shëndetësor, shërbimeve sociale dhe personelit	3.1.1. Zhvillimi i protokollit mjekësor për trajtim të rasteve të dhunës në familje.	MSH-ja, ekspertët, OJQ-të, donatorët	2011-2014	3.000€	Protokolli mjekësor është miratuar	E kryer Trajnimi i trajnuesve i ofruar nga MSH-ja dhe UNFPA, RRGK-ja gjithashtu e ka mbështetur

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

në tërë territorin e Kosovës.	arsimor për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje						150 nëpunës shëndetësor janë trajnuar nga UNFPA-ja sipas doracakut të zhvilluar nga UNFPA-ja, RRGK-ja dhe përkrahja e MSH-së. TIT-i është mbajtur në nivel kombëtar dhe tri trajnime janë mbajtur në komunat e Gjakovës, Gjilanit, Dragashit/Prizrenit dhe Pejës. Përveç kësaj, UNFPA-ja ka mbajtur edhe seanca për rritjen e vetëdijes me komunitetet fetare (gjithsej 4 punëtori) rreth qëndrimeve fetare ndaj dhunës në familje në nivel kombëtar dhe në komunat e Gjakovës, Gjilanit, Dragashit/Prizrenit. Mitrovica e Veriut mbetet sfidë Gjithashtu nuk ka sistem koherent të drejtësisë në Kosovën veriore ku PK-ja është integruar, megjithatë gjykatësit dhe prokurorët së voni janë integruar. Ekzistojnë gjithashtu dy QPS paralele që operojnë në veri të Kosovës të cilat shkaktojnë huti të të mbijetuarit e dhunës në familje. Ende nuk ekziston strehimore në pjesën veriore të Kosovës. Është vetëm një avokat në dispozicion në Mitrovicën e jugut që e flet gjuhën serbe.
		3.1.2. Trajnimi i personelit për përkujdes shëndetësor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje (trajnimi i rreth 150.000 personave që punojnë në sektorin e shëndetësisë dhe shërbimeve)	MSH-ja, OJQ-të	2011-2014	37.000€	Numri i personelit të trajnuar	TIT-i është kryer (numri i saktë pritet të dërgohet nga UNFPA-ja)
		3.1.3. Trajnimi i personelit të shtëpive të strehimit për identifikimin e rasteve klinike	OJQ-të, strehimoret, MPMS-ja, MSH-ja	2011-2014	200.000 €	Numri i trajnimeve Numri i pjesëmarrësve në trajnim	700 pjesëtarë të personelit për përkujdes shëndetësor janë trajnuar deri më tani nga MSH-ja.
		3.1.4. Trajnimi i personelit të shtëpive të strehimit për	MSH-ja, ekspertët, OJQ-të, donatorët			Numri i trajnimeve Numri i	RRGK-ja nuk ka hasur ndonjë mjek të trajnuar gjatë vlerësimit (hulumtimi i ardhshëm 2015)
							Trajnimi ofrohet vazhdimisht për

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

	mbrojtje nga STD-të dhe HIV-i				pjesëmarrësve në trajnim	personelin e strehimoreve E kryer
	3.1.5. Trajnimi i gazetarëve për raportimin e dhunës në familje	Asociacioni i gazetarëve, OJQ-të, ekspertët, donatorët	2011-2014	80.000 €	Numri i trajnimeve Numri i pjesëmarrësve në trajnim	Ad hok jo i vazhdueshëm Një i identifikuar deri më tash që është mbajtur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë Informatat tjera mungojnë
	3.1.6. Trajnimi i nëpunësve social në Qendrat e punës sociale për çështjet që ndërlidhen me dhunën në familje	Qendrat për punë sociale OJQ-të Donatorët	2011-2014		Numri i trajnimeve Numri i pjesëmarrësve në trajnim	Trajnimet e rregullta të ofruara nga MPMS-ja përfshirë standardet minimale për ofrimin e shërbimit social për viktimat e dhunës në familje Niveli i cilësisë jo i kënaqshëm sa i përket performancës së QPM-ve (hulumtimi i ardhshëm i RRGK-së dhe përfundimet e vlerësimit të hulumtimit)
3.2. Të përmirësoj politikat për mbështetje ekonomike për viktimat dhe kryerësit e dhunës.	3.2.1. Zhvillimi i programeve ekonomike në bashkëpunim me donatorët dhe operatorët privatë, bankat dhe bizneset.	MZHE-ja, MPMS-ja, ABGJ-ja, MF, Donatorët	2012-2014		Numri i viktimave të përkrahura Shuma e granteve të miratuara	Nuk ka programe të qëndrueshme për zhvillim ekonomik që janë ndërmarrë nga QK-ja për hartimin e tyre (vetëm nisma ad hok)
3.3. Të ndërtojë dhe forcojë shërbimet sociale (shëndetësore, arsimore, sociale, ekonomike, juridike) për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje	3.3.1. Ekzaminime mjekësore falas për viktimat e dhunës familjare, të akomoduar në strehimore	MSH-ja, MD-ja, strehimoret, donatorët, operatorët privatë	2011-2014	Pa kosto	Numri i viktimave të ekzaminuara	E kryer Ofruar rregullisht
	3.3.2. Përkujdes shëndetësor dhe shërbimet sociale për personat me nevoja të veçanta dhe viktimat e dhunës në familje	OJQ-të, MSH, Donatorët, Qendrat e shëndetit mendor	2011-2014	Pa kosto	Numri i personave me nevoja të veçanta të ndihmuar	Është ofruar përkujdes shëndetësor falas dhe shërbime sociale Nevojitet vlerësim i mëtejshëm i cilësisë
	3.3.3. Trajnimi profesional për viktimat e dhunës në familje	MPMS-ja, MASHT-i, OJQ-të, Qendrat për punë sociale, donatorët, Qendrat e bizneseve për informim profesional	2011-2014	40.000 € Çdo vit	Numri i përfutuesve Numri i personave të punësuar	Në komunën e Prishtinës janë trajnuar vetëm 6 femra. Nevojiten informata tjera Ky indikator mbetet sfidë, pasi mungon një program i qëndrueshëm i hartuar nga qeveria. Gjithashtu bizneset që ofrojnë punësim për viktimat nuk gëzojnë asnjë status të përfutiesit sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë
	3.3.4. Ndërmjetësimi i punësimit të viktimave të dhunës në familje	DPP- MPMS-ja, Qendrat rajonale të punësimit	2011-13	Pa kosto	Numri i personave të punësuar	Strehimoret e ofrojnë këtë shërbim në baza ad hok

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

							Implementim i pjesshëm, pasi që ai duhet të institucionalizohet
		3.3.5. Shërbimet sociale për viktimat e dhunës në familje të ndërlidhen me programet për fuqizimin e familjes	MPMS-ja, Qendra për punë sociale, Fshati SOS – programi për fuqizimin e familjes, donatorët	2011-13	Pa kosto	Numri i programeve Pasqyra gjeografike e programeve Familjet përfituese	Nuk dihet nëse ka ndodhur
4. Rehabilitimi dhe riintegrimi i përhershëm o viktimave të dhunës në familje	4.1. Ofrimi i shërbimeve të rehabilitimit/trajtim shëndetësor dhe psikologjik si dhe strehimi i viktimave të dhunës në familje	4.1.1. Ofrimi i shërbimeve rehabilituese dhe psikologjike në strehimoret e viktimave të dhunës në familje.	MPMS-ja, OJQ-të – strehimoret, komunat. QPS-ja (Qendra për punë sociale)	2011-13	800.000 €	Një numër i viktimave përfitojnë nga këto shërbim, gjashtë strehimore të kontraktuara nga MPMS-ja	Strehimoret i ofrojnë rregullisht këto shërbime
		4.1.2. Ofrimi i shërbimeve dhe këshillimit juridik falas për viktimat e dhunës në familje dhe ofrimi i mbrojtjes juridike falas për këto viktimat.	Ministria e Drejtësisë, mbrojtësit e viktimave, policia, gjykatat, QPS-të	2011 -2014		Një numër i viktimave përfitojnë shërbime juridike falas	VAAD janë përfaqësues të autorizuar të viktimave në gjykata
		4.1.4 Ofrimi i shërbimeve dhe kualifikimeve profesionale për viktimat e dhunës në familje	MASHT-i, drejtorët e arsimit në komuna, QPS-të, MPMS-DPP, Zyrat rajonale të punësimit	2011 -2014			Indikatori dhe numrat janë të paqarta këtu për qëllime monitorimi.
							Strehimoret i kanë ofruar këto shërbime përkrahjen nga disa donatorë.
			KOSTOJA TOTALE : BUXHETI I KOSOVËS: DONATORËT: TJERË (UT PRIVAT):		2. 414.560 € 1.612.854 € 780.106€ 21.600 €		

RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË KOSOVËS KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2011-2014

Bibliografia:

Raportet

Anketë studimore bazë për DhBGj dhe dhunën në familje në komunat Dragash, Gjilan dhe Gjakovë, 2013, UNICEF.

Plani i veprimit për partneritet evropian, dhjetor 2012, gjendet në http://www.mei-ks.net/repository/docs/Eu-ropean_Partnership_Action_Plan_2012.pdf

Doracak mbi drejtësinë për viktimat: mbi përdorimin dhe aplikimin e Deklaratës e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit,” Zyra e KB-së për Kontrollimin e drogës dhe parandalimin e Krimit, gjendet në https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/UNODC_Handbook_on_Justice_for_victims.pdf

Rrjeti i Grave të Kosovës për Agjencinë për Hulumtim të Barazisë Gjimore,Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje, 2008. gjendet në <http://www.womensnetwork.org/documents/20130120165404373.pdf>.

RRGK “Më shumë se vetëm fjalë?: Përgjigja e organeve të drejtësisë ndaj dhunës në familje në Kosovë”, 2009 gjendet në <http://www.womensnetwork.org>.

Rrjeti i Grave të Kosovës për Zyrën e UNDP-së në Kosovë, Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë, fq.1 gjendet në <http://www.womens-network.org/documents/20130405120224756.pdf>

Programi i Kosovës dhe Plani i veprimit kundër dhunës në familje 2011-2014, gjendet në faqen e internetit të Agjencisë për Barazi Gjimore <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimit.pdf>

Zyra e Koordinatorit Nacional kundër dhunës në familje, Raporti vjetor i progresit për aktivitetet kundër dhunës në familje, publikuar në maj 2013. Shiko fq. në http://www.md-ks.net/repository/docs/Final_English_APR_DV.pdf

Studimi i Ulf Farnsveden, Ariana Qosaj-Mustafa dhe Nicole Farnsworth; “Profilu gjinor i shtetit të Kosovës,” fq. 2, financuar nga Suedia gjendet në http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF

UNFPA “Hulumtim për ndikimin e dhunës në të drejtat riproduktive të grave në Kosovë (2008).

Legjislacioni

UA Nr. 12/2012, gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UA_per_trajtimin_psiko-social_te_kryersve_te_dhunes_ne_familje_10.09.pdf.

UA Nr. 02/2013, gjendet në: <http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Udhezim%20Administrativ%2002-2013.pdf>.

ABGJ Komentari i Ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje, gjendet në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Komentari%20i%20Ligjit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje%20-Shqip.pdf>

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. KI 41/12 me aplikantit Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe Termat e Referencës për caktimin e Koordinatorit nacional kundër dhunës në familje, të miratuar më 11.07.2012, me vendimin Nr. 04/83

Ligji kosovar për mbrojtjen kundër dhunës në familje Nr.03/L-18, gjendet në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, takimi i 58^{te} i KGJK-së, mars 2012

Ligji kosovar për shërbime sociale dhe familjare, 2005. Gjendet në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf

Ligji kosovar për ndihmë juridike falas, gjendet në [http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ndihme_juridike_falas_\(anglisht\).pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ndihme_juridike_falas_(anglisht).pdf)

Kodi Penal i Kosovës dhe Procedura e Kodit Penal, gjendet në www.legislationline.org/documents/id/17771

Procedurat Standarde Operative (PSO) për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë, miratuar në 2013. Gjendet në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Procedurat_Standarde_te_Veprimit_per_Mbrojtje nga_Dhuna_ne_Familje.pdf

Mbrojtja e viktimave dhe zyra ndihmëse, në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Declaration_of_damages.pdf

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje, gjendet në http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2003regs/RE2003_12.pdf

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, gjendet në <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm>

SHTOJCË:

- I. Shiko Skemën organizative të koordinimit, monitorimit dhe implementimit të mekanizmave kundër dhunës në familje në Kosovë – Struktura institucionale strategjike dhe operationale. Që gjendet në Zyrën e Koordinatorit nacional kundër dhunës në familje, Raporti vjetor i progresit për aktivitetet kundër dhunës në familje, publikuar në maj 2013. Në fq. 11 http://www.md-ks.net/repository/docs/Final_English_APR_DV.pdf. Financuar nga projekti i UNDP-së Iniciativa për sigurinë e grave.
- II. Vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe Termat e referencës për caktimin e Koordinatorit nacional kundër dhunës në familje, miratuar më 11.07.2012, me vendimin Nr. 04/83.
- III. Raportet e Policisë së Kosovës për rastet e dhunës në familje: vitet 2011, 2012, 2013, 2014
- IV. Lista komunale e respondentëve
- V. Lista qendrore e respondentëve




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Zëvendësministri i Drejtësisë emërohet Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje.
2. Koordinatori ka përgjegjësinë për udhëheqjen e procesit të zbatimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit për vitin 2011-2014, të miratuar nga Qeveria më 25 gusht 2011.
3. Koordinatori udhëheq me Grupin Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje në këtë përbërje:
 - 3.1. Zyra e Kryeministrit-Agjencia për Barazi Gjinore zëvendës-kryesues;
 - 3.2. Ministria e Drejtësisë, anëtar;
 - 3.3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 3.4. Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 3.5. Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 3.6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar;
 - 3.7. Ministria e Financave, anëtar;
 - 3.8. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;
 - 3.9. Policia e Kosovës, anëtar;
 - 3.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar;
4. Në cilësinë e eksperteve dhe vëzhguesve ftohen:
 - 4.1. Prokuroria e Shtetit, anëtar;
 - 4.2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;
 - 4.3. Instituti Gjyqësor i Kosovës, anëtar;



Shkresë Shpjeguese.
Emërimi i Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në nenin 27 të tij e ka obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës në hartimin e Programit Kundër Dhunës në Familje. Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin e Kryeministrit është angazhuar për hartimin e dokumentit dhe implementimin e programit dhe ka caktuar Agjencinë për Barazi Gjinore bartëse e këtij procesi .

Agjencia për Barazi Gjinore ka përfshirë në hartimin e këtij dokumenti përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale angazhimi i të cilave nuk është parë vetëm si faktorë që ndikon në cilësinë e dokumentit por një mundësi që të gjithë akterët e përfshirë të kuptojnë se çfarë duhet ,dhe çfarë mundë të bëjnë për të luftuar dhe adresuar dhunën në familje.

Programi shërben si udhëzues nacional për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, për parandalimin, sigurinë, drejtësinë dhe trajtimin e viktimave por edhe të abuzuesve të dhunës në familje.

Programi i ngërthen në vete tre shtylla kryesore si: Parandalimi ,Mbrojtja dhe Siguria, Përkrahja , trajtimi dhe Riintegrimi.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar Programin Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit me dt 25.08.2011.

Sipas Programit , autoriteti më i lartë institucional në këtë fushë do të jetë Koordinatori Nacional.

Detyrë e Koordinatorit Nacional do të jetë koordinimi, bashkërendimi, monitorimi dhe raportimi i implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në Programin Kundër Dhunës në Familje .

Koordinatori Nacional do të mbështetet nga Sekretariati, detyrë themelore dhe përgjegjësi e të cilit është mbledhja e informacioneve dhe e të dhënave nga institucionet tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

Emërimi i Koordinatorit Nacional, do të mundësonte edhe realizimin e shumë aktiviteteve tjera të parapara në këtë dokument strategjikë siç janë hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit në nivelin nacional për viktimat e dhunës në familje.

Rekomandimi për tu emëruar sa më shpejtë që është e mundur Koordinatori Nacional del edhe nga shumë tryeza diskutimi të OJQ vendore dhe ndërkombëtare duke përfshirë këtu edhe rekomandimet që kanë dal nga Kuvendi i Kosovës.

Po ju drejtohem me propozim vendimin për caktimin e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe themelimin e mekanizmave institucional për zbatimin e Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014.

Mekanizmat institucional për zbatimin dhe monitorimin e Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014 ;.

- I. Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje (KNKDHF)**
- II. Sekretariati Koordinues (SK)**
- III. Grupin Koordinues (GK)**

I. Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje (KNKDHF):

Qeveria duhet të emëroj një **Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje** që mbanë pozitë të lartë në Qeveri, në nivel Ministri, të cilit do t'i ofrohet mbështetje politike nga Qeveria dhe administrative/logjistike nga Sekretariati Koordinues .

Detyrat dhe përgjegjësitë e KNKDHF.

KNKDHF ka përgjegjësinë për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit, të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011- 2014, të miratuar nga Qeveria me dt 25.08.2011.

- Është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të zbatimit të Programit Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit të miratuar nga Qeveria e Kosovës me dt 25.08.2011.
- Është përgjegjës për të raportuar para qeverisë, parlamentit dhe strukturave tjera koordinuese.
- Është përgjegjës të kryesoj Grupin Koordinues dhe të siguroj takimet e rregullta të këtij Grupi dhe mund të thërras takime urgjente përtej kalendarit të dakorduar.
- Siguron mbështetjen politike nga të gjitha ministrat dhe agjencitë përkatëse me qëllim që të mbështesë pikat fokale për GK.

Në të gjitha këto aktivitete, **KNKDHF** do të mbështetet nga Sekretariati Koordinues-logjistikë për dhunën në familje.

II. Sekretariati Koordinues- logjistikë për dhunën në familje.

Sekretariati do të ofroj mbështetje administrative-logjistike për KNKDHF për koordinimin e të gjitha aktiviteteve kundër Dhunës në familje.

Një punëtor me orar të plotë do të punoj në Sekretariat vetëm për çështjet e dhunës në familje me qëllim që të ofroj mbështetje administrative dhe logjistike për punën e KNKDHF dhe për të shërbyer si pikë referimi. Në periudhën 2 vjeçare prej themelimit të marrëdhënies së punës ky punëtor do të financohet nga projekti WSSI – UNDP. Ky Personi i angazhuar do të jetë pozicionuar brenda Agjencisë për Barazi Gjinore.

I udhëhequr nga KNKDHF, Sekretariati do të:

- Mbajë procesverbalet e takimeve të Grupit Koordinues.
- Siguroj shpërndarjen e të gjitha informatave përkatëse në nivel lokal dhe brenda vendit,
- Udhëheqë me një bazë të të dhënave mbi projektet/kontaktet, si dhe një listë të OJQ-ve, që angazhohen rregullisht që është në dispozicion të Grupit Koordinues dhe publikut të gjerë,
- Asistoj KNKDHF-në në të gjitha aspektet, sipas nevojës.

III. Grupi Koordinues (GK):

Në bazë të tri shtyllave kryesore si: Parandalimi ,Mbrotjtja dhe Siguria, Përkrahja , trajtimi dhe Riintegrimi të Programit Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit të miratuar nga Qeveria e Kosovës me dt 25.08.2011, dhe në bazë të nenit 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr 09/2011, Qeveria e Kosovës themelon Grupin Koordinues .

Organi i tillë duhet të jetë ndër-ministror dhe ndër-institucional dhe do të përfaqësohet nga udhëheqësit më të lartë të institucioneve të poshtëshënuara:

Në nivelin kombëtar:

- a. Zyra e Kryeministrit-Agjencia për Barazi Gjinore
- b. Ministria e Drejtësisë
- c. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- d. Ministria e Punëve të Brendshme
- e. Ministria e Shëndetësisë
- f. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- g. Ministria e Financave
- h. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Institucionet tjera:

- a. Zyra e Prokurorit të Shtetit
- b. Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- c. Policia e Kosovës,
- d. Instituti Gjyqësor.
- e. Enti i Statistikave të Kosovës
- f. Koalicioni i Strehimoreve.

Të gjithë përfaqësuesit e GK veprojnë si përfaqësues të ministrive/agjencive përkatëse dhe janë përgjegjës për:

- Zbatimin , rishikimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të Programit Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit.
- Kanë autoritetin për të marrë vendime dhe të drejtën e votës gjatë miratimit të vendimeve të GK-së,
- Ndërlidhin në mes të GK dhe ministrive/agjencive të tyre dhe sigurojnë rrjedhën e informatës ,
- Koordinojnë inputet e ministrisë/agjencisë së tij/saj, dhe
- Janë në dispozicion në kuptim të kohës dhe kapacitetit .
- Koordinojnë të gjitha aktivitetet brenda vendit me qëllim sigurimi dhe bashkëpunimi lokal duke përfshirë grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave.
- Sigurimin e buxhetit ,resurseve humane dhe koordinimit.
- Mbajtjen e kontakteve të rregullta me donatorë në vend dhe informon për mbajtjen e takimeve me qëllim që të koordinoj fondet dhe të shmangë dyfishimin e projekteve.
- Takohet jo më pak se dy herë në vit.
- Çdo anëtar i GK mund të thërras takimet jashtë kalendarit të paraparë nëse paqitet nevojë e domosdoshme.
- Anëtarët /et mund të zëvendësohen vetëm në raste të veçanta nga personi me pozitë të barazvlevshme në hierarkinë e institucionit.

Roli i OJQ-ve:

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në strukturat koordinuese është e nevojshme, marrë parasysh rolin thelbësor të luajtur nga OJQ-të në veçanti në fushën e parandalimit dhe asistencës për viktimat

OJQ-të do të përfaqësohen në GK . Në këtë kornizë, OJQ-të duhet të jenë pjesë e procesit vendimmarrës dhe duhet të konsultohen me qëllim që të merret mendimi dhe përvoja e tyre.

Tabela 1. Rastet e dhunës në familje Policia e Kosovës për vitin 2011

Directorate of Serious Crime	Domestic Violence Cases												
Year	2011												
Police Regions	Jan	Feb	March	April	May	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
Prishtina	17	20	23	21	18	21	20	32	19	30	25	22	268
Gjilan/Gnjilane	6	6	6	5	10	11	11	10	9	9	11	15	109
Ferizaj	15	5	5	2	4	4	19	14	9	14	9	8	108
Peja/Pec	11	18	19	20	20	16	23	15	20	16	16	13	207
Prizren	15	9	12	12	22	23	17	14	16	11	5	16	172
Mitrovica	28	15	16	16	13	17	20	9	15	9	16	8	182
Total	92	73	81	76	87	92	110	94	88	89	82	82	1046

Tabela 2. Rastet e dhunës në familje Policia e Kosovës për vitin 2012

Directorate of Serious Crimes	Domestic Violence Cases												
Year	2012												
Police Regions	Jan	Feb	Mar	April	May	June	July	August	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
Prishtina	23	14	29	20	25	20	35	41	27	24	25	18	301
Gjilan/Gnjilane	2	3	11	6	7	13	13	9	8	9	4	6	91
Ferizaj	8	13	9	12	10	5	15	9	9	9	12	11	122
Peja/Pec	18	13	13	19	18	14	12	25	16	13	19	11	191
Prizren	17	9	9	5	13	19	16	19	13	9	7	3	139
Mitrovica	13	8	17	17	14	13	24	25	13	14	17	7	182
Total Number	81	60	88	79	87	84	115	128	86	78	84	56	1026

Tabela 3. Rastet e dhunës në familje Policia e Kosovës për vitin 2013

Directorate for Serious Crimes	Domestic Violence cases												
Year	2013												
Police regions and months	Jan	Feb	March	April	May	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Total
Prishtina Region	26	16	21	32	23	21	23	27	25	11	14	12	251
Gjilan/Gnjilane Region	2	6	9	6	5	12	15	16	9	15	8	19	122
Ferizaj Region	15	11	10	16	15	14	8	12	9	9	10	10	139
Peja/Pec Region	21	18	21	20	15	10	26	11	19	18	21	11	211
Prizren Region	20	7	15	13	15	12	21	26	24	18	17	6	194
Mitrovica Region	14	14	16	14	14	13	20	14	11	18	11	11	170
Total number	98	72	92	101	87	82	113	106	97	89	81	69	1087

Tabela 4. Rastet e dhunës në familje Policia e Kosovës për vitin 2014

Directorate of Serious Crimes	Domestic Violence Cases												
Year	2014												
Regional Directorates /Date	Jan.	Feb.	March	April	May	June	July	August	Sep.	Oct.	Nov.	Dec.	Total
Pristina Region	10		27	24	29	31	30	22	21	22	18	19	253
Gjilan/Gnjilane Region	11	12	19	18	11	13	20	21	7	10	13	11	166
Ferizaj Region	8	4	10	12	8	10	16	7	13	15	11	14	128
Peja/Pec Region	17	12	18	20	19	21	22	28	24	21	14	16	232
Prizren Region	27	15	26	22	21	19	17	19	13	5	11	15	210
Mitrovica Region	9	9	6	9	8	13	13	9	18	12	16	7	129
North Mitrovica Region	4	4	5	4	2	6	5	2	4	3	4	3	46
Total number	86	56	111	109	98	113	123	108	100	88	87	85	1164

4. Lista komunale e respondentëve

EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA/INSTITUCIONI	VENDI
Ahmet Bahtijari	Qeverisja komunale Dragash	Dragash
Hajri Ramadani	Komuna Dragash	Dragash
Berlinda Berisha	Policia e Kosovës	Gjakova
Sakibe Doli	Shtëpia e sigurisë	Gjakova
Lumnije Shllaku	ZBGJ	
Elvane Shehu	Qendra për punë sociale	Gjakova
Sanije Berisha	Shoqata e gruas	Gjakova
Besnik Pireva	Mbrojtësi i viktimës	Gjilan
Afërdita Këqiku	QKMF-Gjilan, psikolog	Gjilan
Malsor Kryeziu	Gjykatë themelore	Gjakova
Leonora Juniku	Departamenti komunal për mirëqenie shëndetësore dhe sociale	Gjakova
Astrit Muhaxhiri	Zyra për ndihmë juridike në Kosovë	Gjakova
Teki Shala	Komuna e Gjakovës	Gjakova
Floriye Zhubi	Komuna e Gjakovës	Gjakova
Dardan Bakija	Komuna e Gjakovës	Gjakova
Sadik Zejnullahu	Departamenti komunal për mirëqenie shëndetësore dhe sociale	Dragash
Ibrahim Gashi	Qendra për punë sociale	Dragash
Gjejron Lokaj	Shoqata për iniciativë të gruas	Dragash
Zejnepe Ramizi	Shërbimi korrektues i Kosovës	Gjilan
Valbonë Dërvodeli	Gjykatë themelore	Gjilan
Vjollca Jakupi	Qeverisja komunale	Gjilan

Nevenka Rikalo	Ruka Ruci	Gracanica
Nazife Jonuzi	Shtëpia e sigurisë	Gjilan
Fazli Abdullahu	Njësi për të drejtat e njeriut	Gjilan
Ramadan Jashari	QKMF-Director	Dragash
Zaim Hajredini	OJQ “CIDO”	Dragash
Lindita Kozmaqi Piraj	Zyrtar për barazi gjinore	Dragash
Bajrush Ymeri	Qeverisja komunale	Novobërdo
Salih Kqiku	Qeverisja komunale	Gjilan

5. Lista qendrore e respondentëve:

EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA/INSTITUCIONI	VENDI
Shpresa Zariqi	Agjencia për Barazi Gjinore	Prishtina
Leonora Selmani	Agjencia për Barazi Gjinore	Prishtina
Edi Gusia	Agjencia për Barazi Gjinore	Prishtina
Antigona Fejza	UNFPA	Prishtina
Flora Macula	UN Women	Prishtina
Linda Sanaja	Un Women	Prishtina
Valentina Bejtullahu	Misioni i OSBE-së në Kosovë	Prishtina
Isabelle Jost	UN Women	Prishtina
Dijana Karan	UNMIK	Prishtina
Ljubisa Besarevic	OHCHR	Prishtina
Afrim Ibrahim	UNICEF	Prishtina
Nertila Qarri	Rrjeti i Grave të Kosovës	Prishtina
Tahire Haxholli	Policia e Kosovës	Prishtina
Brikena Sylejmani	UNDP	Prishtina
Basri Kastrati	Mbrojtja e viktimës-Zyra e Prokurorit të Shtetit	Prishtina
Visare Mujko-Nimani	UNFPA	Prishtina
Lavdim Krasniqi	Instituti Gjyqësor i Kosovës	Prishtina (TBC)
Premtime Preniqi	Zyrtar komunal për çështje gjinore	Prishtina(TBC)
Adile Basha-Shaqiri	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Prishtina
Nicole Farnsworth	Rrjeti i Grave të Kosovës	Prishtina

**VLERËSIM I REAGIMIT TË
SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE
ZBATUESVE TË LIGJIT:**

**PROGRAMI I KOSOVËS KUNDËR
DHUNËS NË FAMILJE DHE PLANI I
VEPRIMIT
2011-2014**

Tabela e përmbajtjes

Metodologjia e vlerësimit51

Informata biografike51

Mbledhja e të dhënave52

Mirënjohje52

Hyrje në vlerësim53

Përkufizimi i dhunës në familje.....53

Përmbledhje e gjetjeve54

Mekanizmat institucional, K. II: 2.3.254

Çështjet kritike në të kuptuarit dhe zbatimin e kuadrit ligjor, K III: 3.2.156

Çështjet kritike të funksionimit të mekanizmave institucional, K. III: 3.2.260

Objektivat dhe Politikat Strategjike, K. IV62

Procedurat Standarde të Veprimit.....62

Propozime dhe rekomandime.....62

Çështjet kritike që nuk janë Adresuar në Strategji62

Përkufizimi dhe të kuptuarit e Problemit62

Metodologjia Konkrete63

Qasja e njëtrajtshme ndaj dhunës në familje.....63

Ndërrimi i mentalitetit / Ndryshimi i dialogut64

Mesazhi për zero tolerancë / Dhuna në familje është krim.....64

Koordinimi dhe bashkëpunimi.....66

Përkufizimi i prioriteteve.....67

Shërbimet duhet t’i mbështesin prioritetet67

Parandalimi dhe rehabilitimi i kryerësve68

Llogaridhënia institucionale dhe zhvillimi i besimit.....68

Përkrahja më e madhe nga shteti.....69

Përmbledhje e rekomandimeve69

Metodologjia e vlerësimit

Për qëllim të këtij vlerësimi është bërë një shqyrtim gjithëpërfshirës i Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011 – 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm: “Strategjia”); janë analizuar të gjithë komponentët që ndërlidhen me drejtësinë penale të trajtuar nga Strategjia, si dhe këshillat për zbatimin e saj për sektorin e drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit. Ky vlerësim duhet shikuar në koordinim me raportin e UN Uomen në të cilin analizohen në hollësi shërbimet për viktimat e dhunës në familje. Kjo pjesë e vlerësimit do të përqendrohet në reagimin e sistemit të drejtësisë penale, përfshirë rolin e gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve policor dhe mbrojtësve të viktimave. Ky vlerësim është bërë me ndihmën e informacioneve të siguruara nga të gjithë sektorët e zbatimit të ligjit dhe intervistimit të tyre dhe do të adresojë kritika për Strategjinë, duke shqyrtuar sukseset dhe dështimet e saj, dhe do të përqendrohet në dhënien e udhëzimeve për politikat dhe paraqitjen e rekomandimeve për të ardhmen.

Informata biografike

Unë quhem Ejmi Lituin. Këtë vlerësim e kam realizuar duke u bazuar në përvojën time si prokurore dhe ish mbrojtëse e viktimave në Qytetin e Nju Jorkut me përvojë të mëhershme pune edhe me kryerësit e dhunës në familje në kontekst të edukimit grupor. Kam punuar si prokurore në Qarkun e Bronksit të Qytetit të Nju Jorkut për 14 vite. Karrierën time e kam filluar duke ndjekur krime të nivelit të ultë të dhunës në familje, veprave penale seksuale, dhe keqtrajtimit të fëmijëve, eventualisht duke u fokusuar në dhunën në familje, me ç’rast kam trajtuar mbi një mijë raste të kundërvajtjeve. Pas tri viteve karrierë, u ngrita në pozitën e prokurores për vepra penale brenda Byrosë për Dhunë në Familje, ku fillova të trajtojë raste më të rënda, përfshirë sulme, vjedhje, grabitje, zjarrvënie, posedim të revoleve dhe armëve tjera, dhunime, vrasje në tentativë, dhe shkelje të urdhrave mbrojtës, pasi që të gjitha këto krime mund të gjenden në kontekst të dhunës në familje. Përfundimisht, u specializova në raste të vrasjeve të ndërlidhura me dhunën në familje, ku kam trajtuar rreth 25 të tilla. Në vitin 2012 u bëra mbikëqyrëse e Byrosë për Dhunë në Familje të Zyrës së Prokurorisë së Qarkut të Bronksit, pastaj një vit më vonë u caktova Zëvendës Kryesuese, dhe tani jam Kryesuese e Byrosë. Jam përgjegjëse për të gjitha rastet që trajtohen nga Byroja ime, ku në çdo kohë kemi në punë mesatarisht rreth 2,500 raste. Aktualisht jemi duke trajtuar 2,204 raste të nivelit të ultë (kundërvajtje), dhe 363 raste të nivelit të lartë (vepra penale), prej të cilave 28 janë vrasje. Aktualisht mbikëqyr 31 prokurorë dhe 9 anëtarë të stafit mbështetës, si dhe punoj ngushtë me Departamentin e Policisë të Qytetit të Nju Jorkut dhe organizatat e shërbimeve të viktimave, për t’u siguruar që të gjithë kryerësit të mbahen përgjegjës dhe të ndihmohen të gjitha viktimat.

Përgjegjësitë e mia gjithashtu përfshijnë edhe mbajtjen e ligjëratave dhe hartimin e trajnimeve me tema që përfshijnë intervistimin e viktimave të dhunës në familje, përpilimin e akuzave në rastet e dhunës në familje, strategjinë e gjykimit, “ndjekjet e bazuara në prova” dhe rastet e ngulfatjes. Kam qenë e përfshirë si anëtare e trupit ligjërues të zyrës për Programin Trajnues të Gjykimit të Kundërvajtjeve, dhe Programin Trajnues të Gjykimit të Veprave Penale, dhe u kam ligjëruar pjesëtarëve të policisë dhe prokurorëve që kanë qenë vizitorë nga vendet jashtë Shteteve të Bashkuara, si dhe u kam ligjëruar dhe mbajtur trajnime pjesëtarëve të Departamentit të Policisë të Shtetit të Nju Jorkut. Rishtazi u kam mbajtur trajnim të gjithë zyrtarëve policor dhe rreshterëve të specializuar të dhunës në familje, ku ka afërsisht rreth 400 të tillë në tërë qytetin, lidhur me rëndësinë e procedimit të rasteve të dhunës në familje pavarësisht bashkëpunimit të viktimës, duke theksuar rëndësinë e strategjive për mbledhjen e provave. Gjithashtu kam hartuar një manual për prokurorë të titulluar: Udhëzues për Përpilimin e Akuzave për Rastet e

Dhunës në Familje si udhëzues për përpilimin e akuzave menjëherë pas arrestimit të kryerësit të dhunës në familje. Ky manual kërkon zbatimin e strategjive, objektivave dhe teknikave të reja. Puna ime është i zbaton politikat e Zyrës së Prokurorisë së Qarkut, derisa krijon sisteme të reja të cilat do t’iu mundësojnë prokurorëve në byronë time, dhe të gjithë prokurorëve tjerë të cilët kanë kontakt me rastet dhe viktimat e dhunës së familje, që të punojnë në mënyrë efektive dhe me dhembshuri derisa përfundimisht të mbajnë viktimat të sigurta, kryerësit përgjegjës dhe të ulin shkallën e krimit në komunitetin e Qarkut të Bronksit, në Qytetin e Nju Jorkut.

Zyra e Prokurorisë e Qarkut të Bronksit ka Njësitin për Ndihmë të Viktimave të Krimit të përbërë nga 14 mbrojtës të viktimave të cilët nuk janë juristë, përfshirë dy persona të specializuar në dhunë në familje, dhe 4 terapistë nga radhët e tyre. Prokurorët në zyrën time bashkëpunojnë me mbrojtësit e viktimave në shumë raste të tyre. Zyra ime gjithashtu bashkërendon shërbimet terapeutike për fëmijët e prekur nga dhuna në familje dhe ne punojmë ngushtë me Zyrën e Krybashkiakut për të luftuar dhunën në familje, për shkak të iniciativës së Qendrës për Drejtësi Familjare e cila bashkëpunon me personelin në byronë time me një mori shërbimesh për viktimat, përfshirë avokatët për përfaqësim në procedura civile, punëtorët social, psikiatrit, ofruesit e shërbimeve specifike për kultura të ndryshme, dhe kujdesin për fëmijët në vendin e ngjarjes.

Mbledhja e të dhënave

Për të ndihmuar në hartimin e këtij vlerësimi, Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe Departamenti i Drejtësisë kanë aranzhuar takime me gjyqtarë të caktuar si koordinator të dhunës në familje për gjyqësorin në Prishtinë, Prizren dhe Deçan. Gjithashtu jam takuar edhe me prokurorët e caktuar në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, dhe Pejës. Jam takuar me pjesëtarë të Policisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët mbikëqyrës dhe hetues të Njësitit për Hetime të Dhunës në Familje, si dhe pjesëtarë të tjerë të Policisë së Kosovës të cilët punojnë në patrullë dhe menaxhojnë sektorët policor. Jam takuar edhe me Kapitenin e Njësitit për Hetimin e Dhunës në Familje të Policisë së Kosovës. Mbrojtësit e viktimave gjithashtu janë të përfaqësuar në vlerësimin tim. Jam takuar me rreth gjashtë mbrojtës të viktimave, përfshirë Menaxherin e Mbrojtësve të Viktimave dhe Mbrojtësin e Lartë të Viktimave në Prishtinë. E kam marr edhe perspektivën e dy anëtarëve të CLARD (Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal) të cilët ofrojnë përfaqësim juridik falas si për viktimat ashtu edhe kryerësit dhe të cilët marrin raste strategjike për të ndihmuar në vetëdijesimin dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale. Në fund jam takuar me një viktimë të dhunës në familje, si dhe anëtarët e ekipit të tij ligjor. Kemi diskutuar dështimet e sistemit dhe si kjo ka ndikuar te ai dhe familja e tij.

Mirënjohje

Luftimi i dhunës në familje është detyrë e nevojshme dhe e paçmueshme për suksesin dhe zhvillimin e çdo shoqërie pasi që i prek të gjithë pjesëtarët e saj: burrat, gratë, dhe fëmijët. Për më tepër, nuk mund të ketë drejtësi derisa të mbrohen vazhdimisht dhe në mënyrë të përhershme të gjitha të drejtat e njeriut. Qeveria e Kosovës dhe zëvendësministri i drejtësisë dhe koordinatori nacional për dhunë në familje, z. Lirak Çelaj, duhet përgëzuar për bërjen e dhunës në familje prioritet dhe për shprehjen e gatishmërisë për të bërë ndryshimet e nevojshme që kërkojnë për të siguruar drejtësi për viktimat dhe llogaridhënie për kryerësit. Pa një reagim të njëtrajtshëm dhe të vendosur kundër dhunës në familje, që e bën të qartë se ajo nuk do të tolerohet, problemi kurrë nuk do të hyjë në rrugën e çrrënjësjes.

I falënderoj të gjithë individët të cilët kanë ndarë kohën që të takohen me mua gjatë vizitës sime në Kosovë. Kam takuar njerëz nga e tërë Kosova të cilët kanë përvojë në sistemin e drejtësisë me raste të dhunës në familje. Përvojat personale dhe njohuritë e tyre më kanë mundësuar që praktikisht dhe personalisht të kuptoj funksionimin e sistemit të drejtësisë. Kjo më ka mundësuar që të vlerësoj strategjinë nga pikëpamja e atyre që punojnë, apo të cilët janë ballafaquar, me sistemin juridik.

Në fund, e falënderoj Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, punëtorët e palodhshëm të të cilave vazhdojnë të ndihmojnë Kosovën që të ketë sistemin më të fortë të mundshëm të drejtësisë penale, dhe natyrisht, për ndihmën që më kanë dhënë në mbledhjen e informatave gjithëpërfshirëse lidhur me gjendjen aktuale që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë dhe dhunën në familje.

Hyrje në vlerësim

Vlerësimi është i ndarë në dy pjesë: shërbimet për viktimat dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga sistemi i drejtësisë. Qasja e drejtësisë zakonisht përqendrohet në kryerësin. Qasja e këtillë në dy drejtime në luftimin e dhunës në familje është esenciale. Nuk mund të ketë asnjë viktimë pa pasur një kryerës. Strategjia gjithëpërfshirëse përmirëson sjelljen e kryerësit dhe e fuqizon viktimën. Kjo pjesë e vlerësimit përqendrohet në atë se si Strategjia e drejton sistemin e drejtësisë të Kosovës për të trajtuar dhunën në familje.

Fillimisht, vlerësimi e shqyrton qasjen e Strategjisë në përkufizimin e dhunës në familje. Segmenti tjetër shqyrton pjesët e Strategjisë që i adresohen sektorit të drejtësisë. Pastaj ka një vlerësim të Procedurave Standarde të Veprimit të hartuara nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Strategjisë. Segmenti i fundit përfshinë propozime dhe rekomandime për të ardhmen.

Përkufizimi i dhunës në familje

Kjo pjesë e parë e këtij vlerësimi i përkushtohet trajtimit të problemeve me qasjen e Strategjisë në përkufizimin e dhunës në familje brenda sistemit të drejtësisë. Dhuna në familje është problem i shumëanshëm. Ka perspektiva psikologjike, ligjore, financiare, shoqërore, kulturore, dhe shumë tjera lidhur me këtë problem, gjë që krijon shumë qasje të ndryshme. Për të sqaruar qasjen institucionale të Kosovës ndaj dhunës në familje është me rëndësi që Strategjia të jep një përkufizim dhe përkufizim të qartë.

Dhuna në familje nuk është vepër penale e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës. Është e përcaktuar nga marrëdhënia ndërmjet palëve. Për të gjetur përkufizimet për llojet e marrëdhënieve në kuadër të të cilave bien krimet e dhunës në familje, duhet shikuar Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje.¹ Këto janë marrëdhënie që i plotësojnë kushtet për t’i mundësuar viktimës së dhunës në familje që të merr urdhër mbrojtës nga gjykata civile në Kosovë. Megjithatë, ligji është i paqartë, që gjë shpie te supozimi se sjellja kriminale ndërmjet anëtarëve të marrëdhënieve të përkufizuara familjare do të konsiderohet dhunë në familje si nga gjykata penale ashtu edhe gjykata civile. Por, kjo nuk duket se ndodh në praktikë.

Duhet kuptuar se krimet ndërmjet anëtarëve të familjes janë po aq serioze, nëse jo edhe më serioze, sesa krimet ndërmjet atyre pa marrëdhënie familjare, pasi që në kuadër të atyre marrëdhënieve zakonisht ka sjellje recidiviste, përfshirë eskalimin të sjelljes. Natyra emocionalisht e ngarkuar dhe intime e veprave të dhunës në familje e vë çdo viktimë në rrezik të viktimizimit të rëndë, e madje edhe të vrasjes. Personi i cili sulmohet nga një i panjohur, apo

1 Kapitulli 1, Neni 2, paragrafi 1.1

punëtori i cili sulmohet nga kolegu, rrallëherë jeton në rrezik duke pritur veprimin e dhunshëm të radhës. Dhuna në familje është ciklike nga natyra me periudha të ndërveprimeve pozitive të pasuara me eskalim të tensionit, i cili shpie në veprimin e dhunshëm të radhës. Në aspektin ndërkombëtar, dhuna në familje njihet si model i sjelljes shtrënguese që ka për qëllim të shtrijë dhe mbajë pushtetin dhe kontrollin mbi një person tjetër të marrëdhënies familjare apo intime. Keqtrajtimi familjar merr shumë forma, përfshirë, por pa u kufizuar në dhunën, keqtrajtimin ekonomik, keqtrajtimin seksual, keqtrajtimin emocional dhe psikologjik, keqtrajtimin verbal, frikësimin dhe izolimin, si dhe minimizimin e sjelljes keqtrajtuese dhe fajësimit e viktimës për shkaktimin e saj. Eskalimi shpeshherë mund të shpie deri te lëndimi i rëndë trupor apo vdekja. Ka një numër treguesish që tregojnë për eskalimin, e madje edhe vdekjen. Këta tregues përfshijnë depresionin dhe idetë vetëvrasëse, idetë vrasëse, posedimin e armës dhe kanosjen me armë, lënien shtatzënë të viktimës, papunësinë, dhe veprimin serioz të ngulfatjes, gjë që jo vetëm do të përforcojë ndjenjën e frikës te viktimja, por mund edhe të jetë ca sekonda larg marrjes së jetës së viktimës.

Siç tregohet edhe nga Strategjia për dhunë në familje, dhuna në marrëdhënie intime është problem serioz dhe i përhapur në Kosovë, ku shumë banorë besojnë se dhuna është diçka e natyrshme gjatë argumenteve dhe se dhuna seksuale nuk është vepër penale kur bëhet ndërmjet partnerëve.² Fatkeqësisht, siç edhe vihet re nga Strategjia, dhuna në familje jo gjithnjë raportohet, dhe vazhdon të mbetet çështje që familja përpiqet ta zgjidh brendapërbrenda, duke drejtuar turpin kah viktimja. Derisa të mos ndryshojnë qasjet dhe të mos përmirësohet roli i grave përmes inkurajimit të barazisë më të madhe, dhuna në familje do të vazhdojë në këtë shkallë.

Përmbledhje e gjetjeve

Në pjesën “Përmbledhje e gjetjeve” është përfshirë një analizë e shkurtë e të gjitha segmenteve të Strategjisë që përfshinë zbatimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë. Segmentet të cilat nuk trajtojnë komponentët e sistemit të drejtësisë janë të përfshira në Kapitullin I të vlerësimit, i cili përqendrohet në shërbimet për viktimat. Çdo titull i marrë nga Strategjia pasohet me një analizë të asaj pjese. Ndonëse shqetësimet dhe sugjerimet do të ceken, ato do të trajtohen më gjerësisht në pjesën “Propozimet dhe rekomandimet” të këtij vlerësimi.

Mekanizmat Institucional (Kapitulli II: 2.3.2)

Sipas Strategjisë, “mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje në Republikën e Kosovës.”

Nevojitet reagim i koordinuar për të trajtuar çështjen e dhunës në familje. Aktualisht nuk ka ndonjë rrjet të fuqishëm të informacioneve që ofrohen dhe ndahen ndërmjet institucioneve partnere në Kosovë. Strategjia ofron udhëzime mbi rolin e të gjithë partnerëve në kapacitetin e tyre individual, megjithatë ekzistojnë pak sisteme për të inkurajuar koordinimin dhe ndarjen e informatave.

Policia e Kosovës duket se përmbush përgjegjësinë e saj për të njoftuar mbrojtësit e viktimave ashtu siç kërkohet. Prokurorët janë hallkë e dobët dhe nuk janë partnerë të qartë në luftën kundër dhunës në familje, në kuptimin që Policia e Kosovës nuk ndihet rregullisht e mbështetur nga zyra e prokurorisë për t’i mbajtur kryerësit përgjegjës. Përveç kësaj, ka mungesë të bashkërendimit ndërmjet asaj që ndodh në gjykatë civile dhe mënyrës se si prokurorët i trajtojnë rastet në gjykatë

penale kur të pandehurit dhe viktimat kanë procedura para të dy gjykatave. Prokurorët nuk duket se ndjehen të obliguar ndaj avokatëve mbrojtës apo publikut kur ata kanë pyetje lidhur me lëndë në procedurë dhe kjo mungesë e transparencës e bën të pamundur ndërtimin e besimit.

Për më tepër, prokurorët nuk janë të specializuar për të trajtuar rastet e dhunës në familje. Prokurorët në këto raste duhet të jenë të specializuar pasi që do t’iu mundësonte atyre që të njihen më mirë me viktimat dhe kryerësit individual, mënyrat e kryerjes, dhe recidivistët. Natyra e ndërlikuar e këtyre marrëdhënieve familjare kërkon nga aktet kryesor trajnim të specializuar si dhe qëndrim të prerë por me dhembshuri. Këtyre rasteve nuk u kushtohet vëmendje e veçantë kur përzihen me të gjitha rastet tjera. Është pengesë e jashtëzakonshme për të gjitha rastet e ndjekura kur nuk ka një person të caktuar që është përgjegjës për të gjitha aspektet e rastit, përfshirë paraqitjen në shqyrtime gjyqësore; kjo bëhet edhe më problematike kur rasti përfshinë familjen, emocione, dhunë, potencial për eskalim, e madje edhe sjellje vrastare.

Fatkeqësisht, nuk është e qartë nëse gjithmonë ngriten akuza penale kur kryhet një vepër penale. Përkufizimi i dhunës në familje në kod civil dhe ligjet e aplikueshme rezulton në zbatimin e masave civile si më të përhapurat në trajtimin e dhunës në familje. Kjo zbeh përgjegjësinë penale, e cila është e rëndësishë parësore në përpjekjen për të zvogëluar shkallën e dhunës në familje në nivel nacional.

Të gjithë aktet kryesorë nuk duket të jenë të koordinuar mirë dhe duket se u mungon mendësia e përbashkët lidhur me qëllimet e Strategjisë. Për shembull, jo të gjithë aktet pajtohen se paraburgimi është masë e përshtatshme. Policia e cila iu përgjigjet thirrjeve të këtilla për ndihmë me gjasë do të shprehte frustrimin që nuk ka më shumë kërkesa për paraburgim, ndërsa prokurorët dhe gjyqtarët përqendrohen në ndikimin tek kryerësit, siç janë pasojat e paraburgimit tek kryerësi i cili siguron ushqimin për familjen. Gjyqtarët dhe prokurorët shpeshherë përqendrohen në atë që ata besojnë se është më e mira për familjen, dhe nëse viktimja ka mundësi tjera të strehimit. Këto konsiderata shpeshherë rezultojnë në vendim për të ruajtur gjendjen aktuale të jetesës në vend të ndërprerjes së saj për hir të sigurisë dhe llogaridhënies. Pa prioritet dhe mendësi të përbashkët, njëtrajtshmëria dhe ndryshimi do të jenë të paarrtshme. Derisa personeli i specializuar i policisë dhe mbrojtësit e viktimave i japin prioritet dhunës në familje, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të bëjnë të njëjtat përpjekje. Pa qëllime të qarta dhe mendësi të përbashkët për sigurinë e viktimave, dhe llogaridhënien e kryerësve, rezultatet në rastin më të mirë do të jenë të papajtueshme, e në rastin më të keq joefektive.

Koordinatori Nacional

Sipas Strategjisë, “Koordinatori Nacional është organ individual përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në Programin kundër dhunës në familje.”³ Kjo detyrë është shumë e gjerë dhe mund të kërkojë një ekip njerëzish për të siguruar zbatimin e Strategjisë. Në të ardhmen, duhet të ketë metoda të përcaktuara qartë për llogaridhënie, monitorim dhe zbatim të Strategjisë së Re. Kjo do të sigurojë një vlerësim më të qartë të suksesit të saj.

Policia e Kosovës

Policia e Kosovës duket se është në pajtim me strukturën që kërkohet nga Strategjia; megjithatë, ka probleme kritike në aftësinë e tyre për t’i trajtuar këto raste. Zyrtarët e specializuar punojnë për të ndarë informacione me viktimat lidhur me shërbimet, urdhrat mbrojtës dhe rolin e mbrojtësve

2 Kapitulli 2.3 i Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014

3 Kapitulli 2.3.2

të viktimave. Një prej zbrazëtirave që nuk trajtohen në Strategji është fakti se zakonisht, zyrtari i parë që i përgjigjet thirrjes për ndihmë nuk është zyrtari për dhunë në familje, por është zyrtari policor patrullues që gjendet më së afërmi. Zgjidhja më efektive do të ishte që të rritet numri i zyrtarëve policor të specializuar, gjë që do të mundësonte rritjen e kontaktit me viktimat dhe kryerës. Të paktën, të gjithë zyrtarët duhet të trajnohen në trajtimin e këtyre kërkesave të ndërlikuara për ndihmë, posaçërisht pasi që nuk ka burime, përfshirë mungesën e makinave për policët e dhunës në familje, për të vizituar të gjitha viktimat dhe për t’iu përgjigjur të gjitha thirrjeve.

Për më tepër, një bazë e të dhënave më e koordinuar e raporteve të paraqitura do t’i mundësonte Policisë së Kosovës që të identifikojë më lehtë viktimat e “rrezikut të lartë”. Këto viktimat të cilat janë në rrezik të lartë të riviktimizimit mund të pranojnë mbështetje më të madhe nga avokatët dhe policia. Zyrtarët mund të zbatojnë “vizita në shtëpi” në baza të rregullta për të kontaktuar familjen. Prania më e madhe do të krijojë marrëdhënie më të mira me policinë për disa, ndërsa për të tjerë, përfshirë kryerësit, do të ngjallë frikën se keqtrajtimi i vazhdueshëm do të zbulohet.

Mbrojtësit e viktimave

Mbrojtësit e viktimave kanë për detyrë mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Kjo është e vështirë kur ka mungesë të mbështetjes dhe bashkëpunimit nga aktet tjerë të rëndësishëm në luftën kundër dhunës në familje. Mbrojtësit e viktimave duken të mirinformuar me ligjin si dhe Procedurat Standarde të Veprimit (në tekstin e mëtejme: “PSV”). Mbrojtësit e viktimave kanë autorizimin për ta përfaqësuar viktimën në gjykatë penale. Për të përmirësuar trajtimin e rasteve të dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale, mbrojtësit e viktimave duhet të ndjekin akuzat penale kur provat tregojnë për ekzistimin e veprës penale ndërsa prokuroria nuk ndërmerr hetimin e tyre.

Prokurorët po mungojnë nga kapitulli për mekanizmat institucional

Roli i prokurorëve të shtetit rrallëherë përmendet dhe nuk është i përcaktuar në Strategji, dhe ata mungojnë krejtësisht nga kapitulli për mekanizmat institucional. Prokurorët kanë për detyrë ta zbatojnë ligjin dhe ta mbrojnë viktimën dhe shoqërinë në tërësi. Roli i tyre nuk mund të nënvlerësohet në luftën kundër dhunës në familje, por pavarësisht kësaj, atyre duket se u është lënë në diskrecion që të vendosin kur dhe nëse do të fillojnë ndjekjen, si dhe kur dhe nëse do ta ndalojnë kryerësin. Prokurorët janë në pozitë të jashtëzakonshme ku mbajnë çelësat e llogaridhënies, që potencialisht mund të shpie në uljen e krimit dhe rrjedhimisht në bashkësi më të sigurt. Ky pushtet duhet dhënë në mënyrë më të njëtrajtshme dhe sistematike.

Çështjet kritike në kuptimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor (Kapitulli III: 3.2.1)

Strategjia trajton çështje kritike që duhet njohur dhe përmirësuar, siç identifikohet nga punëtoritë dhe konsultimet me ekspertë. Ndonëse është e dobishme që të trajtohen këto fusha, ka udhëzime të pamjaftueshme se si të rregullohen këto çështje. Për më tepër, Strategjisë i mungon propozimi për mbikëqyrje, një domosdoshmëri kjo për të siguruar përmirësimin dhe korrigjimin. Fatkeqësisht, problemet potencohen por nuk jepen zgjidhje. Ndryshimi duhet inkurajuar dhe udhëzuar me një qasje të përcaktuar qartë të orientuar kah zgjidhja.

- *Niveli i njohjes së Konventave ndërkombëtare dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar*

Strategjia edukon viktimat lidhur me dhunën në familje por jo edhe praktikuesit institucional që kanë për detyrë mbrojtjen e viktimave. Strategjia ofron përqendrim të gjerë në edukimin e viktimave lidhur me të drejtat e tyre dhe ligjin e zbatueshëm. Derisa ky është mjet i çmueshëm për fuqizimin e viktimave, duhet të ketë përqendrim të njëjtë edhe në edukimin e atyre që e shkelin ligjin, si dhe atyre që e zbatojnë atë. Arsimimi i vazhdueshëm ligjor në formë të njoftimeve mbi ndryshimet ligjore dhe trajnimeve të ofruara nga qeveria mund të jenë të dobishme për të përmbushur pritjet si dhe për të ndihmuar në evoluimin e këtyre pritjeve. Gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e policisë, dhe mbrojtësit e viktimave duhet të kenë njohuri për të drejtat dhe ndalesat themelore ligjore gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje ose në të kundërtën nuk mund të ketë përmirësim. Aktet kryesor duhet të jenë të mirinformuar për ligjet dhe të drejtat përkatëse dhe të gjithë duhet ta kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje dhe nevojën për ndryshim dhe llogaridhënie. Kjo duhet të shtrihet përtej atyre që specializojnë në çështjet e dhunës në familje, pasi që tjerët mund të vijnë në kontakt si me viktimat ashtu edhe me këto çështje.⁴

- *Vonesat në lëshimin e urdhrave mbrojtës dhe dënimit e buta për kryerësit recidivistë dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës*

Dhuna në familje nuk mund të çrrënjohet pa dënimin e kryerësve, dhe në raste të caktuara, këto dënime duhet të jenë të ashpra. Pa zbatuar qasjen për zero tolerancë nga të gjithë ata që punojnë me viktimat dhe kryerës, status quo do të vazhdojë të mbetet. Kryerësit duhet të mbahen përgjegjës, përndryshe urdhrat mbrojtës kanë pak vlerë. Duhet të ketë udhëzime më strikte dhe më të gjera për largimin e diskrecionit aq të madh nga ata të cilët janë përgjegjës për llogaridhënien e kryerësve.

Politikat mund të përcaktohen qoftë nga Ministria e Drejtësisë, apo nga zyrtarë rajonale të prokurorive, për të avokuar për një rezultat më konsistent në këto raste. Ligji Nr.03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje duhet të përcaktojë më qartë masat penale, dhe të lejojë dhe inkurajojë ekzekutimin e masave civile kur ka shkelje të urdhrit mbrojtës.⁵ Arrestimi duhet të jetë i detyrueshëm, dhe dënimet penale duhet të merren parasysh për të priorizuar dhunën në familje dhe të trajtohen më seriozisht veprimet e kryerësve të cilët shkelin urdhrin e gjykatës. Shkeljet e urdhrit mbrojtës duhet të integrohen në Kodin Penal të vendit. Shkelja e urdhrit mbrojtës duhet të përcaktohet qartë si vepër penale në Kapitullin XVII, Veprat Penale kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Duhet të jetë e qartë për të gjithë aktet kryesor, viktimat, dhe kryerësit, se krimet e dhunës në familje nuk kufizohen në kërkesën për urdhër mbrojtës në procedurë civile, por se ekziston edhe përgjegjësi penale për shkeljen e këtyre urdhrave. Dhunë në familje duhet të konsiderohet SECILA vepër penale e kryer nga personat në ndonjërin nga marrëdhëniet e përcaktuara.⁶

4 Për shembull, kur bëhet një thirrje nga viktimat e dhunës në familje për ndihmë nga departamenti i policisë, zyrtarët policor të specializuar nuk janë të parët që përgjigjen pasi që janë shumë pak dhe kryesisht janë zyrtarët patrullues të policisë që gjenden më së afërmi ata të cilët do të reagojnë më së pari. Për më tepër, gjyqtarët e lëndëve penale të cilët gjykojnë rastet e dhunës në familje dhe të shkeljeve të urdhrave mbrojtës, të cilët aktualisht nuk janë të specializuar, do të përfitonin nga trajnimi i mëtutjeshëm në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

5 Derisa neni 25 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parasheh dënime civile me gjobë dhe me burgim, dënimet janë të rralla në procedura civile dhe janë të rezervuara për ndjekje penale.

6 Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje e përkufizon gjerësisht sjelljen nga e cila mund të konsistojë, si dhe llojet e marrëdhënieve përmes të cilave mund të kryhet. Këto përkufizime do duhej të përfshiheshin edhe në Kodin Penal.

- *Lëshimi i kufizuar i masave të parapara sipas rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje*

Siç u tha më lartë, udhëzimet më të gjera do të shpijnë në zbatim më të mirë ligjit dhe në rritje të njëtrajtshmërisë. Për më tepër, pa edukim mbi rreziqet që u kanosen viktimave dhe mbi ciklet dhe sjelljet e keqtrajtimit, do të jetë e vështirë që të përcaktohen masat e përshtatshme. Siguria e viktimës dhe fëmijëve të saj duhet të jetë brenga kryesore. Siç qëndrojnë gjërat, nëse viktimat nuk kërkon ndihmë të caktuar, një gjë e tillë nuk ofrohet nga gjykata. Nga viktimat dhe mbrojtësit e viktimave pritjet që ta njohin ligjin më mirë se anëtarët e gjyqësorit. Për më tepër, sistemi nuk është “miqësor” për përdoruesit e tij, duke ua bërë kështu të vështirë viktimave që të manovrojnë. Kur viktimat vendos që të kërkojnë masa mbrojtëse shtesë gjatë procedurës, nevojitet që t’i paraqitet sërish kërkesë gjykatës. Kjo shkakton vonesa në sigurimin e asaj që viktimat kanë nevojë për të qenë të sigurta. Procesi duhet të jetë më fleksibil ashtu që urdhri përfundimtar i gjykatës të përfshijë të gjitha masat e përshtatshme.

- *Arsyetimi i dobët i aktvendimeve me të cilat shqiptohen urdhrat mbrojtës*

Strategjia nuk përmban pritje të definuara qartë për gjyqësorin lidhur me një qasje më të njëtrajtshme në shqiptimin e urdhrave mbrojtës. Diskutimi i kësaj çështjeje kritike në Strategji nuk e shpjegon problemin, e as nuk ofron ndonjë zgjidhje. Pritjet më të qarta të cilat shpijnë në një qasje më të njëtrajtshme do të rezultojnë nga udhëzimet më të gjera, edukimi, dhe monitorimi, ku të gjitha këto duhet të zbatohen nga institucionet e Kosovës. Ligjet do të zhvilloheshin në mënyrë më të plotë sikur gjyqtarët të ofronin vendime me shkrim, të cilat rrjedhimisht pastaj mund të ofrojnë udhëzime për gjyqtarët tjerë gjatë interpretimit të ligjit.

- *Vëmendje e kufizuar në sigurimin e zbatimit të urdhrave mbrojtës*

Urdhri mbrojtës duhet t’i jepet çdo viktimit e cila ka arsye dhe e kërkon atë. Derisa siguria e viktimës të mos konsiderohet si prioritet, urdhrat mbrojtës do të analizohen bazuar në faktorët e rëndësishëm për secilin gjyqtar individual, dhe shpeshherë, bazuar në gjendjen materiale të familjes. Gjendja materiale e familjes nuk do duhej të kishte kurrfarë ndikimi në zbatimin e urdhrat mbrojtës. Shërbimet e viktimave duhet të ndihmojnë me strehim alternativ në situatat kur viktimat është e pasigurt në shtëpi, ose kryerësi duhet të largohet nga shtëpia. Për më tepër, gjykatat duhet të shqiptojnë urdhra për ndalimin e afërimit personave apo vendeve të caktuara, ashtu siç parashihet në nenin 177 të Kodit të Procedurës Penale. Kur kryerësi arrestohet, gjykata penale duhet gjithashtu të ketë kompetencë që të lëshojë urdhër sipas kërkesës së prokurorit, gjë që mund të bëhet në të gjitha rastet.⁷ Duket se rasti i Diana Kastratit ka ndryshuar mendësinë në mbarë Kosovën lidhur me lëshimin e urdhrave, por urdhrat të cilët detyrojnë kryerësin që thjeshtë të flejë në një dhomë tjetër apo të qëndrojë 5 metra larg nga viktimat kanë pak ndikim për të garantuar sigurinë e viktimës apo sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre.

- *Kapacitete të kufizuara profesionale kushtuar rasteve gjyqësore të dhunës në familje*

Sipas Strategjisë, të gjithë segmentet e gjyqësorit duhet të specializohen për dhunë në familje, por, në praktikë, kjo nuk po ndodh. Vetëm gjyqtarët e gjykatës civile të cilët merren me çështje familjare specializojnë, dhe jo aq mirë. Gjyqtarët e gjykatës penale nuk specializojnë fare, por do duhej. Për shkak të faktit se çështjet e dhunës në familje mund të përshkojnë të gjitha ligjet tjera, të gjithë gjyqtarët duhet t’i nënshtrohen trajnimit dhe edukimit për të kuptuar më mirë dinamikën e dhunës në familje, format e saj, dhe vështirësitë me të cilat mund të ballafaqohet

⁷ Ky vlerësim në pjesën “Propozime dhe rekomandime” do ta trajtojë më gjerësisht çështjen e prioritizimit të sigurisë së viktimës si dhe nevojën për shërbime mbështetëse për të parandaluar që gjendja materiale e familjes të mos jetë faktor kontrollues në marrjen e vendimeve për urdhra mbrojtës.

viktimat gjatë përpjekjes për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit apo gjatë përpjekjes për t’u larguar nga marrëdhënia. Pa një propozim të definuar qartë për specializim dhe trajnim, deklarata se kjo duhet të bëhet do të mbetet vetëm aq: deklaratë.

- *Besimi i kufizuar i qytetarëve në sistemin gjyqësor*

Strategjia trajton shqetësimin lidhur me mungesën e besimit në sistemin e drejtësisë penale. Nëse viktimat kanë mëdyshje për sistemin gjyqësor, atëherë janë policët, mbrojtësit e viktimave dhe prokurorët ata që duhet t’ua heqin këto mëdyshje. Biseda njoftuese duhet të përfshijë një përmbledhje të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe mënyrës se si mund t’i ndihmojë ata. Fletushka dhe broshura duhet të hartohen për të shpalosur sistemin dhe procedurat e nevojshme. Nga e gjithë popullata, viktimat e dhunës në familje ka më së paku gjasë që të kenë njohuri për të drejtat e tyre pasi që keqtrajtuesit përfitojnë nga mungesa e njohurive të tyre. Për më tepër, keqinformimi i bërë nga ana e keqtrajtuesve të tyre shpesh pengon bashkëpunimin e tyre me organet e ndjekjes penale. Viktimat e painformuar ka më shumë gjasë që të jetë viktimë jo bashkëpunuese. Të gjitha aspektet e sistemit të drejtësisë penale duhet t’i shpjegohen viktimës. Kjo do t’i fuqizojë dhe do t’i informojë ato. Komunikimi i informacioneve viktimave dhe mbledhja e informacioneve nga viktimat gjithashtu ndërton besimin. Viktimat duhet t’i shohin aktet kryesor si të qasshëm dhe të ditur për të ndërtuar besimin dhe duhet ta shohin shfrytëzimin e “sistemit” si një rrugë të duhur drejt sigurisë.

- *Raportimi i ulët i dhunës ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara*

Strategjisë i mungon një mesazh i qartë lidhur me dhunën në familje. Mesazhi duhet të jetë se dhuna në familje është krim që nuk do të tolerohet. Kjo do t’ua bëjë me dije të gjithëve, përfshirë viktimave dhe kryerësve, se raportimi i krimit është mënyra e vetme për të zvogëluar dhunën kundër grave. Sigurisht, kryerësit nuk përfitojnë nga raportimi i krimit nga ana e viktimës. Duhet punuar që të zvogëlohet izolimi i viktimave të dhunës në familje. Sistemi i drejtësisë duhet të ngjall besim ashtu që gratë të ndjehen të mbrojtura dhe të mos kenë frikë nga pasojat e lajmërimit para organeve. Kjo do t’ua mundësojë viktimave që të paraqiten më me lehtësi. Për të mbështetur këto përpjekje, nevojitet trajnim për teknikat forenzike të marrjes në pyetje. Të gjithë pjesëtarët e zbatimit të ligjit duhet të jenë në gjendje që të marrin në pyetje fëmijën apo personin e ndjeshëm, përfshirë viktimat e rritura të dhunës në familje. Viktimat nuk mund të ndihmohen nëse pjesëtarët e zbatimit të ligjit nuk janë në gjendje që të mbledhin informacionet e nevojshme. Nëse informacioni nuk sigurohet, atëherë nuk mund të ndahet me prokurorin apo gjyqtarin. Trajnimi dhe udhëzimet do t’iu ndihmojnë atyre të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me viktimat që të jenë në një pozitë më të mirë për t’iu ndihmuar. Kjo duhet të përfshijë njohjen më të mirë të kufizimeve të viktimave të cilat nuk janë krejtësisht bashkëpunuese, dhe mënyrës se si kjo mungesë e bashkëpunimit të plotë mund të ndikojë në saktësinë e informacioneve të raportuara.

Çështje kritike të funksionimit të mekanizmave institucional (Kapitulli III: 3.2.2) ⁸

Kjo pjesë e strategjisë i identifikon mangësitë në funksionimin e secilit institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës për rastet e incidenteve të dhunës në familje. Strategjia e trajton mungesën e infrastrukturës dhe prioritizimin për mbështetjen e përpjekjeve për adresimin e dhunës në familje si çështje kritike. Fatkeqësisht, nuk është dhënë ndonjë udhëzim për atë se si të arrihet ndryshimi dhe si të ndërtohet një sistem më i mirë, e as se si qeveria do të sigurojë që dhuna në familje do të jetë prioritet për të gjithë partnerët e saj.

- *Mungesa e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale të kualifikuara për parandalim dhe ofrim të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje*

Duhet të zotohen më shumë burime për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të atyre që janë në sistemin e drejtësisë nëse dëshirojmë që të ndodhë ndryshimi në këtë shoqëri. Dhuna në familje është problem ndërkombëtar. Zgjidhjet janë po aq të suksesshme sa edhe burimet e zotuara për to. Gjatë fazës së mbledhjes së informatave në përgatitje për këtë vlerësim, ishte befasuese që prokurorët nuk janë të specializuar në fushën e dhunës në familje, ndonëse ka prokurorë që konsiderohen si “Koordinatorë Nacional kundër dhunës në familje”. Këta prokurorë janë përgjegjës për marrjen dhe shpërndarjen e këtyre rasteve mirëpo, ata nuk e bëjnë ndjekjen e rasteve të dhunës në familje për rajonin e tyre. Përveç kësaj, prokurorët nuk i trajtojnë rastet e tyre nga fillimi deri në fund pasi që ata shpesh ua kalojnë lëndët tjerëve për t’i “mbuluar” ata në datat e gjykimeve. Mungesa e personelit prokurorial shpie në dërgim të lëndëve sa andej e këndeje, mungesë të njohurive të qarta dhe mungesë të qartë të specializimit në fushën e dhunës në familje. Pa pasur më shumë burime është vështirë që të imagjinohet drejtësia si një mundësi.

- *Institucionet e rëndësishme të zbatimit të ligjit nuk e konsiderojnë dhunën në familje si prioritet*

Prioritizimit të dhunës në familje i mungojnë udhëzimet e qarta, gjë që rezulton në dallim në trajtim të këtyre rasteve nga njeri prokuror te tjetri apo nga njeri gjyqtar te tjetri. Rastet e dhunës në familje vazhdojnë të trajtohen si çështje të ndërlikuara familjare pa ndonjë zgjidhje të lehtë që më së miri trajtohen në gjykatë civile. Për ta zgjidhur këtë problem, gjyqtarët e prokurorët specifik duhet të përkushtohen në trajtimin e rasteve të dhunës në familje në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. Prokurorët e gjyqtarët të cilët kanë njohuri dhe janë të informuar do të krijojnë efekt të zmbropsjes së kryerësve të cilët jo vetëm që kanë gjasa që t’i përsërisin veprat por edhe ta eskalojnë sjelljen e tyre të dhunshme, duke i shkelur edhe më tutje të drejtat e viktimës dhe duke i rrezikuar jetët e viktimave dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre.

Dhuna ndërmjet personave të panjohur shpesh merret si më serioze se sa dhuna ndërmjet personave në marrëdhënie. Mirëpo, dhuna brenda një marrëdhënieje ka gjasa që të përsëritet vazhdimisht, dhe secilën herë që përsëritet mund të bëhet më e dhunshme se herët e mëparshme. Secili rast i abuzimit do ta bëjë viktimën që të ndjehet më e vetmuar dhe e izoluar dhe më shumë të frikësuar për jetën dhe të ardhmen e saj dhe më të tërhequr e të thyer emocionalisht. Nëse ajo vendosë që të largohet kjo është koha më e rrezikshme për të sepse burri i cili dëshiron ta ushtrojë pushtetin e tij ndaj gruas nuk do të heq dorë kur ky kontroll të jetë kërcënuar. Kjo është koha kur ndodhin vrasjet. Kjo shpie në pyetjen, “përse dhuna ndërmjet personave të panjohur merret më seriozisht se sa dhuna që ndodhë ndërmjet partnerëve intim?” Nuk ka gjasa që i

⁸ Shumica e çështjeve kritike që përfshijnë mekanizmat institucional të adresuar në Strategji përfshijnë shërbimet për viktimat, të vlerësuara nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

panjohuri të lëndohet prapë, kurse lëndimi fizik e emocional i një gruaje dhe fëmijëve të saj mund të zgjasë tërë jetën dhe të përsëritet në gjeneratat e ardhshme. Burri që e godet gruan e tij duhet të dënohet më rëndë, e jo më lehtë, dhe ky dënim duhet të ekzistojë pavarësisht dëshirave të gruas. Llogaridhënia duhet të jetë e njëtrajtshme, përndryshe ndjekja penale apo ekzistimi i ligjeve të dhunës në familje nuk kanë kuptim. Dhuna në familje e prekë të gjithë shoqërinë; sigurinë e pjesëtarëve të saj në përgjithësi. Mund të krijohet çfarëdo strategjie, por pa burime, udhëzime, arsimim, trajnim dhe përkrahje financiare të nevojshme, ajo mbetet vetëm një grup i rekomandimeve të pazbatuara dhe paekzekutuara.

Objektivat dhe Politikat Strategjike (Kapitulli IV)

Strategjia ofron një listë të sugjerimeve në “Objektivat strategjike dhe specifike”⁹ dhe “Formulimin e Politikave dhe Programeve për secilin sektor”.¹⁰ Ekziston një listë e gjërave që strategjia mëton t’i arrijë por nuk ka sugjerime konkrete që do ta bënin këtë listë realitet. Nëse do të implementoheshin, shumica e këtyre sugjerimeve do të ishin hapa pozitiv në drejtim të duhur dhe PSV-të janë të dobishme në këtë, mirëpo, vetë Strategjia jep shumë pak udhëzime të qarta përkitazi me mënyrat e zbatimit të synimeve të Strategjisë. Gjithashtu, Strategjia nuk parasheh mekanizma për monitorimin apo zbatimin e Strategjisë. Me sa duket tani ka raportim të më shumë rasteve dhe hartimi i Ligjit për mbrojtje ndaj dhunës në familje është hap i madh në drejtimin e duhur. Ka pasur trajnim për aktet kryesor i cili me sa duket ka qenë i suksesshëm, mirëpo, trajnimi është i kufizuar dhe duhet të bëhet më tepër për të siguruar një qasje më të njëtrajtshme. Organizatat si CLARD janë duke punuar në edukimin e popullatës. Mirëpo, është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës që të japin një mesazh të qartë dhe udhëzime të njëtrajtshme që dhuna në familje nuk do të tolerohet.

Monitorimi dhe vlerësimi i programit

Nevojitet mbledhje e statistika dhe mbledhje e të dhënave uniforme për ta vlerësuar suksesin e institucioneve të Kosovës që e zbatojnë Strategjinë. Nuk ka ndonjë sistem kuptimplotë të monitorimit dhe llogaridhënies për aktet. Është vështirë që të vlerësohet numri i rasteve apo rritja e raportimit nëse statistikat nuk mbahen në mënyrë rutinore nga policia, prokuroria dhe gjykatat. Për më tepër, është vështirë që të përcaktohet respektimi dhe zbatimi i Strategjisë nëse nuk ka raportim për zbatimin e as për sukseset dhe dështimet e saj. Krijimi i sistemit më të mirë të mundshëm për trajtimin e dhunës në familje në Kosovë do të merr kohë. Një metodë e besueshme dhe e njëtrajtshme e llogaridhënies për zbatim duhet të jetë raportimi tek Koordinatori i dhunës në familje, për të siguruar drejtimin më të mirë të ecjes përpara.

Strategjia parasheh që Agjencia për Barazi Gjinore duhet ta monitorojë numrin e rasteve të dhunës në familje. Kjo qasje e lë anash rolin e sistemit të drejtësisë për luftimin e dhunës në familje dhe e injoron rolin e Koordinatorit Nacional si pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, Policia, mbrojtësit e viktimave, prokurorët dhe gjykatat duhet të mbajnë statistika. Të dhënat e mbledhura duhet të përfshijnë statistika për raportimin, hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave të dhunës në familje si dhe kërkesave për lëshim të urdhrave mbrojtës por edhe urdhrave mbrojtës të lëshuar.

⁹ Kapitulli 4.1

¹⁰ Kapitulli 4.2

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV)

Pas Strategjisë, janë miratuar procedurat standarde të veprimit për parandalimin e dhunës në familje me qëllim të plotësimit të zbrazëtirave në trajtimin e viktimave të dhunës në familje nga institucionet e Kosovës. Procedurat standarde të veprimit kanë dhënë udhëzime substanciale lidhur me rolet e secilit akter kyç. Mirëpo, pa zbatim apo llogaridhënie, realizimi i objektivave të PSV-ve nuk është i njëtrajtshëm. Gjyqësori dhe prokuroria ishin më pak të njoftuar për Strategjinë dhe PSV-të në krahasim me Policinë dhe mbrojtësit e viktimave. Një arsye për diskrepancë është që Strategjia është përqendruar më tepër në viktimat dhe shërbimet për viktimat se sa në adresimin e sjelljes së kryerësit. PSV-të e mbështesin Strategjinë, mirëpo, nuk kanë qenë në gjendje që t'i tejkalojnë zbrazëtitrat në Strategji ku kishte mungesë të udhëzimeve të detajuara për ndryshim, veçanërisht në fushat e monitorimit dhe zbatimit.

Propozimet dhe Rekomandimet

Kjo pjesë e vlerësimit paraqet propozimet dhe rekomandimet për tu përfshirë në përpjekjet e ardhshme, me qëllim të adresimit të problemit të dhunës në familje. Këto propozime dhe rekomandime përqendrohen në ndryshimet në qasjen ndaj dhunës në familje dhe në strategjitë e ardhshme për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Këto sugjerime duhet të konsiderohen si plotësim i komenteve që gjenden në Përmbledhjen e Gjetjeve.

Çështjet kritike që nuk janë adresuar në Strategji

Ekzistojnë disa faktorë kyç që mungojnë tërësisht nga Strategjia, e që do të adresohen më poshtë. Ata përfshijnë (1) politika e tolerancës zero në të gjitha institucionet e Kosovës për sa i përket dhunës në familje, (2) modeli i bazuar në kryerësin për çrrënjosje të dhunës në familje, (3) zgjidhja e problemeve që kanë ekzistuar para pesë viteve, dhe ende vazhdojnë të ekzistojnë, (4) kriteret e qarta për specializim të akterëve institucional, (5) zotim i më shumë burimeve, (6) një model për trajnimin dhe arsimimin nga dhe për akterët kyç dhe (7) një strategji monitorimi për të siguruar zbatim dhe për ta vlerësuar përparimin e arritur.

Përkufizimi dhe të kuptuarit e problemit

Të gjithë akterët, veçanërisht ata në sistemin e drejtësisë, duhet të jenë më mirë të edukuar lidhur me fenomenin e dhunës në familje dhe standardet ndërkombëtare për luftimin e tij. Një perceptim i përgjithshëm në tërë Kosovën është që dhuna në familje përfshinë sulme të vogla dhe kërkesa për urdhra mbrojtës. Ky përkufizim i dhunës në familje është joadekuat për ta eliminuar si duhet apo edhe zvogëluar dhunën në familje në shoqërinë kosovare. Për ta përmirësuar të kuptuarit e dhunës në familje nga ana e akterëve kërkohen trajnime më të thelluara lidhur me dinamikën e ndërlikuar të dhunës në familje dhe një game të sjelljeve abuzuese dhe kontrolluese që kryerësit i kanë në dispozicion.

Kjo mungesë e të kuptuarit të dinamikës së dhunës në familje demonstrohet nga të besuarit e pabazuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që viktimat e humbin dëshirën për të bashkëpunuar në ndjekjen penale, apo e humbin interesin për urdhër mbrojtës, për shkak se marrëdhënia e tyre është përmirësuar dhe ato nuk kanë më frikë dhe nuk janë më në rrezik. Zakonisht dhuna në familje nuk korrigjohet vetë. Një burrë që është i dhunshëm në marrëdhëniet e tij nuk vendos

përnjëherë që nuk do të përdorë më forma të abuzimit dhe do ta jetojë jetën e tij në mënyrë të shëndoshë. Në vend të kësaj, pjesëtarët e sistemit të drejtësisë në Kosovë duhet të trajnohen dhe arsimohen për ta njohur faktin që viktimat shpesh marrin vendime të bazuara në frikë, presion, turp, keqinformim, mungesë të vetëbesimit, apo mungesë të alternativave. Pa një të kuptuar të qartë të ciklit të dhunës dhe formave të abuzimit në marrëdhënien e dhunës në familje, ndjekja dhe gjykimi i këtyre rasteve do të vazhdojë të jetë joefektiv.

Metodologjia konkrete

Strategjia e re duhet të merr para sysh vendosjen e udhëzimeve dhe planeve më konkrete. Strategjia e mëparshme ofronte vetëm informata lidhur me atë që nuk ka funksionuar, dhe një listë të nevojave për korrigjim. Strategjia ishte e mirë si hap i parë për identifikimin e çështjeve dhe shprehjen e nevojës për prioritizim të dhunës në familje, por për të ecur përpara është e nevojshme që të ekzistojë një plan strategjik me afate kohore për zbatim dhe burime financiare për ta bërë të mundshëm ndryshimin.

Për më tepër, Strategjisë iu kanë nevojitur PSV të ndara dhe përkrahëse por ajo nuk ka dhënë udhëzime për qëllimin specifik të PSV-ve apo periudhën e nxjerrjes së tyre. Ky dështim i ka shtuar vite të tëra zbatimit të strategjisë. Derisa sugjerimet për praktikat më të mira mund të jenë të dobishme, akterëve iu nevojiten udhëzime. Një strukturë më e fortë për zbatim do të jetë në dobi të të gjithëve. Zbatimi duhet të ndodhë me faza. Duhet të ekzistojë një ekip i njerëzve me detyra të mbikëqyrjes, adresimit të çështjeve dhe njohjes së pikave të rezistencës, që ka aftësi dhe kompetenca për t'i dhënë mandat zbatimit. Do të ishte ideale sikur ky ekip të përbëhej nga njerëz që e kuptojnë dhe interesohen për dhunën në familje. Koordinator i dhunës në familje ka kompetenca të pakufizuara për të siguruar respektim, dhe njëtrajtshmëri, mirëpo kjo është punë e madhe që kërkon vëmendje të madhe nga individë të përkushtuar.

Qasja e njëtrajtshme ndaj dhunës në familje

Rajonet e ndryshme gjyqësore të Kosovës, e interpretojnë dhe zbatojnë ligjin në mënyra të ndryshme. Kjo është për shkak të zbrazëtirës në Strategji e cila nuk e përvijon një qasje të njëtrajtshme. Një strategji e saktë krijon mjedis më të mirë për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm. Duhet të ketë llogaridhënie më të madhe kur strategjia apo ligji nuk zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme. Derisa qasja për garantimin e urdhrave mbrojtës, arrestimeve dhe kërkesve për paraburgim, llogaridhënies së kryerësve dhe shërbimeve për viktimat duhet të jetë e njëtrajtshme, duhet të ketë edhe liri për të zgjidhur probleme dhe zbatuar mjete të dobishme. Aktualisht ka pak liri nga akterët për të adresuar çështjen e dhunës në familje në rajonin e tyre në atë mënyrë që funksionon më së miri për ta. Personat që interesohen për këtë çështje dhe e kuptojnë atë, kanë aftësi për të krijuar ndryshim në nivel lokal. Ata i presin direktivat nga lartë dhe nuk mund të veprojnë pa to. Për shembull, një polic kishte raportuar që formularët në PSV-ve janë shumë të dobishëm dhe përkatës, mirëpo polici nuk i kishte përdorur ato forma sepse nuk ishte urdhëruar nga mbikëqyrësi. Personat në linjën e parë të frontit, të cilët e respektojnë dhe përkrahin ligjin, duhet të ndjehen të fuqizuar pasi që duhet njoftuar më mirë me problemin, dhe bile edhe me viktimat e kryerësit individual. Kosova duhet t'i ketë takimet vjetore dhe gjashtëmujore për akterët, në mënyrë që të bashkohen në një vend për t'i diskutuar përpjekjet e tyre dhe për të mësuar nga njëri tjetri. Të gjithë do të përfitonin nga kjo dhe Koordinator i dhunës në familje do të kishte mundësi që të shihte evoluimin e strategjisë së re.

Ndërrimi i mendësisë / Ndryshimi i dialogut

Një nga pengesat më të mëdha ndaj ndryshimit në Kosovë është mendësia aktuale që dhuna në familje është problem familjar. Bashkimi i familjes është qëllimi kryesor i gjykatave dhe prokurorive. Viktimat fajësohen dhe turpërohen nga sistemi. Kjo është qasje joefektive. Të gjithë akterët duhet ta njohin faktin që dhuna në familje është çështje e shëndetit publik por edhe çështje e të drejtave të njeriut dhe bashkimi i familjes nuk është mi i lartë se sa siguria e viktimës. Siguria e viktimës dhe llogaridhënia e kryerësit duhet ta zëvendësojnë bashkimin e familjes si një ndër prioritetet e Strategjisë.

E drejta ndërkombëtare shpesh përqendrohet në mbrojtjen e viktimës apo personit të cenueshëm. Strategjia në mënyrë të qartë e shikon dhunën në familje përmes filtrave të të drejtave të njeriut. Derisa nevojiten shërbime dhe edukim i viktimave për të bërë ndryshim, diskutimi duhet të zhvendoset për ta përfshirë edhe kryerësin. Ne i ndihmojmë viktimës dhe kryerësi e gjen një tjetër. Kur ta ndryshojmë kryerësin e kemi zvogëluar dhunën në familje. Gjuha aktuale e strategjisë sugjeron që viktimat e kanë një sëmundje që kërkon përkujdesje. Ato duhet të rehabilitohen dhe reintegrohen. Derisa është e drejtë të sugjerohet që viktimave iu nevojitet një reagim i koordinuar i shërbimeve, është kryerësi ai që ka nevojë për trajtim. Dialogut aktual rreth dhunës në familje i mungon llogaridhënia dhe rehabilitimi i kryerësit. Strategjia duhet ta qartësojë që kryerësi është problemi e jo viktimat.¹¹

Mesazhi për zero tolerancë / Dhuna në familje është KRIM

Derisa Ligji për mbrojtje ndaj dhunës në familje përbënë një hap të madh në drejtimin e duhur, ai fatkeqësisht parasheh vetëm mjet juridik në gjykatë civile, ku kryesisht adresohet lëshimi i urdhrave mbrojtës. Strategjia e re duhet ta adresojë trajtimin e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale. Dhuna në familje përbëhet nga lloje të ndryshme të sjelljes kriminale që mund të gjenden në shumë nene të Kodit Penal. Shumë shpesh, kur gruaja kërkon urdhër mbrojtës, kjo ndodhë si rezultat i sjelljes abuzive dhe kriminale. Nëse nuk ka qenë kështu, ajo nuk do të ketë bazë për marrjen e urdhrit. Mirëpo, nuk bëhen arrestime në bazë të këtyre pretendimeve të cilat dëshmojnë në gjykata në mbështetje të urdhrit mbrojtës. Kurdo që viktimat ta raportojë rastin dhe të pretendojë që kryerësi e ka shkelur Kodin Penal, duhet të bëhet arrestimi. Kjo është mënyra e vetme që të bartet mesazhi i thjeshtë që dhuna në familje nuk do të tolerohet. Politika për zero tolerancë do t’ua bëjë me dije kryerësve që do të ketë llogaridhënie dhe do t’iu tregoj viktimave që kur rastet të raportohen do të ndërmerren edhe veprime.

Një rezultat tjetër i rëndësishëm është zvogëlimi i lirisë së veprimit (diskrecionit). Derisa të gjithë akterët ta kenë miratuar qasjen për zero tolerancë ndaj dhunës në familje, është me rëndësi që të zvogëlohet numri i rrethanave lehtësuese që prokurorët mund t’i marrin para sysh për arrestimin apo paraburgimin e kryerësve. Nëse është shkelur ligji, prokurorët dhe policia duhet të kërkojnë që të veprojnë. Për më tepër, ligji aktual për mbrojtjen nga dhuna në familje është hartuar në atë mënyrë që përmban mundësi të ndryshme. Shkelja e urdhrit mbrojtës duhet të kërkojë ndalimin dhe pasojën. Duhet të merret qëndrim i fuqishëm për tu siguruar që mesazhi të jetë pranuar: Kosova nuk do ta tolerojë dhunën në familje ... Kryerësit do të dënohen.

Pjesëtarët e informuar të profesionit ligjor besojnë që çështjet e dhunës në familje duhet të dëgjohen para gjyqtarit në gjykatë penale, e jo gjyqtarit në gjykatë civile. Ka shumë ndarje ndërmjet urdhrave mbrojtës dhe sjelljes kriminale kur në realitet ato shkojnë krah për krah. Shumë viktimat kërkojnë urdhra mbrojtës si rezultat i sjelljes së dhunshme dhe kriminale, dhe

¹¹ Qasja me kryerësin në qendër do të diskutohet më tutje në tekstin e mëposhtëm.

shumë urdhra mbrojtës shkelen; që prapë është sjellje kriminale. Ashtu siç është dizajnuar, ndarja është bërë për të sugjeruar që dhuna në familje është çështje civile dhe pjesë e procedurave të gjykatave familjare e jo vepër e rëndë kundër shtetit. Organizimi aktual e minimizon rëndësinë e problemit të dhunës në familje dhe ia bënë më të vështirë viktimës e cila duhet të manovrojë dy procedura të ndara e të ndryshme gjyqësore. Përveç kësaj, humben shumica e përfitimeve të pasjes së gjyqtarëve të specializuar. Së pari vetëm gjyqtarët e gjykatës civile specializohen për dhunën në familje, mirëpo ata nuk i gjykojnë shumicën e rasteve të dhunës në familje të cilat përfundimisht duhet të trajtohen nga gjykata penale. Gjyqtari që merr informata për situatën e viktimës dhe kryerësit nuk është i njëjti gjyqtar i cili i adreson mjetet juridike. Një gjë që i shtohet këtyre vështirësive është fakti që gjyqtari i cili duhet ta merr vendimin e vështirë për llojin e urdhrit mbrojtës që do të lëshohet për viktimën, nuk ka kurrfarë përfshirje në rezultatet e atij urdhri mbrojtës. Gjyqtari i gjykatës civile nuk njoftohet për shkeljet e as nuk përfshihet në ekzekutimin e këtyre urdhrave, e as llogaridhënies në rast të shkeljes së tyre. Do të ishte më efikase nëse gjyqtari i cili e lëshon urdhrin dhe i jep udhëzime kryerësit të jetë po ai që e takon kryerësin në rast të mosrespektimit të urdhrit mbrojtës.

Përfundimisht, sjellja kriminale duhet të trajtohet nga gjyqtari i gjykatës penale. Kosova duhet ta shqyrtojë ndryshimin e plotësimin apo revidimin e Ligjit të dhunës në familje për të ofruar qartësi që të gjitha aktet e dhunës në familje, jo vetëm shkelja e urdhrave mbrojtës, do të merren seriozisht dhe trajtohen si procese penale. Sipas nenit 177 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtarët lëshojnë urdhra mbrojtës në fillim të ndjekjes penale. Urdhrat do të mund të rrinin në fuqi gjatë kohës sa shqyrtohet lënda, dhe kur të zgjidhet ajo mund të lëshohet një urdhër “përfundimtar”, me kohëzgjatje të ndryshme varësisht nga zgjidhja e rastit dhe akuza për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Në situata ku sjellja e të pandehurit nuk përbënë vepër penale, viktimat mund ta ketë mundësinë e kerkimit të urdhrit mbrojtës në gjykatën civile, shkeljet e së cilit mund të adresohen qoftë nga gjyqtari në gjykatë penale apo civile, varësisht nga natyra dhe ashpërsia e shkeljes.

Përveç kësaj, një komponentë e rëndësishme për strategjinë e re është specializimi i gjyqtarëve të gjykatës penale. Sikur një gjyqtarë në secilin rajon t’i kishte shqyrtuar të gjitha rastet penale që përfshijnë dhunën në familje, ai ose ajo do të ishte në pozitën më të mirë për të shqyrtuar dënime që janë të njëtrajtshme, dhe do të ishte përparësi shumë e madhe në rastet që kemi të bëjmë me recidivistë. Gjyqtari do t’i njihte palët dhe do të krijonte marrëdhënie me gjyqtarin e specializuar të gjykatës civile në mënyrë që të dy të mund të informohen për të gjitha rastet e pazgjidhura ndërmjet palëve (përfshirë por pa u kufizuar vetëm në ndjekjet penale si dhe procedurat e shkurorëzimit, kujdestarinë dhe vizitat, ndarjen e pronës, etj.)¹² Kjo do të funksiononte si në të mirë të viktimës ashtu edhe kryerësit. Ekzistimi i gjyqtarëve të specializuar të cilët janë arsimuar e trajnuar për dinamikën e dhunës në familje, së bashku me prokurorët e specializuar, do të mundësojë reagim dhe parandalim më të mirë.

Prokurorët aktualisht “specializojnë” në mënyrë shumë të kufizuar. Është caktuar që një prokuror në secilin rajon të jetë i specializuar për dhunën në familje. Mirëpo, në praktikë, prokurori i cili është “Koordinator i dhunës në familje” thjeshtë e organizon punën me lëndët e dhunës në familje dhe i shpërndanë lëndët tek prokurorët tjerë. Në disa prokurori mund të ketë përgjegjësi shtesë e në disa tjera më pak mirëpo ky nuk duhet të jetë rezultati i specializimit.

¹² Në Nju Jork, kemi gjykata të specializuara për dhunën në familje, njëra për nivel më të ulët (kundërvajtje) kurse e dyta për raste më të rënda (vepra penale). Gjithashtu e kemi edhe një gjykatë të integruar të dhunës në familje (IDV). Kjo gjykatë është në dispozicion për palët të cilat kanë raste të pazgjidhura familjare në kohën kur është iniciuar rasti në gjykatën penale (që përfshinë cilindo nivel të veprave). Një gjyqtar do t’i trajtojë të dy rastet. Derisa lënda në gjykatë penale dhe ajo në gjykatë familjare përfshijnë prokuror e avokat të ndryshëm dhe shqyrtohen nga gjyqtari ndarazi, që të dyja trajtohen në të njëjtën ditë dhe zakonisht njëra pas tjetrës.

Prokurori i cili specializohet për dhunën në familje duhet të pranojë trajnim dhe arsimim shtesë dhe duhet të jetë përgjegjës për të gjitha lëndët që përfshijnë dhunë në familje nga fillimi deri në fund. Kjo do të ishte në dobi të rasteve, viktimave dhe kryerësve. Prokurorët e specializuar do të ishin në pozitë më të favorshme pasi që do të ishin më të vetëdijshëm për kryerësit individual në rajonin e tyre, dhe do të kishin mundësi që të krijojnë marrëdhënie me aktet tjerë kryesorë të cilët janë gjithashtu të specializuar për dhunën në familje. Shumë prokurori aktualisht nuk e kanë numrin e duhur të prokurorëve apo burimet për ta bërë këtë specializim. Përveç kësaj, çështjet e numrit të prokurorëve i parandalojnë prokurorët që t’i trajtojnë lëndët nga fillimi deri në fund, gjë që është problematike dhe mund të jetë e dëmshme për suksesin e rasteve. Kjo shpie në situatë ku prokurorët i paraqesin lëndët e kolegëve të tyre në gjykatë; lëndë në të cilat nuk janë të njoftuar me provat dhe faktet relevante. Nëse qytetarët nuk mbrohen nga prokurorë të përgatitur dhe informuar të cilët e kanë për detyrë që ta kërkojnë drejtësinë në emër të tyre, atëherë sistemi i drejtësisë penale është duke i zhgënjyer të gjithë.

Autori i këtij raporti është i brengosur nga mungesa e njëtrajtshmërisë në ndjekje, mungesa e transparencës, mungesa e standardeve të larta për punë dhe luftim për drejtësi, mungesa e njohjes së rasteve dhe rezultateve dhe mungesa e burimeve që iu janë dhënë prokurorëve; burime që do t’iu mundësonin atyre që të bëjnë më shumë. Prokurorët duhet t’i respektojnë standardet më të larta të etikës pasi që asnjë pozitë tjetër në kuadër të profesionit ligjor nuk bartë me vete më shumë përgjegjësi për shoqërinë. “Prokurori sillet gjatë gjithë kohës në atë mënyrë që e promovon besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efektshmërinë, pavarësinë dhe paanësinë e prokurorëve.”¹³ Prokurori është mbrojtësi i të gjitha viktimave, zbatues i të gjitha ligjeve, dhe sigures i llogaridhënies për ata që zgjedhin t’i shkelin të drejtat e tjerëve dhe shkelin kodin e mirësjelljes të paraparë me ligj. Përveç sigurisë së të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë, prokurori e mbanë çelësin si të lirisë ashtu edhe sigurisë së personit. Detyra më e rëndësishme e prokurorit është që të kërkojë drejtësi. Me sa duket nuk ka kërkim të drejtësisë nga prokurorët por vetëm mbledhje e informatave të cilat në fund iu dorëzohen gjykatës. Roli i prokurorit duhet të zhvillohet edhe më tutje dhe gjatë këtij procesi duhet të inkurajohet njëtrajtshmëria në të gjitha rajonet, si dhe llogaridhënia për kryerësit e veprave penale që ndodhin në suaza të marrëdhënieve familjare.

Koordinimi dhe Bashkëpunimi

PSV-të e kanë arritur qëllimin e përkufizimit më të qartë të roleve të akterëve kyç. Policia e Kosovës dhe mbrojtësit e viktimave me sa duket kanë përfituar më së shumti nga PSV-të. Viktimat dhe kryerësit do të përfitonin, siç u cek më lartë nga një specializim më i mirë i prokurorëve dhe gjyqtarëve. Këta pjesëtarë të specializuar do të mund të punonin më mirë së bashku për t’i ndihmuar viktimat dhe për t’i mbajtur përgjegjës kryerësit.

Një gjë që i ka munguar strategjisë së mëparshme e që duhet të përfshihet në strategjinë e re, janë mekanizmat për monitorim dhe zbatim. Përfundimisht, një rekomandim i rëndësishëm është që të emërohen me kujdes ata që e mbikëqyrin zbatimin e Strategjisë së re, si dhe pjesëtarët e institucioneve kryesore të cilët do të specializohen. Në esencë, personat që e kanë pasion punën e tyre në përgjithësi do të kenë performancë më të lartë. Ata që interesohen për një çështje do të punojnë palodhshëm për t’u dëgjuar, dhe ata që e kanë për detyrë t’iu ndihmojnë tjerëve nuk do të pushojnë derisa të sillet drejtësia. Kjo është çështje delikate për një shtet që është i ndikuar nga traditat. Ata që janë caktuar për të punuar me këto lëndë duhet të jenë persona që interesohen për to dhe të cilët do të punojnë për të siguruar se do të ndërmerren

¹³ Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, neni 2 pika 2.

hapa për ta garantuar sigurinë e viktimave dhe zvogëlimin e gjasave që kryerësi të kryej serish vepër të tillë. Aktet institucional duhet ta kuptojnë veprën penale, mentalitetin dhe dinamikën e dhunës në familje. Duke e pasur para sysh këtë nevojë, duhet të ketë dëshirë për të kuptuar. Duhet të përzgjidhen personat e duhur për ta transmetuar mesazhin e koordinatorit të dhunës në familje; që duhet të shfrytëzohet Strategjia e re dhe që dhuna në familje nuk do të tolerohet.

Caktimi i Prioriteteve

Siguria e viktimës, llogaridhënia e kryerësit dhe zvogëlimi i shkallës së krimit duhet të jenë prioritetet kryesore të strategjisë së re për luftimin e dhunës në familje. Këto prioritete do të rrezikohen gjithmonë nëse vihen nën hijen e ideologjive të ndryshme. Të menduarit aktual në mendësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë në Kosovë është ai i nocionit të bashkimit të familjes. Është e qartë që rezultati i dëshirueshëm në ndjekjet penale të dhunës në familje dhe procedurat civile është ruajtja e strukturës së familjes dhe situatës së jetesës në të. Derisa dëshira e shoqërisë për të ruajtur njësinë familjare është e arsyeshme, sapo dhuna në familje të ketë hyrë në dinamikën e familjes, ky prioritet duhet të bartet në prioritet ku siguria e viktimës është brenga kryesore. Nuk mund të pretendohet që është pranuar ky prioritet dhe prapë të zbatohet ligji me theks në mbajtjen e viktimës brenda të njëjtës shtëpi ku jeton edhe kryerësi. Siguria e viktimës dhe bashkimi i familjes janë qëllime të papërputhshme në një marrëdhënie ku është përfshirë dhuna në familje. Përveç kësaj, dinamika e abuzimit në familje nuk thyhet lehtë. Nuk ka gjasa që një raport i policisë, një urdher mbrojtës, apo edhe kalimi i një kohe të shkurtër në paraburgim do ta ndryshojnë mentalitetin e burrit i cili abuzon ose rrah. Sjellja ka gjasa të jetë e rrënjësor thellë dhe shpesh vjen si rezultat i ekspozimit ndaj sjelljes së ngjashme në fëmijëri. Pa llogaridhënie të vërtetë, si dhe përpjekje reale për ta ndryshuar mentalitetin e abuzuesit, sjellja nuk do të ndryshojë. Mesazhi duhet të jetë i qartë që nëse viktimat nuk është e sigurt, asaj do t’i jepet mbrojtje, që shpesh ngërthen ndihmë me jetën e përditshme dhe mbështetjen për fëmijët e saj. Mesazhi për kryerësin gjithashtu duhet të jetë i qartë. Dhuna në familje nuk do të tolerohet andaj do të ketë edhe pasoja, si për sjelljen e dhunshme ashtu edhe për shkeljet e urdhrave të gjykatës. Vazhdimi i mbajtjes së mendësisë së vjetër të ruajtjes së bashkësisë familjare në dëm të sigurisë dhe llogaridhënies është i rrezikshëm dhe do të shpie në vazhdimësi të dhunës dhe me gjasa edhe në eskalim.

Shërbimet duhet t’i mbështesin prioritetet

Derisa kjo pjesë e vlerësimit nuk e ka për qëllim që t’i vlerësojë shërbimet për viktimat, është e qartë që duhet të ketë sisteme për ta bërë sigurinë dhe llogaridhënien prioritet. Viktimat aktualisht janë të bllokuara në marrëdhënie abuzive për shkak se nuk kanë mundësi tjera. Gjyqtarët vendosin që viktimat t’i lënë në shtëpi me abuzuesin dhe familjen e tij sepse nuk ka mundësi tjera për viktimën. Kryerësit e kanë krijuar problemin me veprimet e tyre, andaj do të ishte e duhur që ata të jenë personat në pozitë të pafavorshme të cilët duhet të kërkojnë aranzhime tjera të jetesës. Prokurorët hezitojnë që t’i ndalojnë të pandehurit sepse ata janë ushqyesit e familjes dhe me sa duket nuk ka mundësi tjera. Me ndërrimin e prioriteteve do të ketë edhe ndërrim të shërbimeve që i mbështesin këto prioritete. Pyetja nuk mund të jetë: Ajo nuk është e sigurt por ku mund të shkojë? Deklarata do të jetë: Ajo nuk është e sigurt, ne duhet t’i ndihmojmë asaj që ta gjejë një vend të sigurt.

Përveç shërbimeve për viktimat, zbatuesit e ligjit kanë nevojë për më shumë burime. Vlerësuesja është habitur kur ka dëgjuar që nuk ka vetura të mjaftueshme në zonat policore kështu që shpesh policët e dhunës në familje nuk mund të reagojnë në raste; që prokuroritë kanë numër të vogël të prokurorëve për ta caktuar një prokuror për trajtimin e të gjitha lëndëve të dhunës në familje, dhe ngjashëm me këtë, që koordinatorët e dhunës në familje në gjykatat civile janë të mbingarkuar, dhe që gjyqtarët e gjykatës penale nuk kanë kurrfarë specializimi në këtë fushë. Nëse luftimi i dhunës në familje do të jetë prioritet, kjo duhet të reflektohet në të gjitha fushat: në media, tek zbatuesit e ligjit, në sistemin e gjykatave dhe në shërbimet për viktimat dhe kryerësit.

Parandalimi dhe rehabilitimi i kryerësit

Sipas të menduarit të tanishëm, konsiderohet si “rrethanë lehtësuese” gjatë ndjekjes së një rasti të dhunës në familje, kur kryerësi kërkon falje dhe premton që ajo sjellje nuk do të përsëritet më. Gjyqtarët në mënyrë jo të duhur e përdorin këtë për ta arsyetuar zvogëlimin e dënimit të kryerësit. Kjo reflekton moskuptim të dinamikës së dhunës në familje.

Ata që punojnë në fushën e dhunës në familje janë të njohur me “Ciklin e dhunës”. Ai cikël sugjeron që kur të ndodhë një akt i dhunës pas saj vjen një periudhë e pendimit. Gjatë kësaj periudhe, marrëdhënia zakonisht është në ditët e saj më të mira, më paqësore dhe më me dashuri. Përfundimisht, tensioni fillon të ngritët prapë, dhe ky tension shpie në një akt tjetër të dhunës. Është pendesa dhe koha e jetesës në paqe dhe dashuri që shpesh e inkurajon viktimën dhe e bënë që të qëndroj në marrëdhënie. Të kuptuarit e kësaj që marrëdhënia mundet herë herë të jetë e mirë, e fuqizon idenë që marrëdhënia po funksionon... deri në aktin tjetër të dhunës. Mirëpo viktimat në marrëdhënie abuzive dhe të dhunshme asnjëherë nuk është jashtë rrezikut derisa kryerësi jo vetëm ta njohë faktin që ekziston problem në sjelljen dhe të menduarit e tij, por edhe të zotohet që do të bëjë ndryshim dhe të pranojë ndihmë për të ndryshuar. Kjo nuk është çështje e terapisë së çiftit. Kjo është çështje e deprogramimit të sjelljes së rrahësit. Për një kohë të gjatë, shoqëria e ka fajësuar viktimën për dhunë. Përfundimisht, vështrimi i dhunës në familje si problem i viktimës apo edhe si problem familjar është vështtrim i problemit nga një perspektivë e gabuar. Ekziston vetëm një arsye përse ekziston dhuna në familje, dhe ajo është për shkak se abuzuesi vendosë të abuzojë. Nëse e heqim nga ekuacioni këtë dëshirë për të qenë të dhunshëm dhe abuziv problemi zgjidhet.

Trajtimi dhe llogaridhënia për kryerësit është komponentë e rëndësishme për çfarëdo strategjie për luftimin e dhunës në familje. Kryerësit DUHET të japin llogari, përndryshe çfarë mesazhi po e bartim? Një alternative ndaj burgimit për kryerësit është një terapi e dizajnuar në mënyrë të veçantë dhe program edukativ me qëllim që t’i ndihmohet kryerësve që ta kontrollojnë sjelljen e tyre dhe ta kuptojnë më mirë se si sjellja e tyre ndikon tek tjerët. Nuk duhet të trajtohet vetëm menaxhimi i zemërimit dhe zgjidhja e konfliktit por edhe nevoja e tyre për pushtet dhe kontroll dhe mënyrat e ndryshme në të cilat merret kontrolli. Atyre duhet t’iu jepet një alternative ndaj sjelljes abuzive me shikim drejt mësimin të njerëzve tjerë se si duket një marrëdhënie e shëndoshë, pa abuzim dhe dhunë.

Llogaridhënia institucionale dhe zhvillimi i besimit

Strategjisë së mëparshme i ka munguar një strukturë më e mirë dhe udhëzime më të qarta lidhur me mbikëqyrjen. Njëtrajtshmëria në tërë vendin nuk mund të ndodhë pa një strukturë

të personave të mirinformuar të cilët kanë kompetenca për të siguruar që Strategjia do të respektohet dhe zbatohet nga të gjithë personat e përfshirë. Me llogaridhënie më të madhe vjen edhe njëtrajtshmëria dhe besimi më i madh për institucionet nga komuniteti. Nëse ekziston frika që nuk do të dalë asgjë e mirë nga raportimi, askush nuk do të raportojë raste. Mesazhi i tolerancës zero do të krijojë llogaridhënie më të madhe për kryerësit dhe do t’iu tregojë viktimave që mund t’i besojnë sistemit për t’iu ndihmuar atyre.

Përveç kësaj, një transparencë më e madhe do të jetë në dobi të komunitetit dhe do të krijojë mirëbesim. Është raportuar që prokurorët nuk kanë dhënë përgjigje në kërkesat e avokatëve mbrojtës dhe komunitetit. Kjo duhet të ndryshojë. Prokurorët kanë pozitë të rëndësishme dhe duhet të punojnë vazhdimisht në ndërtimin e besimit, e jo ta dëmtojnë atë duke mos u përgjigjur. Ata që i shërbejnë publikut duhet të kenë standard më të lartë, duke kërkuar mbikëqyrje të punës së tyre me lëndë dhe ngarkesës me lëndë.

Mbështetje më e madhe shtetërore për viktimat

Nëse statusi i ulët ekonomik që përfshinë varësi ndaj abuzuesve të tyre, si dhe hakmarrja për lënien e tyre janë dy pengesat më të mëdha për të kërkuar ndihmë dhe gjetjen e sigurisë, duhet të ndërmerren hapa më të mëdhenj për të (1) ofruar strehim të sigurt për viktimat dhe (2) për t’iu ndihmuar atyre në aspektin financiar në mënyrë që të mësojnë se si mund ta mbështesin vetën e tyre për ta filluar një jetë të re. Një nga kohët më të rrezikshme për viktimën e dhunës në familje është kur ajo vendosë ta lë marrëdhënien. Në Kosovë, ky rrezik rëndohet edhe më tutje nga fakti që nuk ka asistencë të nevojshme, gjë që e bënë këtë jo vetëm kohë të rrezikshme dhe frikshme por edhe konfliktuoze pasi që ajo mund të përballet me një jetesë pa burime, pa mjete financiare dhe shpesh edhe pa mbështetje të familjes. Viktimat inkurajohen që të mendojnë për fëmijët dhe ta ruajnë marrëdhënien e tyre abuzive, mirëpo çdo shtëpi e dhunshme dhe abuzive që rritë fëmijë në të, krijon gjeneratë të re të të rriturve të cilët nuk e dinë se si duket marrëdhënia e shëndoshë, dhe çka është edhe më keq, krijon abuzues dhe viktimat të së ardhmes. Kjo është sjellje e mësuar dhe institucionet duhet ta vlerësojnë më mirë se çka në fakt është interesi më i mirë jo vetëm i viktimës por edhe fëmijëve.

Përmbledhje e rekomandimeve

Kosova ka punuar shumë për t’i përkufizuar përbërësit esencial të strategjisë së saj. Përveç komponentëve të shtuar të (1) mesazhit për zero tolerancë, (2) llogaridhënies së kryerësit dhe (3) llogaridhënies institucionale, (4) përmirësimit të monitorimit të jo vetëm zbatimit të strategjisë por edhe statistikave që kanë të bëjnë me dhunën në familje, (5) transparencës, (6) objektivave dhe prioritetëve të definuara qartë dhe (7) burimeve shtesë, Strategjia e re duhet të merr para sysh edhe (8) dhënien e udhëzimeve më të qarta dhe (9) një qasje të orientuar kah zgjidhja. Kosova nuk do ta dijë sa ka përparuar pa i shqyrtuar efektet e përmirësimeve gjatë gjithë kohës. Analizat statistikore mund të jenë të dobishme edhe për të matur përfitimet që i sjellë ndryshimi. Mund të nevojitet kohë që të përcaktohet strategjia që funksionon më së miri për të inkurajuar raportimin dhe zvogëlimin e dhunës dhe krimin. Përkushtimi i shtetit të Kosovës për t’i kushtuar vëmendje të afërt kësaj çështjeje duhet lavdëruar. Tolerimi i padrejtësisë dhe dhunës vetëm sa e destabilizon shoqërinë dhe e inkurajon shkeljen e të drejtave të njeriut. Ecja përpara drejt zbatimit të zgjidhjeve më të qarta që i adresojnë çështjet thelbësore të atyre që preken nga dhuna në familje do ta përmirësojë shoqërinë për të gjithë ata që jetojnë në të.

Përmbledhje

- Duhet të ketë mesazh të qartë që dhuna në familje nuk do të tolerohet.
- Duhet të sigurohen hapa konkret për të ofruar zgjidhje për problemet e identifikura.
- Dhuna në familje duhet të njihet dhe përkufizohet si model ciklik i sjelljes së personit.
- për ta zvogëluar dhunën në familje duhet të ketë përqendrim në ndryshimin e sjelljes së kryerësit.
- Siguria e viktimës dhe bashkimi i familjes janë qëllime të papërputhshme kur marrëdhënia përfshinë dhunë në familje.
- Dhuna në familje duhet të trajtohet si çështje e shëndetit publik dhe sigurisë, dhe shqyrtimi i saj duhet të shkojë përtej fushës së ndërgjyqësisë personale, që rezulton nga kufizimi i përkufizimit të dhunës në familje vetëm në Kodin Civil.
- Kodi penal duhet ta përfshijë përkufizimin e dhunës në familje.
- Hetimi dhe ndjekja penale e dhunës në familje është e nevojshme për ta ndaluar dhunën ndaj grave.
- Akterët institucional duhet të edukohen lidhur me dhunën në familje.
- Të gjithë policët duhet të edukohen për dhunën në familje.
- Reaguesit e parë duhet të jenë të specializuar për hetimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Prokurorët duhet të identifikohen si pjesë e rëndësishme e mekanizmave institucional.
- Duhet të ketë propozim të dizajnuar qartë për specializim dhe trajnim si të gjyqtarëve të gjykatës civile ashtu edhe asaj penale dhe prokurorëve.
- Ligji duhet të revidohet për të siguruar që procesi të jetë më i lehtë për tu naviguar, përfshirë role dhe pritje të defnuara më qartë për mbrojtësit e viktimave.
- Çdo viktimë që ka bazë dhe kërkon urdhër për mbrojtje duhet t’i mundësohet urdhri.
- Statusi financiar i viktimës nuk duhet ta rrezikojë sigurinë e saj.
- Ligji nuk duhet t’ia lejojë kryerësit që të mbesë në shtëpinë e përbashkët si rezultat i lehtësimit apo mungesës së alternativave.
- Akterët kryesor duhet ta kenë të njëjtën qasje / mendësi të ngjashme lidhur me dhunën në familje.
- Akterët kryesor duhet të jenë të koordinuar më mirë.
- Duhet të ketë mekanizma për takime të rregullta të institucioneve të Kosovës për ta vlerësuar zbatimin dhe për t’i shkëmbyer idetë.
- Duhet të ketë masa të mbikëqyrjes për të siguruar përmirësim dhe korrigjim.
- Duhet të ketë trajtim të njëtrajtshëm dhe uniform të rasteve të dhunës në familje në tërë Kosovën.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

343.55(496.51)”2011/2014”(047)
Mustafa -Qosaj, Ariana
Raport mbi vlerësimin e programit të Kosovës kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit : 2011-2014 / Ariana Qosaj Mustafa, Amy Litwn. – Prishtinë : Asha, 2015. – 109 f. ; 21 cm.
Parathënie : f. 4
1.Litwn, Amy
ISBN 978-9951-717-01-4

